



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

21/2020

KRIMET

E PËRGJITHSHME
NË KOSOVË



2019

Nëntor, 2020

Autorët: Mirvet Thaqi, Anesa Hoxha dhe Egzon Halili

Ekipi i Redaktorëve: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Nëntor 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	5
2. Metodologjia.....	7
3. Gjykimi i drejtë sipas kornizës ligjore vendore dhe akteve juridike ndërkombëtare	8
4. Mandati ligjor i Prokurorive dhe Gjykatave në trajtimin e krimeve të përgjithshme.....	13
5. Ngarkesa totale me lëndë e divizioneve penale të gjykatave themelore	15
5.1 Ngarkesa me lëndë e DP-ve sipas gjykatave themelore	17
5.2 Ngarkesa dhe mënyra e kryerjes së lëndëve në DP të GjTh-ve sipas kategorive të veprave penale	19
5.3 Ngarkesa dhe mënyra e zgjidhjes së lëndëve në DP të Gjykatës së Apelit	24
6. Ngarkesa me lëndë në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorive Themelore gjatë vitit 2019.....	26
6.1. Ngarkesa me lëndë në DP-të e PTh-ve sipas kategorive të veprave penale dhe mënyra e kryerjes së lëndëve gjatë vitit 2019.....	29
7. Performanca e gjykatësve të DP-ve gjatë vitit 2019.....	31
8. Performanca e Prokurorëve të DP-ve në PTh gjatë vitit 2019	35
9. Gjetjet e IKD-së në trajtimin e krimeve të përgjithshme.....	37
10. Anex : Analizë e detajuar e rasteve të përzgjedhura karakteristike	43
11. Rekomandimet	88

Lista e shkurtesave

DP	Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal
DPDP	Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjTh	Gjykata Themelore
GjTHDP	Gjykata Themelore, Departamenti i Përgjithshëm
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KRPRK	Kodi i Ri Penal i Republikës së Kosovës
LGJ	Ligji për Gjykatat
LKGJ	Ligji për Këshillin Gjyqësor
LKP	Ligji për Këshillin Prokurorial
LPSH	Ligji për Prokurorin e Shtetit
PTH	Prokuroria Themelore

1. Përmbledhje ekzekutive

Divizionet Penale të Departamenteve të Përgjithshme të Gjykatave Themelore vazhdojnë të përballen me numër të madh të lëndëve të pazgjidhura, të cilat barten vit pas viti. IKD gjen se ky numër i lëndëve është një ndër arsyt kryesore të zvarritjes së rasteve gjyqësore në sistemin gjyqësor të Kosovës, e cila zvarritje konsiston në shkeljen e të drejtës kushtetuese për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Por, për dallim nga vitet paraprake, gjatë vitit 2019 Divizionet Penale të Gjykatave Themelore janë përforcuar me 18 gjyqtarë të rinj, i cili ka ndikuar edhe në uljen e numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. Për dallim nga viti 2018 kur kishin mbetur të pazgjidhura 40,118 lëndë, në fund të vitit 2019 ky numër është zvogëluar për 6,861 lëndë, përkatësisht në 33,257 lëndë. Por, përkundër kësaj rritje, shprehur në mesatare të numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e gjyqtarëve, gjyqtarët e divizioneve penale gjatë vitit 2019 kanë zgjidhur lëndë më pak se sa në vitin 2018.

Sa i përket politikës ndëshkimore në divizionet penale, dënimi më i shqiptuar është dënimi me gjobë, që përbën 49.39% të dënimeve, pasuar nga dënimi me kusht në 40.26% të rasteve, derisa në vetëm 6.64% të rasteve është shqiptuar dënim me burgim efektiv. 3.72% e lëndëve janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

Në anën tjetër, divizioni penal i Gjykatës së Apelit gjatë vitit 2019 ka zgjidhur më pak lëndë se sa që ka pranuar, derisa kësaj gjykate në fund të vitit 2019 i kanë mbetur të pazgjidhura 391 lëndë. Gjatë vitit 2019, kjo gjykatë ka kthyer në rigjykim 19.7% të lëndëve të zgjidhura.

Sipas raporteve zyrtareve, në departamentet e përgjithshme të prokurorive në fund të vitit 2019 kanë mbetur të pazgjidhura 74,849 lëndë. Sa i përket sistemit prokurorial, të dhënat statistikore të gjeneruara nga ky sistem e bëjnë të pamundur vlerësimin e trendeve të efikasitetit, për shkak të paqartësive të shumta. Për më tepër, sistemi prokurorial nuk ka ofruar të dhëna sa i përket numrit të rasteve të parashkuara në departamentet e përgjithshme të prokurorive gjatë vitit 2019.

Sa i përket zgjidhjes së lëndëve, IKD në këtë raport ka evidentuar disbalanc mes gjyqtarëve sa i përket numrit të lëndëve të zgjidhura, derisa sa i përket prokurorëve, sistemi prokurorial nuk ka dhënë qasje në këto të dhëna. Në raport me normën orientuese për prokurorë, sipas mesatares, këtë normë e kanë arritur Prokuroria Themelore në Prishtinë, ajo në Pejë, Mitrovicë dhe Ferizaj, derisa këtë normë nuk e kanë arritur Prokuroria Themelore në Prizren, Gjilan dhe Gjakovë.

Sa i përket procedimit të rasteve gjyqësore, IKD ka gjetur se vazhdon të jetë e theksuar dukuria e shtyrjes së seancave gjyqësore. Nga 3,426 seancat gjyqësore që IKD ka monitoruar në divizionet penale, 1,055 prej tyre janë shtyrë. Shprehur në përqindje, i bie se nga totali i seancave të monitoruara, 30.7% e tyre janë shtyer. Pra, afërsisht çdo e treta seancë. Sfidë tjetër vazhdon të jetë dukuria e parashkrimit. Shprehur në mesatare, IKD gjenë se gjatë vitit 2019,

në çdo ditë kalendarike janë parashkruar mesatarisht 6,49 lëndë, e që në muaj i bie të jenë parashkruar 197,5 lëndë penale.

IKD ka gjetur se në trajtimin e rasteve penale, prokurorët e departamenteve të përgjithshme nuk i kanë kushtuar rëndësi luftimit të kriminalitetit përmes sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së përfituar në mënyrë të kundërligjshme. Nga 2,371 raste të monitoruara, IKD ka gjetur se prokurorët e këtyre departamenteve në vetëm 54 raste kanë parashtruar kërkesë për sekuestrim të pasurisë, derisa këtë nuk e kanë bërë në 2,381 raste të tjera.

Gjetjet e IKD-së në këtë raport argumentojnë se mënyra e trajtimit të rasteve nga DP-të e Gjykatave dhe Prokurorive shkel të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, kohëzgjatja e procedurave penale vazhdon të jetë një problematikë e theksuar. Edhe në këtë raport, IKD ka evidentuar raste ku procedura gjyqësore ka zgjatur mbi 13 vite. Nga të dhënat e IKD-së, të nxjerra nga analizimi i rasteve të përzgjedhura ëistike që janë në këtë raport, del se Divizionet Penale të Gjykatave Themelore, për caktimin e shqyrtimit fillestar pas dorëzimit të aktakuzës në gjykatë u janë nevojitur mesatarisht **561 ditë**, ndonëse KPPK-ja në nenin 242.4 ka përcaktuar mbajtjen e kësaj seance brenda 30 ditëve nga ngritja e aktakuzës.

Në anën tjetër, në këtë raport IKD ka evidentuar raste të trajtimit selektiv dhe diskriminues të gjykatave ndaj personave të akuzuarve. Ky standard i dyfishtë i gjyqësorit vjen në shprehje në rastet kur persona me ndikim të lartë publik ballafaqohen me drejtësinë. Në raste të tilla, gjykatat zbatojnë praktika të ndryshme krahasuar me rastet tjera gjyqësore, kur si persona të akuzuar paraqiten njerëzit e rëndomtë. Po ashtu, IKD ka evidentuar edhe raste kur për shkak të neglizhencës së gjykatës, një qytetar ishte dënuar dy (2) herë për veprën e njëjtë penale, derisa janë evidentuar edhe raste të procedimeve penale për vepra penale të rëndësisë së vogël. Po ashtu, IKD në këtë raport ka evidentuar edhe shkelje ligjore sa i përket kompetencës së gjykatave me rastin e vendosjes.

Po ashtu, IKD gjatë procesit të monitorimit ka evidentuar praktika të Prokurorit të Shtetit, të cilat janë negacion i sigurisë juridike të qytetarëve. Këto praktikë, konsistojnë në ngritjen e aktakuzave nga të cilat hiqet dorë ende pa u shqyrtuar asnjë provë, madje ende pa u caktuar as shqyrtimi fillestar. Për më tepër, edhe gjatë vitit 2019 IKD ka evidentuar raste të shumta ku prokuroria ka ngritur aktakuza ndaj personave të vdekur.

2. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve në Departamentet e Përgjithshme – Divizionet Penale në sistemin prokurorial dhe gjyqësor, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Për draftimin e këtij hulumtimi, IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare (legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të ndryshme zyrtare të KGJK-së, raporte të ndryshme zyrtare të KPK-së si dhe të dhëna të tjera të siguruar nga këto institucione përmes kërkesave për qasje në dokumente publike dhe informata). Sa i përket të dhënave statistikore të sistemit prokurorial, të njëjtat janë të paqarta dhe nuk përputhen me periudha të ndryshme raportuese, çfarë ndikon në paqartësinë e trendit të efikasitetit në sistemin prokurorial.

Por para së gjithash, draftimi i këtij raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve në Departamentet e Përgjithshme – Divizionet Penale. Për të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD tash e dy vite ka lansuar për publikun edhe Platformën e Monitorimit të Gjyqësorit (<https://ejudiciary.org/>).

Me qëllim të krijimit të një pasqyre sa më të qartë lidhur me efikasitetin dhe performancën e sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial, IKD gjatë draftimit të këtij hulumtimi ka përdorur metodën krahasimore, duke analizuar të dhënat dhe dukuritë në analogji me vitet paraprake.

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikatorë të qartë për matjen e progresit dhe regresit të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor.

Ky raport përfshin monitorimin e këtyre rasteve në departamentet e përgjithshme të shtatë (7) prokurorive themelore dhe departamentet e përgjithshme – divizionet penale të shtatë (7) gjykatave themelore dhe degët e tyre, për periudhën kohore 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2019. Për të njëjtën periudhë kohore, raporti i bënë një trajtim të veçantë disa prej rasteve karakteristike, të cilat janë monitoruar nga IKD, duke ofruar gjetje të veçanta për secilin nga rastet e përfshira në këtë hulumtim.

Po ashtu, me qëllim të pasqyrit të trendit, IKD i është referuar edhe performancës së viteve paraprake të divizioneve penale, me qëllim të pasqyrit të progresit dhe regresit të efikasitetit të këtyre divizioneve.

IKD në këtë raport ka analizuar ngarkesën me lëndë të këtyre departamenteve, trendin e efikasitetit, mënyrën e zgjidhjes së lëndëve, performancën individuale të prokurorëve dhe gjyqtarëve etj. Për të gjitha këto, IKD në këtë raport ka dhënë edhe vlerësimet dhe rekomandimet.

3. Gjykimi i drejtë sipas kornizës ligjore vendore dhe akteve juridike ndërkombëtare

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si një ndër kushtetutat më moderne, ka mishëruar brenda saj standardet më të larta ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në nenin 21.1 të saj, ku përcaktohen Parimet e Përgjithshme mbi të Drejtat e dhe Liritë Themelore, këto të drejta përkufizohen si: *“të pandashme, të patjetërsueshme, të pacenueshme dhe bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës”*.¹

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 22 të saj ka paraparë zbatimin e drejtpërdrejtë në Kosovë të disa nga instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare më të rëndësishme në lëmin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Këtyre dokumenteve ndërkombëtare u është dhënë përparësi e zbatimit të tyre në rast konflikti me normat e brendshme ligjore apo nënligjore². Ndër instrumentet më kryesore të përcaktuara me këtë nen, është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollat e saj.

Sa i përket interpretimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Në kuadrin e këtyre të drejtave të garantuara në rendin kushtetues kosovar, një vend të rëndësishëm ka zënë edhe e drejta për gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, e cila është ngritur në pedestal, duke u ranguar në kategorinë e postulateve kushtetuese.

Kjo e drejtë themelore, është përcaktuar me nenin 31 të Kushtetutës sonë dhe parasheh se *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”*. Po ashtu, aty janë përfshirë edhe një sërë garancish procedurale, të tilla si: e drejta e çdo personi që çështja e tij të shqyrtohet publikisht, brenda një afati kohor të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e themeluar me ligj, prezumimi i pafajësisë, ndihma juridike falas etj.

Një formulim i ngjashëm mbi të drejtën për proces të rregullt gjyqësor është përshirë edhe në nenin 6 të KEDNJ. Në këtë nen, si elemente themelore të parimit të gjykimit të drejtë janë listuar: procesi të jetë publik; procesi të realizohet brenda një afati të arsyeshëm kohor; procesi të realizohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme; nga një gjykatë e caktuar me ligj; vendimi përfundimtar duhet të bëhet publik; i akuzuari të ketë mundësinë dhe lehtësitë për tu

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 9 prill 2008. Neni 21.1 [Parimet e Përgjithshme]: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës”*.

² Po aty. Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollat e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

përgatitur për çështjen e tij dhe të informohet për procedurat që ndiqen; e drejta e tij që të ketë mbrojtës të zgjedhur vetë ose ndihmë juridike falas; ndërveprim mes palëve në procedurë si dhe mes palëve e dëshmitarëve, ekspertëve etj.³

Kjo e drejtë thelbësore është e garantuar edhe në nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) i cili parashikon se "*gjithkush ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj*".

E drejta për një proces të rregullt gjyqësor përbën një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila është e projektuar ashtu që të mbrojë individët nga cenimet dhe kufizimet e paligjshme, arbitrare ose të privimit të të drejtave të tjera themelore. Parimin e gjykimit në kohë të arsyeshme e shpjegon më së miri parimi i mirënjohur në drejtësi, se "drejtësia e vonuar, është drejtësi e mohuar".

Ky parim u vë detyrimin bartësve të sistemit të drejtësisë që me efikasitetet të udhëheqin dhe të përfundojnë trajtimin e rasteve gjyqësore, i cili efikasitet duhet të konsistojë të paktën në respektimin e afateve ligjore.

Një proces i rregullt gjyqësor sendërtohet mbi premisat e një drejtësie të mirë administruar, e cila pikë së pari i garanton secilit mbrojtje efektive të të drejtave të tyre, dhe së dyti, përcjell idenë se çdo person i nënshtrohet të njëjtave rregullave, për tu konsumuar koncepti ideal i barazisë para ligjit, ku dhënia e vendimit final bazohet në provat e mirë administruara dhe të shqyrtuara nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, dhe ku çdo personit, i garantohet e drejta që të ushtrojë mjete juridike ndaj këtyre vendimeve gjyqësore.

E drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin në vete domosdoshmërinë që gjykimi të jetë publik dhe kjo kërkon që autoritetet përkatëse të sigurojnë, deri në një masë të arsyeshme, salla të gjykimit të përshtatshme, në mënyrë që anëtarët e interesuar të publikut të mund të marrin pjesë në gjyq. Në çështjen Riepan kundër Austrisë,⁴ GJEDNJ vendosi, "*se për të përmbushur nenin 6 të Konventës, vendi ku zhvillohen seancat gjyqësore duhet të jetë lehtësisht i qasshëm për publikun, që normalisht kërkon mbajtjen e seancave gjyqësore në salla normale gjyqi aq të mëdha sa të mund të zërë vend publiku. E drejta për seanca publike vlen jo vetëm për procedurat, por edhe për vendimet e gjykatave*".

Për momentin e fillimit dhe përfundimit të afatit të arsyeshëm për një çështje penale, ekzistojnë disa qëndrime. Lidhur me këtë, GJEDNJ ka nxjerrë vendime që kanë përcaktuar kritere të

³ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e miratuar në vitin 1950 nga Këshilli i Evropës. Neni 6 .1 "*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.."*

⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Riepan kundër Austrisë. nr. 35115/97. Aktgjykim. Strasburg, 14 nëntor 2000.

përgjithshme për kohën e fillimit dhe përfundimit të afatit të arsyeshëm. Përmbajtja e vendimeve nuk është një standard i njëjtë, pasi natyra rasteve të trajtuara ndryshon nga njëri rast te rasti tjetër, por kjo nuk do të thotë se përfundimet e arritura janë kundërthënëse mes vete. GjEDNJ ka zhvilluar një sërë kriteresh për vlerësimin e kohëzgjatjes së procesit, duke filluar nga *“identifikimi i momenteve kyçe kohore për llogaritjen e kohëzgjatjes, kompleksitetin e çështjes, sjelljen e autoriteteve, sjelljen e kërkuarit dhe rëndësinë e çështjes për vetë atë”*.

Në çështjen Mc Farlane kundër Irlandës, kjo gjykatë thekson që, në çështjet penale, nocioni *“kohë e arsyeshme”* e paraparë sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së, fillon të zbatohet sapo një person *“të akuzohet”*, ndërsa nocioni *“akuzë”*, mund të përkufizohet si *“njoftimi zyrtar i dhënë një individit nga autoriteti kompetent për një pretendim se ai ka kryer një vepër penale”*, një përkufizim që gjithashtu korrespondon me kriterin nëse *“gjendja e tij (të dyshuarit) është prekur ndjeshëm”*. Ndërsa në çështjen T. kundër Britanisë së Madhe, kjo gjykatë thekson se nocioni *“afat i arsyeshëm”*, mbulon të gjithë procedurat penale, duke përfshirë edhe procedurat e apelimit dhe përcaktimin e dënimit.

Në çështjen B. kundër Austrisë, kërkuari u akuzua në korrik 1980 dhe u dënua në shkallën e parë në nëntor 1982. Gjykata nga ana e saj vlerësoi se kjo kohëzgjatje nuk përbënte shkelje të nenit 5 § 3. Megjithatë ankimi i tij në apel kundër vendimit që e kishte dënuar nuk mori përgjigje deri në dhjetor 1995. Në lidhje me këtë kohëzgjatje Gjykata vlerësoi se ajo ishte zgjatur në mënyrë të pajustificueshme dhe kështu që përbënte shkelje të nenit 6 të KEDNJ.⁵

Një parim fundamental në procedurë penale është edhe prezumimi i pafajësisë, sipas të cilit, çdo person i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, me vendim të formës së prerë. Sa i përket jurisprudencës së GjEDNJ, ky parim vjen në shprehjen në çështjen Kuzmin kundër Ruisë⁶. Lidhur me këtë, GjEDNJ thekson se është veçanërisht e rëndësishme, në një fazë të hershme, sidomos përpara një aktakuze në kontekstin e procedimeve penale, të mos bëhen akuza publike që mund të interpretohen si konfirmim nga ana e zyrtarëve të lartë që e konsiderojnë individin në fjalë, fajtor.

Prezumimi i pafajësisë si i tillë ngërthen në vete dy nën parime të rëndësishme, njëri prej të cilit është *“in dubio pro reo”*, pra çdo dyshim lidhur me saktësinë e një fakti relevant duhet interpretuar në favor të të akuzuarit dhe se barra e provës bie mbi organin e akuzës. Sipas jurisprudencës së GjEDNJ, ky parim cenohet nëse *“një vendim gjyqësor, që i përket një individit të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk ka ndonjë konkluzion formal mjafton që të ketë një arsytim i cili lë të kuptohet se gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor”*. Në këtë drejtim, në rastin Minelli kundër Zvicrës⁷, Gjykata, u shpreh se *“prezumimi i pafajësisë shkelet nëse, pa u vendosur ligjërisht më parë fajësia e një të akuzuari dhe, në veçanti, pa pasur ky i fundit*

⁵ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti B. kundër Austrisë. nr.11968/86. Aktgjykim. Strasburg. 28 mars 1990.

⁶ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Kuzmin kundër Ruisë. nr.28917/05. Aktgjykim. Strasburg.18 Mars 2010.

⁷ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Minelli kundër Zvicrës. nr.8660/79. Aktgjykim. Strasburg. Aktgjykim. 25 mars 1983.

mundësi për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes, një vendim gjyqësor në lidhje me të pasqyron ndjesinë se ai është fajtor”.

Në kontekstin e një gjykimi të drejtë e të paanshëm ka një rëndësi të madhe fakti nëse vendimi është marrë nga një gjykatë e pavarur. Për të bërë një vlerësim të tillë, GJEDNJ merr në konsideratë: mënyrën e emërimit të anëtarëve të saj; kohëzgjatjen e detyrës së tyre; ekzistencën e garancive kundrejt presioneve të jashtme dhe çështjen nëse organi përfaqëson një dukje të pavarësisë objektive.⁸

Megjithatë, thjesht fakti se një gjyqtar ka marrë pjesë më parë në gjykimin e disa çështjeve kundër të bashkuzuarve të një kërkuesi nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të hedhur dyshime mbi paanësinë e këtij gjyqtari në gjykimin e çështjes kundër kërkuesit. Në vendimin Berhani kundër Shqipërisë⁹, Gjykata pranoi argumentin e Qeverisë se nuk kishte pasur shkelje të paanësisë kur, dy nga tre gjyqtarët, të cilët vendosën mbi themelin në rastit të ankuesit, më parë kishin hedhur poshtë kërkesën e tij për mosrespektim të afateve, pra pa u shprehur mbi themelin. Ndërsa, në çështjen Holm kundër Suedisë¹⁰, Gjykata vendosi se kishte një shkelje të nenit 6 për shkak se anëtarët e jurisë ishin anëtarë të një partie politike me të cilën ishte i lidhur njëri nga të paditurit.

Shkelje të nenit 6 të KEDNJ ka konstatuar GjEDNJ edhe në rastet kur të akuzuarit i është pamundësuar njoftimi në gjuhën që ai e kupton dhe e flet lidhur me akuzën që i vihet në barrë. Në çështjen Brozicek kundër Italisë¹¹, i akuzuari ishte gjerman, i cili shprehu qartë vështirësitë e tij gjuhësore për gjykatën vendase. Në rrethana të tilla, GjEDNJ u shpreh se autoritetet italiane duhet të kishin përkthyer njoftimin, përveç nëse ato do të ishin në pozitë të tillë që të konkludonin se ai e zotëronte mirë gjuhën italiane, që nuk ishte e vërtetë në këtë rast.

Në funksion të realizimit të një procesi ligjor të drejtë, një rol të rëndësishëm luan edhe garantimi i mbrojtjes efektive për të pandehurin. Kushtetuta jonë në nenin 30.5 të saj, ka paraparë mundësinë që i akuzuari të zgjedh mbrojtësin sipas vullnetit të tij, ndërsa në mungesë të mjeteve financiare, ajo ka paraparë ofrimin e ndihmës juridike falas. Lidhur me këtë. GjEDNJ është shprehur se e drejta për tu përfaqësuar vetë nuk është një e drejtë absolute. Në çështjen Croissant kundër Gjermanisë¹², ajo u shpreh se kushti që një i pandehur të asistohet nga një avokat në procesin e gjykatës vendase nuk ishte në pajtim me nenin 6 (3) c. Sipas GjEDNJ, kur i akuzuari ka të drejtën e asistencës ligjore pa pagesë, ai ose ajo ka të drejtë për asistencë ligjore, e cila është praktike, efektive dhe jo thjesht teorike. Lidhur me këtë, GjEDNJ ka përcaktuar se “*në rastet kur është e qartë se avokati që përfaqëson të akuzuarin para*

⁸ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Campell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar nr. 7819/77, Aktgjykim. Strasburg, 28 Qershor 1984,

⁹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Berhani kundër Shqipërisë. nr.847/05. Aktgjykim. Strasburg. 27 maj 2010.

¹⁰ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Holm kundër Suedisë. nr.14191/88. Aktgjykim. Strasburg. 25 nëntor 1993.

¹¹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Brozicek kundër Italisë. nr.10964/84. Aktgjykim. Strasburg. 19 dhjetor 1989

¹² Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Rasti Croissant kundër Gjermanisë, nr. 13611/88, Aktgjykim. Strasburg. 25 shtator 1992.

gjykatës nuk ka pasur kohë dhe lehtësitë që të përgatisë mbrojtjen siç duhet, gjyqtari i çështjes ka detyrimin që të ndërmarra pozitive, për të siguruar që detyrimet ndaj të akuzuarit të përmbushen siç duhet”.

4. Mandati ligjor i Prokurorive dhe Gjykatave në trajtimin e krimeve të përgjithshme

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndërtohet mbi parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit mes tyre. Ky model është adaptuar me qëllim që të realizohet funksionimi i pavarur i secilës nga të tri degët e pushtetit, përkatësisht pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor.

Sa i përket organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se *“Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat”*¹³ dhe se *“Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata”*¹⁴.

Me qëllim të jetësimit në praktikë të këtyre detyrimeve kushtetuese, Kuvendi i Republikës së Kosovës më 22 korrik 2010 kishte miratuar **Ligjin nr. 03/L-199 për Gjykatat**, i cili pjesërisht kishte filluar zbatimin më 1 janar 2011, ndërsa për pjesën tjetër zbatimi i tij fillonte nga 1 janari 2013. Ky ligj kishte ri definuar organizimin e brendshëm dhe strukturën e sistemit gjyqësor, për dallim nga e kaluara. Me kalimin viteve, ky ligj kishte pësuar disa plotësime-ndryshime, fillimisht në vitin 2012, e më pastaj ky ligj ishte shfuqizuar nga ligji i ri për gjykatat, i cili ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019.¹⁵

Ligji për Gjykatat ka përcaktuar se drejtësia në Republikën e Kosovës ofrohet në tri shkallë dhe atë në shkallë të parë në Gjykatë Themelore, në shkallë të dytë në Gjykatën e Apelit, dhe në krye të hierarkisë së gjyqësorit të rregullt qëndron Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Ky ligj ka përcaktuar funksionimin e shtatë gjykatave themelore në territorin e Republikës së Kosovës, të cilat përveç selisë kryesore kanë edhe degët e tyre. Sipas këtij ligji, secila Gjykatë Themelore, përfshi edhe degën e saj, ka Departamentin e Përgjithshëm, derisa në secilën seli të Gjykatës Themelore veprojnë edhe Departamenti i Krimeve të Rënda dhe Departamenti për të Mitur. Ky ligj ka paraparë funksionimin e tri departamenteve tjera të veçanta si pjesë e Gjykatës Themelore të Prishtinës, krahas gjashtë (6) gjykatave tjera, si Departamenti Special me kompetencë për lëndët e PSRK-së, Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike, me juridiksion ekskluziv për tërë territorin e vendit.

Departamenti i Përgjithshëm, sipas legjislationit pozitiv organizohet në tri divizione: Penal, Civil dhe për Kundërvajtje.

Departamenti i Përgjithshëm i GjTh-ve, sipas nenit 20.1 të Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, të cilat nuk hyjnë në kompetencë të departamenteve të tjera. Pra, lëndët për veprat penale të dënueshme nën 10 vite, parimisht gjykohen nga

¹³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 102.1.

¹⁴ Po aty. Neni 102.2

¹⁵ Ligji nr. 06/L - 054 për gjykatat, i miratuar më 23 nëntor 2018.

divizionet penale të departamenteve të përgjithshme, ngase ligji për gjykatat ka përcaktuar se për veprat penale të dënueshme me mbi 10 vite është kompetent Departamenti për Krime të Rënda. Strukturë identike sa i përket organizimit të punës nëpër departamente, ligji ka adoptuar edhe për Gjykatën e Apelit.¹⁶

Gjatë vitit 2019, në të gjitha divizionet penale të GjTh-ve kanë qenë të angazhuar 97.5 gjyqtarë.¹⁷

Funksionin e ndjekjes penale, sipas Kushtetutës tonë e ushtron institucioni i Prokurorit të Shtetit, i cili është edhe kategori kushtetuese. Sipas nenit 109 të Kushtetutës sonë, Prokurori i Shtetit është *“Institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj”*¹⁸. Ndërsa, organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit, sipas Kushtetutës, rregullohen me ligj të veçantë¹⁹.

Për të plotësuar kuadrin ligjor në këtë drejtim, Kuvendi i Republikës së Kosovës më 30 shtator 2010 ka miratuar **Ligjin për Prokurorin e Shtetit**, i cili ka pësuar dy plotësim-ndryshime, gjatë vitit 2015 dhe 2018.²⁰ Ky ligj ka paraparë themelimin e shtatë (7) Prokurorive Themelore me juridiksion mbi të gjitha lëndët e shkallës së parë, Prokurorinë e Apelit për të vepruar para Gjykatës së Apelit, Prokurorisë Speciale, fushëveprimi i së cilës është rregulluar me ligj të veçantë dhe instanca më e lartë është Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKSH), që ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe autorizime të tjera të parapara me këtë ligj.

Ndërsa, për sigurimin e pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit, mos diskriminimit të këtyre institucioneve, Kushtetuta ka paraparë themelimin e mekanizmave të posaçëm dhe të pavarur, që për detyrë kanë administrimin e drejtësisë. Në këtë drejtim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka themeluar si kategori Kushtetuese Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK),²¹ në me kompetencë për të mbikëqyrë punën e sistemit gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK),²² për të mbikëqyrë punën e sistemit prokurorial në Republikën e Kosovës. Për të dy këto institucione, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligje të veçanta.

¹⁶ Ligji për gjykatat. Neni 24.

¹⁷ Sqarim nga KGJK: Kjo statistikë është gjeneruar nga KGJK-ja dhe është pasqyrim i faktit se një gjyqtar i një gjykate ka qenë i angazhuar në dy divizione në të njëjtën kohë.

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 109.1.

¹⁹ Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i miratuar më 30 shtator 2010.

²⁰ Ligji Nr. 03/L-225 Për Prokurorin e Shtetit, ndryshuar me ligjet nr.05/L-034 dhe nr. 06/L-025.

²¹ Ligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i miratuar më 23 nëntor 2018.

²² Ligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i miratuar më 7 mars 2019.

5. Ngarkesa totale me lëndë e divizioneve penale të gjykatave themelore

Në vitin 2018, të gjitha divizionet penale të departamenteve të përgjithshme në kuadër të gjykatave themelore që vepron në Republikën e Kosovës, nga viti paraprak kishin trashëguar 42,116 lëndë, ndërsa kishin pranuar 22,300 lëndë të reja, duke bërë që të kishin në punë 64,416 lëndë në total.

Nga ky total, këto gjykata kishin arritur të zgjidhin 24,278 lëndë, kurse 40,118 kishin mbetur të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. Kjo lë të kuptohet se gjatë vitit 2018, departamentet e përgjithshme të të gjitha gjykatave kishin zgjidhur **37.7%** të lëndëve në punë, duke lënë të pazgjidhura rreth **62.3%** të lëndëve.

Duke vepruar në këtë mënyrë, divizionet penale të të gjitha gjykatave themelore gjatë vitit 2018 kishin zgjidhur 1,978 lëndë më shumë se sa që kanë pranuar. Kjo diferencë në mes të lëndëve të zgjidhura dhe atyre të pranuar paraqet diferencën e lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti.

Ndërsa, gjatë vitit 2019, DP-të e GjTh-ve kanë trashëguar 40,118 lëndë nga viti paraprak, i kanë pranuar 20,343 lëndë të reja, derisa kanë pasur në punë gjithsej 60,461 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 27,192 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 33,257 lëndë. Pra, gjatë vitit 2019, DP-të e Gjykatave Themelore kanë zgjidhur **45%** të lëndëve që kanë pasur në punë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe **55%** të lëndëve.

Kryesuesi i KGJK-së, Skënder Çoçaj, në një përgjigje të dhënë për këtë raport, ka deklaruar se ngarkesa dhe numri i madh i lëndëve janë shkaqet kryesore që numri i lëndëve të pazgjidhura në DP-të e gjykatave themelore, për vitet 2018 dhe 2019 të jetë më i lartë se i atyre të zgjidhura.

“Shkaqet që kanë ndikuar që numri i lëndëve të pazgjidhura në DP-të e gjykatave themelore, gjatë vitit 2018 dhe 2019 të jetë më i lartë sesa i atyre të zgjidhura është se gjykatat janë të ngarkuara nga numri i madh i lëndëve” ka thënë Çoçaj.²³

Tutje, ai ka theksuar se KGJK-ja ka ndërmarrë të gjitha veprimet që i ka në kompetencë për të përmirësuar efikasitetin e gjykatave në zgjidhjen e lëndëve, fillimisht duke përmirësuar kushtet e punës nëpër gjykata, pastaj plotësimin e vendeve të lira të punës si për gjykatës ashtu edhe për stafin administrativ.


Në këtë mënyrë, divizionet penale të të gjitha gjykatave themelore gjatë vitit 2019 kanë zgjidhur 6,849 lëndë më shumë se sa që kanë pranuar, i cili numër paraqet shkallët e rënies së numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti.

²³ Përgjigje nga Kryesuesi i KGJK-së, Skënder Çoçaj, për IKD. 12.11.2020

Lëndët	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura
2018	42,116	22,300	64,416	24,278	40,118
2019	40,118	20,343	60,461	27,192	33,257

Tabela 1. Ngarkesa totale me lëndë në Divizionet Penale të Gjykatave Themelore për vitet 2018 dhe 2019.

Pra nga këto statistika shihet se divizionet penale për dallim nga fundi i vitit 2018, vitin 2019 e kanë përmbyllur me 6,849 lëndë më pak. Në këtë statistikë, kanë ndikuar dy faktorë, e që janë ulja e numrit të lëndëve të pranuar gjatë vitit 2019 dhe ngritja e numrit të lëndëve të zgjidhura gjatë këtij viti.



Grafika 1. Lëndët e zgjidhura dhe të pazgjidhura nga Divizionet Penale të Gjykatave Themelore për vitet 2018 dhe 2019.

Me këtë rast, IKD gjen se një trend i tillë gjatë vitit 2019 paraqet një trend pozitiv në kuptim të reduktimit të numrit të lëndëve të pazgjidhura që barten vit pas viti. Kjo për arsye se me një trend të tillë, divizioneve penale u nevojiten më pak se pesë (5) vite për të zgjidhur lëndët të cilat barten vit pas viti, dhe për tu kthyer në funksion të zgjidhjes së lëndëve që pranohen at vit, drejt arritjes së stabilitetit me lëndë në këto divizione.

5.1 Ngarkesa me lëndë e DP-ve sipas gjykatave themelore

Krahas shtatë gjykatave themelore që gjykojnë lëndë në shkallë të parë, divizioni penal i GjTh-së në Prishtinë kishte numrin më të madh të lëndëve penale në punë, qoftë në vitin 2018 me gjithsej 26,246 lëndë, ashtu edhe për vitin 2019, me 23,996 lëndë, ndërsa numrin më të vogël të lëndëve penale e ka pasur GjTh në Gjakovë, me 4,829 lëndë në punë në vitin 2018 dhe 4,379 lëndë penale në vitin 2019.

Bazuar në numrin e lëndëve në punë, përqindjen më të madhe të lëndëve të zgjidhura për vitin 2018 e kishte GjTh-ja e Pejës me gjithsej **51%** apo 2,540 lëndë të zgjidhura, ndërsa për vitin 2019, GjTh-ja e Prizrenit me **56%** apo 3,872 lëndë të përfunduara.

Ndërsa përqindjen më të ulët në kryerjen e lëndëve për vitin 2018 e kishin DP-ja në Prishtinë dhe ajo në Mitrovicë me nga **33%** të lëndëve të zgjidhura, dhe në vitin 2019, përqindjen më të ulët në këtë rrafsh e ka sërish GjTh në Prishtinë, me vetëm **40%** të lëndëve të zgjidhura gjatë asaj periudhe.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyqi, në një përgjigje për IKD-në lidhur me këtë raport, ka thënë se kjo përqindje nuk ka të bëjë me performancën, duke theksuar se *“Matja e performancës nuk mund të vlerësohet nëse bazë krahasuese merret numri i lëndëve në punë në fillim të vitit dhe numri i lëndëve të mbetura në fund vit, për faktin se kjo kryekëput varet nga numri i lëndëve që pranohen në gjykatë në raport me numrin e gjyqtarëve që gjykojnë në këtë divizion”*.²⁴

Por, sa i përket numrit të lëndëve të zgjidhura, në këtë rrafsh prinë GjTh në Prishtinë me 8,667 lëndë të zgjidhura, derisa GjTh me numrin më të vogël të lëndëve të zgjidhura është GjTh në Mitrovicë, me gjithsej 1,734 lëndë të zgjidhura.

Bazuar në të dhënat që figurojnë në tabelën e mëposhtme, mund të vërejmë se në raport me vitin 2018, në vitin 2019 është rritur ndjeshëm numri i lëndëve të zgjidhura dhe ka rënë numri i lëndëve të pazgjidhura në të gjitha Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës.

²⁴ Përgjigje nga Kryetarja e GjTh në Prishtinë, Afërdita Bytyqi, për IKD. 09.10.2020.

	2018					2019				
	Në punë	Të zgjidhura	Përqindja %	Te pazgjidhura	Përqindja %	Në punë	Te zgjidhura	Përqindja %	Te pazgjidhura	Përqindja %
Prishtinë	26246	8667	33%	17573	67%	23996	9551	40%	14445	60%
Mitrovicë	5213	1734	33%	3479	67%	6980	3237	46%	3740	54%
Gjilan	6651	2638	40%	4013	60%	6189	2670	43%	3519	57%
Ferizaj	8136	2919	36%	5215	64%	7358	3336	45%	4020	55%
Pejë	5030	2540	51%	2483	49%	4700	2422	52%	2273	48%
Prizren	8311	3848	46%	4463	54%	6859	3872	56%	2987	44%
Gjakovë	4829	1932	40%	2892	60%	4379	2104	48%	2273	52%

Tabela 2. Ngarkesa me lëndë dhe efikasiteti i DP-ve të gjykatave themelore për vitet 2018 dhe 2019.

Në gusht të vitit 2013, KGJK-ja kishte miratuar Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra. Në parathënie të kësaj strategjie thuhej decidivisht se “reduktimi i lëndëve të vjetra është një nga çështjet më kritike me të cilat përballet gjyqësori i Kosovës.”²⁵

Ndërsa, në vitin 2014, KGJK kishte miratuar Planit Strategjik të Gjyqësorit të Kosovës për vitet 2014-2019. Në këtë Plan Strategjik është inkorporuar edhe Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra, për zbatimin e së cilës strategji, ishin parë veprime shtesë. Ndër të tjera, në këtë drejtim, kjo strategji ka paraparë “Krijimi i procedurave dhe mjeteve, përfshirë analizën e rëndësisë së lëndëve, për t’i analizuar nevojat e gjyqtarëve dhe gjykatave dhe për t’i miratuar aktet nënligjore përkatëse” dhe “Shpërndarja periodike e gjyqtarëve duke u bazuar në numrin e lëndëve”.

Po ashtu, për reduktimin e numrit të lëndëve, KGJK në këtë strategji kishte përcaktuar “Zhvillimin e një hulumtimi për të përcaktuar nëse ankesat e shumta që i parashtrihen Gjykatës së Apelit po e shtojnë pa arsye zgjidhjen përfundimtare të lëndëve” dhe “Caktimin e standardeve për afatet kohore për kryerjen e lëndëve dhe caktimi i procedurës standarde të shpërndarjes së lëndëve”.²⁶

²⁵ “Strategjia Kombëtare për reduktimin e lëndëve të vjetra”. KGJK. Gusht 2013 (<https://www.gjyqesori-ks.org/wp-content/uploads/2019/03/Strategjia-kombetare-per-reduktimin-e-lendeve-te-vjetra.pdf>). Qasur së fundi më 2 maj 2020).

²⁶ Hashani, G. Thaqi, M. “Krimet e përgjithshme në Kosovë, ligji vs praktika”. Prishtinë. Nëntor. F.13. 2019 (Shih linkun <https://kli-ks.org/krimet-e-pergjithshme-ne-kosove-ligji-vs-praktika/>). (Qasur së fundi më 2 maj 2020).

Në përgjigjen e dhënë për IKD-në, sa i përket efikasitetit të kësaj strategjie, kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj ka theksuar se *“Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra ka ndikuar pozitivisht dhe si rezultat i saj janë kryer shumë lëndë të vjetra”*.²⁷

Sa i përket departamenteve të përgjithshme, KGJK nuk ka ndërmarrë asnjërin prej këtyre veprimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit të kësaj strategjie.

5.2 Ngarkesa dhe mënyra e kryerjes së lëndëve në DP të GjTh-ve sipas kategorive të veprave penale

Gjatë vitit 2018, DP-të e GjTh-ve më së shumti kanë qenë të ngarkuara me lëndë nga kapitulli i veprave penale kundër jetës dhe trupit (12,366 lëndë në punë). Ndërsa, sa i përket zgjidhjes së lëndëve, gjatë vitit 2018 gjyqtarët e DP-ve të GjTh-ve më së shumti kanë zgjidhur lëndë nga kapitulli i veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik (gjithsej 5,700 lëndë të zgjidhura)²⁸.

Edhe në vitin pasues, veprat penale kundër jetës dhe trupit e kanë përmbushur numrin më të madh të ngarkesës së DP-ve të gjykatave themelore (12,393), pasuar me 11,212 lëndë të veprave penale kundër shërbimeve komunale.

Sa i përket lëndëve të zgjidhura për vitin 2019, ashtu si në vitin paraprak, gjykatësit e DP-ve, kanë arritur të zgjidhin më së shumti lëndë nga kategoria e veprave kundër sigurisë së trafikut publik me 6,527 lëndë, pasuar me lëndë nga kapitulli i veprave penale kundër jetës dhe trupit (5,787 lëndë të zgjidhura).

Ndërsa, gjykatësit e këtij departamenti gjatë vitit 2019, më së paku lëndë kanë arritur të zgjidhin nga kategoria e veprave kundër të drejtave të votimit me gjithsej katër (4) lëndë të zgjidhura nga 84 sosh në punë, pasuar nga ato të veprave penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare (5 lëndë të zgjidhura nga 46 lëndë në punë).

²⁷ Përgjigje nga Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj, për IKD. 12.11.2020.

²⁸ Hashani, Gzime; Thaqi, Mirvet: “Krimet e Përgjithshme në Kosovë”, Prishtinë. Nëntor 2019. F.15 (Shih linkun <https://kli-ks.org/krimet-e-pergjithshme-ne-kosove-ligji-vs-praktika/>). (Qasur së fundi më 2 maj 2020).


Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura	Lëndë në kompetencë të gjykatës
Kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës	138	111	249	124	125	0
Kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare	42	4	46	5	41	0
Kundër jetës dhe trupit	7287	5106	12393	5787	6602	4
Kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut	194	55	249	72	177	0
Kundër të drejtave të votimit	77	7	84	4	80	0
Kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	32	4	36	13	23	0
Kundër integritetit seksual	196	73	269	50	219	0
Kundër martesës dhe familjes	128	178	306	111	195	0
Kundër shëndetit publik	101	98	199	49	150	0
Narkotikë	1537	1122	2659	1156	1502	1
Krimi i organizuar	0	0	0	0	0	0
Kundër ekonomisë	793	848	1641	319	1322	0
Kundër shërbimeve komunale	7869	3343	11212	5242	5968	2
Kundër pasurisë	7687	2814	10501	3748	6751	2
Kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore	2390	1262	3652	1364	2288	0
Kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	474	283	757	265	491	1
Armët	1104	1235	2339	796	1543	0
Kundër sigurisë së trafikut publik	5846	2109	7955	6527	1427	1
Kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike	1450	678	2128	591	1536	1
Kundër rendit publik	1997	485	2482	708	1774	0
Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	248	62	310	62	248	0
Totali	40,118	20,343	60,461	27,192	33,257	12

Tabela 3. Ngarkesa me lëndë e DP-ve të Gjykatave Themelore sipas kapitujve të Kodit Penal për vitin 2019.

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së lëndëve për vitin 2018, rezulton se gjykatësit e DP-ve dënimin që më së shpeshti e kanë shqiptuar gjatë asaj periudhe raportuese ka qenë dënimi me

gjobë (7,929 raste), pastaj ai me kusht (7,478 raste), dhe vetëm në 848 raste kanë dhënë dënime me burgim efektiv ndërsa 805 janë dënime të tjera.²⁹

Pra shikuar në përqindje, këto dënime të shqiptuara nga DP-të e gjykatave themelore, nga 17,060 dënimeve në total, prej tyre janë shqiptuar 46.48% dënime me gjobë, 43.83% me kusht, ndërsa 4.97% të dënimeve janë me burgim dhe 4.72% dënime të tjera.



Grafiku 1. Përqindja e dënimeve të shqiptuara nga Gjykatat Themelore të RKS-së në vitin 2018.


Gjithashtu, këta gjykatës në 289 raste kanë nxjerrë aktgjykime liruese, ndërsa në 943 raste aktgjykime refuzuese. Kurse 3,019 lëndë janë zgjidhur në mënyrë tjetër.³⁰

Një praktikë e ngjashme, sa i përket dënimeve të aplikuara pasqyrohet edhe në vitin 2019, ku dënimi më i shpeshtë i shqiptuar nga DP-të e GjTh-ve ishte ai me gjobë në gjithsej **7,585** raste apo 49.39%, pasuar në dënimin me kusht me **6,182** raste apo 40.26%, në **1,019** raste apo 6.64% është shqiptuar dënimi me burgim efektiv, si dhe janë shqiptuar edhe **571** dënime të tjera apo shprehur në përqindje 3,72% .

²⁹ Hashani, Gzime; Thaqi, Mirvet: “Krimet e Përgjithshme në Kosovë”. Prishtinë. Nëntor. 2019. F.16 (Shih linkun <https://kli-ks.org/krimet-e-pergjithshme-ne-kosove-ligji-vs-praktika/>). (Qasur së fundi më 2 maj 2020).

³⁰ Po aty. F. 17.

Dënimet e shqiptuara nga Gjykatat Themelore në vitin 2019



Grafiku 2. Përqindja e dënimeve të shqiptuara nga Gjykatat Themelore të RKS-së në vitin 2019.

Në këtë divizion të gjykatave themelore janë nxjerrë edhe 273 aktgjykime liruese si dhe 1,247 aktgjykime refuzuese, ndërsa, 7,945 raste janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

IKD për vitin 2018 kishte paraqitur si statistikë shqetësuese parashkrimin e lëndëve në sistemin e drejtësisë. Në vitin 2018, në 2,843 lëndë kishte arritur afati i parashkrimit, ku prej tyre 2,663 raste kishin arritur parashkrimin absolut, ndërsa 180 raste të tjera parashkrimin relativ. Sipas llogaritjeve të bëra, rezulton se mesatarisht në vitin 2018 për çdo ditë janë parashkruar 7.7 lëndë, ndërsa në muaj janë parashkruar gjithsej 237 lëndë penale.³¹

Një trend i tillë ka përcjellë drejtësinë edhe gjatë vitit 2019, ku gjithsej janë parashkruar 2,370 lëndë në tërë gjykatat themelore. Prej tyre, 2,228 lëndë kishin arritur parashkrimin absolut, ndërsa 142 raste parashkrimin relativ.

Shprehur në mesatare, del se brenda vitit 2019, në çdo ditë kalendarike kanë arritur të parashkruhen mesatarisht 6,49 lëndë, e që në muaj i bie të jenë parashkruar 197,5 lëndë penale.

Edhe pse vërehet se kjo dukuri negative ka pasur një rënie të lehtë nga viti i kaluar, duhet të kemi parasysh se sistemit tonë të drejtësisë gjatë 2019 i janë bashkuar edhe 17.5 gjyqtarë të rinj, e që ky numër është dashur të ndikojë dukshëm në uljen e numrit të lëndëve të parashkruara, që paraqesin një problem thelbësor në sistemin kosovar të drejtësisë.

³¹ Po aty, F.17.

Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Dënim me burgim	Me gjobë	Me kusht	Aktgjykim liris	Refuzues	Dënime tjera	Është zgjidhur në mënyrë tjetër	Parashkrim absolut	Parashkrim relativ
Kundër rendit kushtetues dhe sigurisë	0	67	23	2	3	2	25	2	0
Kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare	2	2	0	0	1	0	0	4	0
Kundër jetës dhe trupit	262	1868	1659	53	255	169	961	518	42
Kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	3	17	18	3	5	0	14	11	1
Kundër të drejtave të votimit	0	1	0	0	0	0	3	0	0
Kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	0	4	3	2	0	0	3	1	0
Kundër integritetit seksual	14	12	13	2	3	0	3	3	0
Kundër martesës dhe familjes	12	22	37	2	3	0	24	10	1
Kundër shëndetit publik	4	17	15	4	1	1	4	3	0
Narkotikë	34	771	242	1	6	11	41	35	15
Krimi i organizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kundër ekonomisë	24	137	69	4	10	6	37	32	0
Kundër shërbimeve komunale	15	788	1566	47	338	67	1949	444	28
Kundër pasurisë	397	907	864	68	175	108	610	593	26
Kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore	23	516	312	22	62	47	233	148	1
Kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	16	69	82	10	12	10	36	27	3
Armët	11	470	192	9	11	8	81	11	3
Kundër sigurisë trafikut publik	113	1417	645	21	329	106	3685	199	12
Kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike	25	229	149	9	17	13	87	58	4
Kundër rendit publik	39	186	204	10	15	17	113	118	6
Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	2	31	18	0	0	2	7	2	0
Totali	1019	7585	6182	273	1247	571	7945	2228	142

Tabela 4. Mënyrat e kryerjes së lëndëve në vitin 2019, sipas kategorive të veprave penale në Kodin Penal.

5.3 Ngarkesa dhe mënyra e zgjidhjes së lëndëve në DP të Gjykatës së Apelit

Sipas raportit vjetor statistikor për punën e gjykatave për vitin 2018, në Gjykatën e Apelit, nga viti paraprak janë trashëguar 379 lëndë penale të departamentit të përgjithshëm, janë pranuar 1,356 lëndë të reja, duke pasur në punë gjithsej 1,735 lëndë, nga të cilat kanë arritur të zgjidhen 1,443 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura vetëm 292 lëndë.

Pra, gjatë vitit 2018, DP-ja e Gjykatës së Apelit ka zgjidhur **83.17%** të lëndëve që ka pasur në punë, duke lënë të pazgjidhura **16.83%** të lëndëve

Gjithashtu, nëse marrim totalin e lëndëve të pranuar në punë gjatë vitit 2018 dhe numrin e lëndëve të zgjidhura nga DP-ja e GjA-së gjatë kësaj periudhe, del se kjo gjykatë ka zgjidhur 87 lëndë më shumë se sa ka pranuar.

Ndërsa sa i përket vitit 2019, DP-ja e GjA-së ka trashëguar 292 lëndë nga viti paraprak, ndërsa ka pranuar 1,657 lëndë të reja. Pra në total ky departament ka pasur 1,949 lëndë penale e me ç'rast ka arritur të zgjidh 1,558 lëndë nga to e që në fund të vitit kanë mbetur 391 lëndë të pazgjidhura.

Nga kjo mund të kuptohet se gjatë vitit 2019, departamenti i përgjithshëm i kësaj gjykate ka zgjidhur **79.94%** të lëndëve në punë, duke lënë të pazgjidhura rreth **20.06%** të lëndëve.

Në këtë mënyrë, divizioni penal i Gjykatës së Apelit gjatë vitit 2019 ka zgjidhur 99 lëndë më pak se sa që ka pranuar në punë, i cili numër paraqet rënien e efikasiteti të punës në këtë departament, krahas edhe vitit paraprak.

Lëndët	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura
2018	379	1356	1735	1443	292
2019	292	1657	1949	1558	391

Tabela 5. Numri i lëndëve të trashëguara, të pranuar, në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura nga divizioni penal i Gjykatës së Apelit për vitet 2018 dhe 2019.

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së lëndëve penale nga GjA gjatë vitit 2018, janë gjithsej 78 ankesa të hedhura poshtë nga kjo gjykatë, 976 vendime të shkallës së parë janë vërtetuar, 187 vendime janë abroguar dhe 202 vendime penale të shkallës së parë janë ndryshuar.

Situatë e ngjashme paraqitet edhe gjatë vitit 2019, ku gjatë këtij viti GjA ka hedhur poshtë 61 ankesa penale të ushtruara ndaj vendimeve të shkallës së parë, 977 vendime të gjykatave themelore janë vërtetuar, 307 vendime janë abroguar dhe 213 aktgjykime të nxjerra në shkallë të parë janë ndryshuar.

	Ankesa është hulumtuar	Është vërtetuar	Është abroguar			Është ndryshuar			
			Për shkak të konstatimit jo të plotë ose të gabueshëm të gjendjes faktike	Për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale	Për shkak të paraqitjes së provave dhe fakteve të reja	Për shkak të shkeljes së ligjit penal	Për arsye tjera	Denimi- masa	
								Është ashpërsuar	Është zbutur
2018	78	976	1	186	0	0	76	51	75
2019	61	977	12	294	1	0	59	47	107

Tabela 6. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve penale në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës së Apelit për vitet 2018 dhe 2019.

6. Ngarkesa me lëndë në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorive Themelore gjatë vitit 2019

Në vitin 2018, DP-të e PTh-ve, kanë trashëguar nga viti paraprak 105,590 lëndë, ndërsa kanë pranuar 45,212 lëndë të reja, ku gjithsej kanë pasur në punë 150,802 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 58,623, ndërsa 92,179 e të gjitha lëndëve kanë mbetur pa u zgjidhur në fund të vitit 2018³².

Ndërkaq, sipas raporteve zyrtare të Prokurorit të Shtetit, DP-të e PTh-ve, gjatë vitit 2019 kanë trashëguar nga viti paraprak 97,205 lëndë, ndërsa kanë pranuar edhe 39,829 lëndë të reja, ashtu që gjithsej në punë kishin pasur 137,034 lëndë, prej të cilave i kishin zgjidhur 62,185, ndërsa si të pazgjidhura u kishin mbetur 74,849 e lëndëve.³³

Sipas këtyre të dhënave, DP-të e PTh-ve gjatë vitit 2019 kanë pasur një efikasitet më të mirë në zgjidhjen e lëndëve, derisa edhe numri i lëndëve të pranuar ka qenë konsiderueshëm më i ulët, çfarë ka ndikuar që numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2019 të jetë relativisht më i ulët në raport me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2018. Përkatësisht, për këto arsye, në fund të vitit 2019, numri i lëndëve të pazgjidhura që barten në vitin tjetër është 17,330 më i ulët se sa numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2018.

Gjatë vitit 2019, DP e PTh-ve, kanë arritur të zgjidhin 22,356 lëndë më shumë se sa që kanë pranuar, dhe kjo diferencë është më pozitive gjatë këtij viti, nëse krahasohet me vitet paraprake. Përkatësisht, gjatë vitit 2019, kjo diferencë është ngritur për 8,945 lëndë më shumë të zgjidhura.

Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, në një përgjigje për këtë raport ka deklaruar se trajtimi i lëndëve të pazgjidhura që barten vit pas viti ishte paraparë me planin strategjik të sistemit prokurorial, dhe se aktualisht brenda institucionit që ai udhëheq janë duke u bërë vlerësime përkritazi me këtë.

“Në Planin Strategjik të Sistemit Prokurorial 2019-2021 është paraparë trajtimi i rasteve të bartura (lëndëve të pazgjidhura që trashëgohen vit pas viti), si dhe masat që duhet zbatuar për të trajtuar këto lëndë. Aktualisht janë bërë vlerësime dhe janë hartuar raportet përkatëse për lëndët me kryes të panjohur, rasteve të parashkruara, janë bërë transferime të prokurorëve në bazë të ngarkesës me lëndë si dhe do të zbatohen masat tjera të përcaktuara me Planin Strategjik” ka deklaruar Hyseni.³⁴

Sipas këtyre të dhënave, rezulton se nëse DP e PTh-ve vazhdojnë me këtë trend të punës, atëherë për të përfunduar të gjitha lëndët të cilat barten vit pas viti, këtyre departamenteve u nevojiten afërsisht edhe më pak se tri (3) vite e gjysmë.

Hashani, Gzime; Thaqi, Mirvet: “Krimet e Përgjithshme në Kosovë”. Prishtinë. Nëntor. 2019. F.23 (Shih linkun <https://kli-ks.org/krimet-e-pergjithshme-ne-kosove-ligji-vs-praktika/>). (Qasur së fundi më 2 maj 2020).

³³ Raporti i Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2019. F. 42-54. (Qasur së fundi më 2 maj 2020).

³⁴ Përgjigje nga Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, për IKD. 23.07.2020.

Numri i lëndëve	Të Trashëguara		Të Pranuara		Gjithsej në Punë		Të Zgjidhura		Të Pazgjidhura	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Viti	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Prishtinë	41,198	44,559	15,008	13,084	56,206	57,643	11,647	17,973	44,559	39,670
Gjilan	2,790	2,169	3,461	3,417	6,251	5,586	4,082	4,035	2,169	1,551
Prizren	10,593	10,648	6,972	5,261	17,565	15,909	10,676	5,951	6,889	9,958
Pejë	18,413	16,525	5,697	5,504	24,110	22,029	7,585	19,830	16,525	2,199
Ferizaj	14,477	12,812	4,756	4,078	19,233	16,890	7,666	6,534	11,567	10,356
Gjakovë	4,906	6,196	2,869	2,801	7,775	8,997	4,502	3,632	3,273	5,365
Mitrovicë	13,213	4,296	6,449	5,684	19,662	9,980	12,465	4,230	7,197	5,750
Gjithsej	105,590	97,205	45,212	39,829	150,802	137,034	58,623	62,185	92,179	74,849

Tabela 7. Ngarkesa e DP-ve të PTH-ve me lëndë gjatë vitit 2018 dhe 2019.

Nga shtatë DP-të e PTh-ve, numrin më të madh të lëndëve në punë për vitin 2018 dhe 2019, e ka pasur PTh në Prishtinë, ku gjatë vitit 2018 kjo prokurori ka pasur 56,206 lëndë në punë, ndërsa më 2019 ka pasur 57,643 lëndë, ndërsa numrin më të vogël të lëndëve në punë e kishte PTh në Gjilan me 6,251 lëndë në vitin 2018, dhe me 5,586 lëndë në vitin 2019.


Kurse, efikasitetin më të lartë në zgjidhjen e lëndëve, në raport me numrin e lëndëve të pranuar, gjatë vitit 2018 e kishte PTh e Mitrovicës e cila përballë 6,449 lëndëve të pranuar ka arritur të zgjidhë 12,465, që paraqet shkallën e efikasitetit prej 193%, derisa në vitin 2019 performancën më të mirë në zgjidhjen e lëndëve e kishte PTh e Pejës e cila nga 5,504 lëndë të pranuar ka arritur të zgjidhë 19,830 lëndë, që paraqet shkallën e efikasitetit prej 360%.

Ndërsa, efikasitetin më të ulët në zgjidhjen e lëndëve krahas atyre të pranuar gjatë vitit 2018 e ka pasur PTh në Prishtinë, e cila nga 15,008 lëndë të pranuar ka arritur të zgjidhë vetëm 11,647 lëndë apo 78%, ndërsa në vitin 2019 performancën më të dobët e ka pasur PTh në Mitrovicë, ku nga 5,684 lëndë të pranuar, DP i kësaj prokurorie ka arritur të zgjidhë vetëm 4,230 apo 74.41% të lëndëve të pranuar.

Kryeprokurori i PTh në Mitrovicë, Shyqyri Sylja, në përgjigjen përkitazi me gjetjet e sipër theksuara, ka thënë se viti 2019 kishte qenë një vit i suksesshëm i punës, dhe prokurorët e PTh në Mitrovicë janë angazhuar maksimalisht në ngritjen e efikasitetit të punës së tyre.

“Prokurorët janë të angazhuar maksimalisht në rritjen e efikasitetit të punës së tyre e që nuk ka munguar as në vitin 2019 dhe unë e konsideroj si një vit shume të suksesshëm të punës në krahasim me kushtet dhe rrethanat në të cilat vepron kjo prokurori. Jam i bindur se diferenca me lendet e kryera në prokuroritë tjera është për faktin se prokuroritë tjera kanë numër më të madh të prokuroreve, lende me pak të pranuar se në dhe numrin e gjykatave në të cilat përfaqësojnë e kanë shume më të vogël si dhe diferencën e largësisë gjeografike (përjashto

Prishtinën). Për fat të keq në këtë vit që po vijojmë efikasiteti do të jetë më i vogël për shkak të gjendjes me Pandeminë Covid-19 dhe punës me orar të reduktuar, kështu që me siguri se edhe planifikimi i jone nuk do të realizohet për këtë vit” ka thënë Sylja.³⁵



Grafiku 3. Efikasiteti në zgjidhjen e lëndëve në bazë të lëndëve të pranura dhe atyre të zgjidhura për shtatë Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2019.

Këto të dhëna, IKD i ka siguruar nga raportet zyrtare të Prokurorit të Shtetit, të prezantuara dhe të miratuara nga KPK-ja. Mirëpo nga të dhënat të cilat janë paraqitur në këto raporte, IKD vlerëson se është e pamundur që të arrihet në përfundime precize lidhur me trendin e efikasitetit të Prokurorit të Shtetit, për shkak të paqartësive numerike në këto raporte.

Raportet statistikore duhet të përpilohen duke ndjekur një logjikë të atillë që fundi i një periudhe raportuese duhet të korrespondojë me fillimin e periudhës raportuese vijuese, gjë që nuk ndodhë në raportet statistikore të Prokurorit të Shtetit. Një kritikë e tillë, ishte adresuar edhe në raportin që IKD kishte publikuar vitin e kaluar, i cili raport kishte të bënte me punën e DP-vë të Prokurorive Themelore për vitin 2018. Përkundër kësaj, kjo gjetje e IKD-së nuk është adresuar nga sistemi prokurorial.

Në këtë rast, IKD vlerëson se kjo mungesë e vullnetit të sistemit prokurorial për të adresuar këtë çështje shpërfaq mungesën e vullnetit të këtij sistemi në dy (2) dimensione.

Dimensioni i parë që shpërfaqët në këtë rast është mos interesimi i ngritjes së efikasitetit. Për ngritjen e efikasitetit, për secilin menaxher, parakusht esencial është skanimi i gjendjes në të gjitha prokuroritë, i cili skanim konsiston para së gjithash në numrin e saktë të lëndëve në të gjitha prokuroritë. Mungesa e statistikave të sakta të sistemit prokurorial ndikon drejt për së drejti në politika jo adekuate për ngritjen e efikasitetit, derisa mungesa e vullnetit për të adresuar problemet statistikore paraqet edhe mungesë të vullnetit për politika kualitative për ngritjen e efikasitetit në punën e Prokurorit të Shtetit.

³⁵ Përgjigje Kryeprokurorit të PTh në Mitrovicë, Shyqyri Sylja, për IKD. 08.10.2020.

Dimensioni i dytë që shpërfaqet në këtë rast është raporti i sistemit prokurorial me publikun. Në këtë dimension, sistemi prokurorial duhet ta ketë parasysh se një ndër parimet kryesore që duhet ta udhëheqë punën e këtyre institucioneve është transparenca, e cila transparenca nuk mund të zhvillohet me të dhëna jo precize. Për këtë arsye, paqartësitë e vazhdueshme në raportet statistikore të Prokurorit të Shtetit domosdoshmërisht se krijojnë paqartësi edhe tek opinioni publik, tek i cili është interesi për tu njoftuar mbi trendet, punën dhe efikasitetin e sistemit prokurorial.

Për këtë arsye, IKD i rekomandon edhe njëherë sistemit prokurorial që të adresojë problemet në raportet e saja vjetore, dhe të paraqesë të dhëna të sakta, përmes të cilave kuptohet drejtë trendi, puna dhe niveli i efikasitetit të punës së Prokurorit të Shtetit.

Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, në një përgjigje të dhënë për këtë raport ka deklaruar se metodologjia e ndryshme e zbatuar nga prokuroritë sa i përket raportimit për lëndët e zgjidhura, ka ndikuar që të ketë diferencë sa i përket numrit të lëndëve të pazgjidhura në fundit të vitit 2018 dhe numrit të lëndëve të bartura nga viti 2018 në vitin 2019.

*“Diferenca e lëndëve-kallëzimeve penale në mes të lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2018 dhe numrit të lëndëve të bartura nga vitit 2018 në vitin 2019, është për faktin se disa prokurori kanë aplikuar metodologji të ndryshme rreth raportimit për lëndët e zgjidhura. Në vitin 2019 KPK ka qartësuar këtë situatë me akt normativ dhe kjo ka ndikuar që këto prokurori gjatë vitit 2019 t'i korrigjojnë raportet e tyre” ka thënë Hyseni.*³⁶

6.1. Ngarkesa me lëndë në DP-të e PTh-ve sipas kategorive të veprave penale dhe mënyra e kryerjes së lëndëve gjatë vitit 2019

PSH-ja dhe KPK-ja, nuk disponojnë statistika sa i përket ngarkesës me lëndë sipas kategorive të veprave penale, përjashtimisht të një numri të vogël të tyre.

Edhe me këtë rast, si në arsyetimin paraprak, sistemi prokurorial nuk i ka të njohura specifikat e ngarkesës me lëndë sipas kategorive të veprave penale, derisa për këto specifika, nuk njoftohet as publiku.

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së rasteve, sipas raporteve zyrtare të Prokurorit të Shtetit, rezulton se DP-të e PTh-ve, gjatë vitit 2019, kanë ngritur 11,690 aktakuza të drejtpërdrejta, ndërsa kanë hedhur 6,680 kallëzime penale, kanë ngritur 4,794 aktakuza me kërkesë për urdhër ndëshkimor si dhe në 99 raste kanë propozuar shqiptimin e masave të trajtimit të detyrueshëm.

Po ashtu gjatë vitit 2019, DP e PTh-ve, kanë pasur 10,539 raste nën hetime, ku pas zhvillimit të hetimeve janë ngritur 5,970 aktakuza, ndërsa në 991 raste hetimet kanë pushuar, dhe në 51 raste janë pezulluar hetimet, ndërsa kanë paraqitur edhe 1,125 kërkesa për caktimin e paraburgimit.

³⁶ Përgjigje nga Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, për IKD. 23.07.2020.

Sipas raportit zyrtar të punës së prokurorit të shtetit gjatë viti 2019³⁷, bazuar në aktakuzat e DP-ve të PTh-ve, rezulton se gjykatat kanë marrë 21,550 vendime gjyqësore, prej të cilave 12,779 apo 59,30% janë aktgjykime dënuese, 803 apo 3,72% aktgjykime refuzuese, prej të cilave 24 kanë përfunduar për shkak të arritjes së parashkrimit, 236 apo 1,10% aktgjykime liruese, në 2,829 apo 13,13% të rasteve gjykatat kanë hedhur aktakuzat derisa në 4,787 apo 22,21% të rasteve gjykatat kanë shqiptuar urdhër ndëshkimor dhe në 116 apo 0,54% të rasteve është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm.

Llojet e vendimeve gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorëve	Viti 2019	
	Numri i Aktgjykimeve	Shprehur në Përqindje %
Aktgjykime Dënuese	12,779	59,30%
Aktgjykime Liruese	236	1,10%
Aktgjykime Refuzuese	803	3,72%
Urdhër Ndëshkimorë	4,787	22,21%
Hedhje të Aktakuzës	2,829	13,13%
Masa e Trajtimit të Detyrueshëm	116	0,54%
Totali	21,550	100%

Tabela 8. Llojet e Vendimeve Gjyqësore përkitazi me aktet akuzues të prokurorëve gjatë vitit 2019.

Kurse ndaj vendimeve gjyqësore të GJTh-ve, sipas të dhënave nga raporti i PSH, del se Prokurorët e DP-ve, kanë parashtruar gjithsej 540 ankesa, prej të cilave 441 janë parashtruar vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin.

Lidhur me vendimet e Gjykatës së Apelit përkitazi me ankesat e prokurorëve, Raporti i Prokurorit të Shtetit nuk ofron të dhëna të tilla, i cili fakt paraqet një mungesë të transparencës, ngase mungesa e një statistike të tillë pamundëson matjen dhe vlerësimin e efikasitetit të ankesave të prokurorisë ndaj vendimeve gjyqësore.

³⁷ Raporti i punës së Prokurorit të shtetit për vitin 2019.F. 70-75. (Qasur së fundi më 2 maj 2020).

7. Performanca e gjykatësve të DP-ve gjatë vitit 2019

Gjatë vitit 2018, DP-të e GjTh-ve kishin trashëguar 42,116 lëndë nga viti paraprak, i kishin pranuar 22,300 lëndë të reja, dhe gjithsej në punë kishin pasur 64,416 lëndë. Nga 80 gjykatësit të cilët kanë qenë të angazhuar për vitin 2018, ishte arritur që 24,278 lëndë të zgjidhen, kurse 40,118 lëndë kishin mbetur të pazgjidhura.

Në këtë mënyrë, i bie se në vitin 2018, mesatarisht secili gjyqtar kishte pranuar nga 278.75 lëndë të reja, derisa secili gjyqtar mesatarisht kishte pasur në punë nga 805.2 lëndë.

Bazuar në rregulloren e 14 shtatorit 2011 për caktimin e normës orientuese të punës së gjyqtarëve, të miratuar nga KGJK, norma orientuese mujore e një gjyqtari në Departamentin e Përgjithshëm është 24 lëndë, ndërsa ajo vjetore 292 lëndë.

Në raportin e kaluar mbi krimet e përgjithshme, IKD kishte gjetur se gjatë vitit 2018, DP-të e GjTh-ve e kishin tejkaluar këtë normë të përcaktuar nga KGJK-ja, duke kryer mesatarisht 11.4 lëndë më shumë. Kjo pasi gjatë vitit 2018, IKD kishte gjetur se mesatarisht secili gjyqtar kishte zgjidhur nga 303.5 lëndë.³⁸

Për dallim nga viti 2018, ku në DP e të gjitha gjykatave kanë qenë të angazhuar 80 gjykatës, në vitin 2019 ky numër është rritur në masë të dukshme, dhe kjo ka rezultuar edhe me rritjen e numrit të lëndëve të zgjidhura. Në vitin 2019 në DP-të e Gjykatave Themelore në Kosovë kanë qenë të angazhuar gjithsej 97.5 gjykatës. Pra, gjatë vitit 2019, numri i gjyqtarëve në DP-të e GjTh-ve është ngritur për 21.8%.

Sa i përket vitit 2019, DP-të e GjTh-ve kanë trashëguar 40,118 lëndë nga viti paraprak, i kanë pranuar 20,343 lëndë, kanë pasur në punë gjithsej 60,461 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 27,192 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 33,257 lëndë.

Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2019, secili gjyqtar mesatarisht ka pasur në punë nga 620.1 lëndë, derisa secili gjyqtar mesatarisht ka zgjidhur 278.9 lëndë.

Bazuar në normën orientuese për gjykatësit, të përcaktuar me rregulloren e KGJK-së, e cila obligon gjyqtarët e DP-ve të GjTh-ve të zgjidhin 24 lëndë në muaj apo 292 lëndë në vit, i bie se gjykatësit e DP-ve të GjTh-ve gjatë vitit 2019 nuk kanë arritur ta përmbushin këtë normë ashtu që mesatarisht një gjykatës ka zgjidhur **278.9 lëndë**, e që i bie **13,1 lëndë** më pak se sa norma vjetore e përcaktuar.

³⁸ Hashani, Gzime; Thaqi, Mirvet: “Krimet e Përgjithshme në Kosovë”. Prishtinë. Nëntor. 2019. F.29 (Shih linkun <https://kli-ks.org/krimet-e-pergjithshme-ne-kosove-ligji-vs-praktika/>). (Qasur së fundi më 2 maj 2020).

Mesatarja për gjyqtarë	2018						2019					
	Numri i gjykatësve	Lëndët në punë	Mesatarja për gjyqtarë	Lëndët e zgjidhura	Mesatarja		Numri i gjykatësve	Lëndët në punë	Mesatarja për gjyqtarë	Lëndët e zgjidhura	Mesatarja	
Prishtinë	16	26,246	1640.4	8,667	541.7		22	23,996	1090.7	9,551	434.1	
Mitrovicë	11.5	5,213	453.3	1,734	150.8		16	6,980	436.2	3,237	202.3	
Gjilan	11.5	6,651	578.3	2,638	229.4		11.5	6,189	538.2	2,670	232.2	
Ferizaj	9	8,136	904	2,919	324.3		13	7,358	566	3,336	256.6	
Pejë	11	5,030	457.3	2,540	230.9		11	4,700	427.3	2,422	220.2	
Prizren	13	8,311	639.3	3,848	296		16	6,859	428.7	3,872	242	
Gjakovë	8	4,829	603.6	1,932	241.5		8	4,379	547.4	2,104	263	
Gjithsej	80	64,416	805.2	24,278	303.5		97.5	60,461	620.1	27,192	278.9	

Tabela 9. Mesatarja e lëndëve në punë dhe lëndëve të zgjidhura nga gjykatësit gjatë vitit 2018 dhe 2019.

Me këtë rast, IKD ka gjetur se në vitin 2019 edhe pse është rritur numri i gjykatësve në GjTh-në në Prishtinë, GjTh Ferizaj dhe atë Prizren, ka rënë mesatarja e zgjidhjes së lëndëve në këto gjykata.

Po ashtu, GjTh në Pejë edhe pse me numër të njëjtë të gjykatësve ka pasur rënie në mesataren e zgjidhjes së lëndëve. Ndërsa, GjTh në Gjakovë, GjTh në Mitrovicë, dhe GjTh në Gjilan në vitin 2019 kanë rritur mesataren e zgjidhjes së lëndëve në krahasim me vitin paraprak.

Mirëpo, edhe pse këto tri gjykata kanë arritur që në vitin 2019 të ngritin mesataren krahasuar me vitin 2018, vlen të theksohet se kjo mesatare ende nuk e ka përmbushur normën orientuese të miratuar nga KGJK, e cila paraqet obligimin për zgjidhjen e 292 lëndëve brenda një viti nga një gjykatës.

KGJK për herë të parë në vitin 2019 kishte publikuar raportin vjetor statistikor për punën e të gjithë gjyqtarëve të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Ky hap pozitiv në drejtim të ngritjes së transparencës ishte vlerësuar nga IKD në serinë e raporteve “*Ligji vs. Praktika*”.

Përtej kësaj, KGJK ka avancuar edhe më tutje drejt përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies gjyqësore në raport me publikun, pasi në maj të vitit 2020 ka lansuar pasqyrën

e performancës, e cila është përkrahur nga Programi i USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (JSSP).

Përmes lansimit të kësaj platforme janë dhënë informacione mbi indikatorë kyç siç janë shkalla e efikasitetit, ose lëndët e pranuar dhe të zgjidhura, trendet e shkallës së efikasitetit si dhe vëllimi i lëndëve të vjetra për secilën Gjykatë dhe për gjyqësorin në tërësi, si dhe normat e produktivitetit të gjyqtarëve individual.

Bazuar në të dhënat që figurojnë në pasqyrën e performancës të publikuar në ueb faqen e KGJK-së, rezulton se për vitin 2019, në nivel të DP-ve të GjTh-ve, gjykatësi që ka kryer më së shumti lëndë ishte gjykatësi nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc, Shefqet Baleci me gjithsej 719 lëndë të përfunduara brenda këtij viti, dhe i cili një epitet të tillë e mban për të dytin vit me radhë, pasuar nga gjykatësit e GjTh në Prishtinë, Fatime Dermaku me 625 lëndë si dhe Agim Kuçi me 585 lëndë të përfunduara gjatë vitit 2019³⁹.



**Shefqet Baleci - Drenas
719 lëndë**



**Fatime Dermaku -
Prishtinë 625 lëndë**



**Agim Kuçi - Prishtinë 585
lëndë**

Gjykatësit e Departamentit të Përgjithshëm që kanë kryer lëndë mbi normën vjetore.

Ndërsa, në anën tjetër gjykatësit me numrin më të vogël të lëndëve të kryera⁴⁰ gjatë vitit 2019 janë gjyqtarja e Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash, Sabaheta Kurteshi⁴¹ me vetëm 43 lëndë, pasuar nga gjyqtarja e Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega Novobërdë, Emine Salihi⁴² me 52 lëndë të kryera, Gjyqtarja e Gjykatës Themelore në Gjakovë, Besarta Doli, me 66 lëndë penale të përfunduara gjatë vitit 2019.⁴³

³⁹ KGJK. “Pasqyra e performancës së gjyqësorit për vitin 2019”. (Shih linkun <https://ëëë.gjyqesori-rks.org/pasqyra-e-performances/>). (Qasur së fundmi më 26 maj 2020).

⁴⁰ Sqarim: IKD ka marrë për referencë vetëm gjyqtarët që kanë qenë të angazhuar gjatë gjithë periudhës në DP-të e GjTh-ve.

⁴¹ Sqarim: Gjyqtarja Sabaheta Kurteshi është edhe Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën themelore në Prizren – Dega në Dragash, dhe përpos lëndëve penale, e njëjta ka zgjidhur edhe 97 lëndë civile.

⁴² Sqarim: Gjyqtarja Emine Salihi është edhe Gjyqtare Mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore në Gjilan- Dega në Novobërdë.

⁴³ Sqarim: Gjyqtarja Besarta Doli ka zgjidhur edhe shtatë (7) lëndë të krimeve të rënda, shtatë (7) lëndë të krimeve të rënda në procedurë paraprake, gjashtë (6) lëndë për të mitur dhe 41 lëndë për të mitur në procedurë papaprake.



**Sabaheta Kurteshi -
Dragash 43 lëndë**



**Emine Salihi - Novobërdë
52 lëndë**



**Besarta Doli - Gjakovë 66
lëndë**

Gjykatëset e Departamentit të Përgjithshëm që kanë kryer lëndë nën normën vjetore.

8. Performanca e Prokurorëve të DP-ve në PTh gjatë vitit 2019

Duke u bazuar në raportin e punës së Prokurorit të Shtetit, gjatë vitit 2019, në DP-të e PTh-ve kanë qenë të angazhuar gjithsej 110 prokurorë, mirëpo ngarkesa e prokurorëve me lëndë sipas departamenteve për secilin DP të PTh-ve është paraqitur në vetëm për 98 prokurorë.

Në mesataren e numrit të lëndëve të pranuar në punë, i bie se gjatë vitit 2019 secili prokuror i DP të PTh-ve ka pranuar në punë mesatarisht 247 lëndë. Sipas mesatares për një prokuror, gjatë vitit 2019 më së shumti lëndë ka pranuar DP i PTh në Pejë, derisa më së paku lëndë ka pranuar DP i PTh në Gjakovë.

Prokuroritë	Numri i Prokurorëve	Lëndët e Pranuar në Punë	Mesatarja e lëndëve të pranuar për një prokurorë
Prishtinë	28	6,881	245.75
Prizren	15	3,215	214.33
Pejë	10	3,377	337.7
Gjilan	10	2,230	223
Mitrovicë	15	4,166	277.73
Ferizaj	11	2,486	226
Gjakovë	9	1,880	208.88
Gjithsej	98	24,235	247.29

Tabela 10. Mesatarja e lëndëve në punë për një prokuror gjatë vitit 2018.

Në anën tjetër, gjatë vitit 2019, mesatarisht secili prokuror ka qenë i ngarkuar me nga 392 lëndë. Në mesataren e numrit të lëndëve në punë për prokurorë prinë DP i PTh-së në Mitrovicë, derisa numrin më të vogël të lëndëve në punë për prokurorë gjatë vitit 2019 e ka pasur DP i PTh-së në Gjilan.

Prokuroritë	Numri i Prokurorëve	Lëndët në Punë	Mesatarja e lëndëve në punë për një prokuror
Prishtinë	28	13,251	473.25
Prizren	15	4,662	310.8
Pejë	10	4,674	467.42
Gjilan	10	2,357	235.7
Mitrovicë	15	7,108	473.86
Ferizaj	11	3,778	343.45
Gjakovë	9	2,599	288.77
Gjithsej	98	38,429	392.13

Tabela 11. Mesatarja e lëndëve në punë për prokurorët gjatë vitit 2019.

Ndërsa gjatë vitit 2019, mesatarisht secili prokuror ka zgjidhura **278 lëndë**. Norma vjetore për prokurorët e DP të PTh-ve, e përcaktuar nga KPK, është 253 lëndë në vit. Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2019, prokurorët kanë tejkaluar këtë normë, pasi kanë zgjidhur 25 lëndë më shumë se sa që kanë pranuar.

Prokuroritë	Numri i Prokurorëve	Lëndët e Zgjidhura	Mesatarja e zgjidhjes së lëndëve për një prokuror
Prishtinë	28	8,862	316,5
Prizren	15	3,411	227,4
Pejë	10	3,995	399,5
Gjilan	10	2,261	226,1
Mitrovicë	15	4,031	268,73
Ferizaj	11	2,837	257,97
Gjakovë	9	1,922	213,55
Gjithsej	98	27,319	278,76

Tabela 12 Mesatarja e zgjidhjes së lëndëve nga prokurorët gjatë vitit 2019.

Ndërsa, sa i përket arritjes së normës orientuese sipas DP të PTh-ve, këtë normë orientuese e kanë tejkaluar katër (4) DP të PTh-ve (Prishtinë, Pejë, Mitrovicë dhe Ferizaj), derisa këtë normë orientuese nuk e kanë përmbushur tri (3) DP të PTh-ve (Prizren, Gjilan dhe Gjakovë).

9. Gjetjet e IKD-së në trajtimin e krimeve të përgjithshme

Gjatë vitit 2019, IKD ka vazhduar që në mënyrë sistematike të monitorojë rastet gjyqësore që trajtohen në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm, Divizioni Penal, në të gjitha gjykatat themelore dhe degët e tyre, që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, IKD ka monitoruar 3,426 seanca gjyqësore, të cilat përbëjnë 2,435 raste të trajtuara në këtë departament. Prej këtyre 3,426 seanca, 2,371 seanca janë mbajtur, ndërsa 1,055 janë shtyrë.⁴⁴





Tabela 13. Numri i seancave të monitoruara nga IKD gjatë vitit 2019.

Në këtë mënyrë, IKD gjatë procesit të monitorimit të DP-ve të GjTh-ve ka gjetur se një numër mjaft i madh i seancave gjyqësore shtyhen, i cili numër i seancave në vitin 2019 përbën 30.7% të totalit të seancave të monitoruara.

Në kuadër të procesit të monitorimit të punës së këtij departamenti, IKD ka gjetur se numrin më të madh të kallëzimeve penale që hyjnë në lëmin e DP-ve, e ka parashtruar Policia e Kosovës, me gjithsej 1,360 raste të paraqitura pranë prokurorisë, ndërsa numrin më të ulët të tyre e kanë iniciuar ATK-ja dhe IPK-ja, me nga 6 raste të paraqitura.

⁴⁴ “Platforma e monitorimit të gjyqësorit”. Instituti i Kosovës për Drejtësi (Shih linkun <https://kli-ks.org>). (Qasur së fundi më 1 maj 2020).



Grafiku 4. Parashtruesit e kallëzimeve penale nga rastet e monitoruara nga IKD në DP-të e GjTh-ve gjatë vitit 2019.

Gjatë monitorimit të rasteve në DP, IKD ka gjetur se Prokurori i Shtetit ka parashtruar kërkesë për sekuestrim të pasurisë në vetëm 54 raste, ndërsa nuk ka ushtruar këtë të drejtë ligjore në 2381 raste të tjera.⁴⁵

Monitorimi në mënyrë sistematike dhe i vazhdueshëm i punës së sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial nga IKD, ka mundësuar që në mënyrë profesionale të hulumtohen sfidat dhe mangësitë që e përcjellin punën e këtyre institucioneve me rëndësi vitale për funksionimin e shtetit ligjor.

Ndër dukuritë më shqetësuese që ka përcjellë punën e gjykatave ndër vite është stërzgjatja e gjykimeve me rastin e vendosjes për një lëndë të caktuar, duke pamundësuar që lëndët të trajtohen brenda afateve të përcaktuara shprehimisht me ligj. Gjatë kësaj periudhe raportuese, IKD ka evidentuar procedura gjyqësore që kanë zgjatur më shumë se **13 vite**, duke shkelur në mënyrë flagrante parimin e gjykimit të drejtë të realizuar brenda një afati të arsyeshëm kohor, i cili është inkorporuar në Kushtetutën e Republikës, Kodin e Procedurës Penale dhe instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përfshirë këtu edhe Konventën Evropiane për Drejtat e Njeriut.

Nga të dhënat e IKD-së, të siguruar nga monitorimi sistematik gjatë vitit 2019, rezulton se prokurorisë i janë nevojitur **1031 ditë**, që të trajtojë kallëzimin penal dhe ta ngritë aktin akuzues bazuar në të dhënat që ai kallëzim penal ka përmbajtur si i tillë.

Ndërsa, sa i përket kohëzgjatjes së një rasti në gjykatë, sipas KGJK-së, kohëzgjatja e një rasti në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatave Themelore është 602 ditë, ndërsa në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës së Apelit është 73.86 ditë. Këtë statistikë, KGJK

⁴⁵ Po aty.

nuk e nxjerrë duke trajtuar kohëzgjatjen e secilit rast një për një, por me anë të një formule matematikore.⁴⁶

Mirëpo, një statistikë e tillë nuk përkon as për së afërmi me të dhënat reale të cilat dalin nga procesi i monitorimit të këtyre rasteve në praktikë. Nga të dhënat e IKD-së, të nxjerra nga analizimi i rasteve të përzgjedhura karakteristike që janë në këtë raport, del se Divizionet Penale të Gjykatave Themelore, për caktimin e shqyrtimit fillestar pas dorëzimit të aktakuzës në gjykatë u janë nevojitur mesatarisht **561 ditë**, ndonëse KPPK-ja në nenin 242.4 ka përcaktuar mbajtjen e kësaj seance brenda 30 ditëve nga ngritja e aktakuzës.

Po ashtu, një fenomen tjetër shqetësues që po sfidon në mënyrë të vazhdueshme punën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial është dukuria e parashkrimit. Parashkrimi, si institut procedural po mundëson që kryesit e veprave penale të shpëtojnë pa marrë dënimin meritore dhe të amnistohen pikërisht nga ato organe që janë të thirrura që të zbatojnë ligjin. Për më tepër, krahas amnistimit të kryerësve të veprave penale, me këtë rast dëmtohet edhe interesi i palëve të dëmtuara. Prezenca e kësaj dukurie lidhet ngushtë me një sërë shkaqesh, qoftë të natyrës objektive (numri i madh i lëndëve, numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve etj.) apo shkaqeve subjektive (neglizhenca e prokurorëve dhe gjyqtarëve, mos veprimi i tyre brenda afateve ligjore, mos planifikimi i duhur i punës etj.). Gjatë vitit 2019, gjithsej janë parashkruar 2,370 lëndë në tërë gjykatat themelore. Prej tyre, 2,228 lëndë kishin arritur parashkrimin absolut, ndërsa 142 raste parashkrimin relativ.

Gjatë vitit 2019, IKD ka gjetur edhe një sërë shkeljesh të tjera, që janë evidente gjatë monitorimit të procedurave gjyqësore në kuadër të DP-ve. Edhe gjatë këtij hulumtimi, IKD ka vërejtur një qasje diskriminuese dhe jo-ligjore që aplikojnë gjykatat varësisht nga cilësia e personit të akuzuar. Rrjedhimisht, ky standard i dyfishtë i gjyqësorit vjen në shprehje në rastet kur persona me ndikim të lartë publik ballafaqohen me drejtësinë. Në raste të tilla, gjykatat zbatojnë praktika të ndryshme krahasuar me rastet tjera gjyqësore, kur si persona të akuzuar paraqiten njerëzit e rëndomtë. Këtu vlen të përmendet rasti i Kryetarit të Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, i akuzuar për mos ekzekutim të vendimeve gjyqësore, i cili duke mos iu përgjigjur ftesave të gjykatës kishte bërë që të dështonin tri seanca radhazi. Gjykata nuk kishte lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim të të akuzuarit Muhaxheri qysh pas seancës së parë, përkundër asaj se ishin plotësuar kushtet ligjore për një veprim të tillë, por një urdhëresë e tillë ishte nxjerrë pas dështimit të tretë për mbajtjen e seancës gjyqësore, edhe pse KPPK-ja e obligon gjykatën që të ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme që të parandalojë zvarritjen e procedurës penale. Trajtim të ngjashëm kanë pasur edhe figura të tjera publike, si Milaim Zeka e Frashër Krasniqi, të cilët nuk kishin prezantuar në gjykatë për katër herë me radhë, edhe pse kanë qenë të ftuar me rregull, dhe gjykata nuk kishte urdhëruar asnjë masë për sigurimin e prezencës së tyre në procedurë penale, duke i kontribuar kështu zvarritjes së këtij gjykimi, në kundërshtim me detyrat dhe autorizimet e saj si gjykatë.

⁴⁶ Shënim: KGJK këtë kalkulim e bënë për Departamentin e Përgjithshëm si tërësi, dhe jo të ndarë në Divizionin Penal, Civil dhe atë për Kundërvajtje.

Kjo përbën shkelje të parimit të barazisë para ligjit, si parim themelor që garanton trajtimin e barabartë për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, duke ndaluar çfarëdo lloj diskriminimi. Një konstatim i tillë gjën mbështetje në faktin se shumë figura të tilla publike, disa nga të cilat edhe janë trajtuar si pjesë e këtij hulumtimi, i janë shmangur thirrjeve të gjykatës, duke bërë që seanca të shumta të dështojnë, pa arsytuar fare mungesën e tyre. Ndërsa, gjykatat, të cilat ligji i ka pajisur me të gjitha mjetet për të garantuar zhvillimin e një procesi të drejtë dhe pa zvarritje, kur janë ballafaquar me raste të tilla, rrallë herë kanë urdhëruar sjelljen e tyre forcërisht në gjykatë, e në shumicën e këtyre herëve këto veprime kanë ardhur si pasojë e publikimit të këtyre fakteve në publik, ku haptas vërehet një trajtim preferencial i këtyre personave krahas qytetarëve të zakonshëm.

Prokuroria, edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar me ngritjen e aktakuzave të cilat nuk i përmbushnin kushtet minimale ligjore që i parasheh Kodi i Procedurës Penale. Kjo pasi, edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, prokurorët kanë vazhduar të ngritin aktakuza ndaj personave, për të cilët më vonë është kuptuar se kanë qenë të akuzuar gabimisht, për faktin e vetëm se kanë pasur të dhëna personale të ngjashme me kryesit e vërtetë të këtyre veprave penale. Pra, në rastet e tilla, prokuroria ka dështuar që t'i bëjë të gjitha verifikimet e nevojshme dhe vlerësimin paraprak të provave, përkatësisht ka dështuar që të vërtetojë identitetin e drejtë e personit ndaj të cilit ka ngritur aktakuzë.

Në anën tjetër, IKD gjatë procesit të monitorimit ka evidentuar praktika të Prokurorit të Shtetit të cilat janë negacion i sigurisë juridike të qytetarëve. Këto praktikë, konsistojnë në ngritjen e aktakuzave nga të cilat hiqet dorë ende pa u shqyrtuar asnjë provë, madje ende pa u caktuar as shqyrtimi fillestar.

Për më tepër, edhe gjatë vitit 2019 IKD ka evidentuar raste të shumta ku prokuroria ka ngritur aktakuza ndaj personave të vdekur. Në shumë prej këtyre rasteve, prokuroria ka shfrytëzuar mundësinë ligjore për ngritjen e aktakuzave të drejtpërdrejta, por që kjo tendencë ka rezultuar të jetë e disfavorshme dhe e pasuksesshme, ngase mos verifikimi i statusit jetësor të të akuzuarve, ka bërë që lëndët e tilla të hedhen poshtë nga gjykatat, pa kurrfarë shqyrtimi të meritave të rastit.

Pasigurisë juridike, në shumë raste i ka kontribuar edhe mos efikasiteti i gjykatës që brenda afateve ligjore të procedojë me zgjidhjen e rasteve. Gjatë monitorimit, IKD ka evidentuar raste të tilla ku një person është detyruar që brenda një kohe të shkurtër të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtat vepra penale, kjo për shkak të vonesës së gjykatës në përpilimin e aktgjykimit. Në raste të tilla përveç se nuk është përfillur afati ligjor për përpilimin dhe dorëzimin me kohë të aktgjykimit tek palët pjesëmarrëse në procedurë, është cenuar parimi universal “ne bis in idem”, i cili pamundëson gjykimin e personave dy herë për të njëjtat vepra penale, përveç kur plotësohen kushtet e parapara me ligj. Ky rast ka trajtim të detajuar në kapitullin e trajtimit të rasteve karakteristike në këtë raport.

Një fenomen tjetër negativ që del nga monitorimi i sistemit të drejtësisë ka qenë mos përmbushja e autorizimeve nga ana e Policisë, që brenda afatit ligjor të dorëzojë kallëzimin penal tek prokurori i çështjes, duke penguar rrjedhën normale të procedurës penale dhe duke

zvarritur çështjen pa nevojë. Në një rast të analizuar, kallëzimi penal ka mbetur në sirtarët e policisë për më shumë se 552 ditë, edhe pse lidhur me këtë, KPPK në paragrafin nenin 70.4 të saj, e obligon policinë që brenda 24 orëve t'i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit, posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare.⁴⁷

Gjetje tjetër e rëndësishme gjatë monitorimit të DP-ve, ka qenë ndjekja penale që Prokurori i Shtetit ka zhvilluar në raport me veprat penale të rëndësisë së vogël. KPPK në nenin 11 të tij ka përcaktuar se *“Nuk përbën veprë penale ajo veprë e cila edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuara me ligj, paraqet veprë të rëndësisë së vogël. Vepra është e rëndësisë së vogël kur rrezikshmëria e saj është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës; mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; rrethanave në të cilat është kryer vepra; shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose rrethanave personale të kryesit”*.⁴⁸ Andaj, kur një veprim i caktuar, i cili në dukje përmban elemente kriminale, por që përmbush elementet e veprës me rëndësi të vogël, pamundëson inicimin e procedurës penale për këto raste, apo dënimin e kryesit.

Në këtë drejtim, gjatë vitit 2019 prokurorët kanë ndjekur penalisht kryesit e atyre veprave penale, të cilësuar si *“vepra të rëndësisë së vogël”*, ku në një rast të trajtuar, dëmi i pretenduar ka qenë vetëm 9 euro.

Ndërsa, gjatë trajtimit të këtyre rasteve, është vërejtur një dukuri pozitive sa i përket politikës ndëshkimore të aplikuar nga gjykatësit e këtij departamenti. Rrjedhimisht, nëse përdorim një analogji me dënimet e aplikuar nga gjykatësit e Departamentit për Krime të Rënda, mund të nxjerrim përfundimin se shpeshherë dënimet që shqiptohen në kuadër të DP-së, janë shumë herë më të larta. Veçmas një analogji e tillë mund të përdoret për të krahasuar dënimet e shqiptuara nga gjykatësit e departamenteve për krime të rënda për vepra penale korruptive, ku akoma nuk kemi një të pandehur për korrupsion të profilit të lartë të dënuar me burgim efektiv, por dënimet më të shpeshta të shqiptuara janë ato me kusht.

Një veçori tjetër negative, e cila i kontribuuar mos efikasitetit dhe zvarritjes së procesit gjyqësor ka qenë procedimi dhe gjykimi i lëndëve nga gjykatat jo kompetente. IKD gjatë monitorimit ka hasur raste të tilla kur një gjykatë ka filluar të procedojë me një çështje penale, pa shqyrtuar fillimisht çështjen e kompetencës, e cila sipas ligjit shqyrtohet qysh me rastin e pranimit të një lënde, dhe muaj më vonë, e njëjta gjykatë ka hequr dorë nga gjykimi i asaj çështje penale, duke u shpallur jo kompetente, e me këtë ka bërë që rasti të zvarritet pa nevojë e pa arsye.

⁴⁷ Kodi nr. 04/1-123 i procedurës penale. Neni 70.4: *“Posa policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia është e detyruar që brenda njëzet e katër (24) orëve t'i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale”*.

⁴⁸ Kodi nr. 06/1-074 Penal i Republikës së Kosovës. Neni 11 *“Nuk përbën veprë penale ajo veprë e cila edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuara me ligj, paraqet veprë të rëndësisë së vogël. Vepra është e rëndësisë së vogël kur rrezikshmëria e saj është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës; mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; rrethanave në të cilat është kryer vepra; shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose rrethanave personale të kryesit”*.

Tutje, IKD gjatë procesit të monitorimit ka evidentuar raste kur një departament i gjykatës ka gjykuar dhe ka vendosur për çështje penale për të cilat sipas ligjit nuk ka të drejtë të vendosë, siç ishte rasti i gjykimit të armëmbajtjes pa leje, e cila në disa gjykata është gjykuar nga DP dhe në disa gjykata është gjykuar në DKR, duke krijuar kaos sa i përket trajtimit të këtyre rasteve. Për më tepër gjykata e shkallës së dytë, kur ka shqyrtuar ankesat për armëmbajtje pa leje, nuk ka trajtuar shkeljen apo mos respektimin e kompetencës lëndore kur gjykimi i tyre është bërë nga DP-të, edhe pse KPPK-ja, e obligon që ajo sipas detyrës zyrtare të kujdeset për ato shkelje, edhe në rastet kur ankuese nuk thirret në to, dhe rrjedhimisht të anulojë apo prish aktgjykimin kur ato konstatohen.

Në anën tjetër, IKD ka gjetur një tendencë të gjyqësorit që të mbaj të fshehura për publikun, raste me një ndjeshmëri të caktuar, kur persona me ndikim në jetën publike janë paraqitur si të akuzuar. Për shumë prej këtyre rasteve, Betimi për Drejtësi ka raportuar në mënyrë ekskluzive, për faktin se ato kanë qëndruar në sirtarët e gjykatave për vite të tëra, pa u proceduar, dhe ka qenë presioni publik ai që ka vënë në lëvizje gjykimin e këtyre rasteve. Kjo mënyrë e veprimit nxitë mosbesimin e publikut në punën e gjykatave, andaj është e domosdoshme që gjykatat të respektojnë ligjin, të jenë transparente për publikun, duke i ofruar secilit qasje të barabartë në drejtësi, ashtu edhe siç parashihet me ligj.

IKD gjatë monitorimit të rasteve në divizionet penale ka hasur në shkelje të shumta të cilat në mënyrë të vazhdueshme po pamundësojnë realizimin e një procesi gjyqësor të drejtë, ku shumë të tilla i atribuohen sjelljes së papërgjegjshme të pjesëmarrësve aktiv në procedurë, e të shumta kanë qenë shtyrjet e seancave me arsyetimin se prokurorët nuk posedonin shkresat e lëndës me vete, apo se ishin të papërgatitur për seancë, apo se nuk kishin as dijeninë elementare për rastin që e përfaqësonin në seancë.

Kontributi i vazhdueshëm i IKD-së, në përmirësimin dhe avancimin e punës së gjyqësorit dhe prokurorisë, është pasqyruar edhe me rastin e publikimit të raportit analitik: “Drejtësia “amniston” veteranët e rrejtshëm, dëmton buxhetin e Republikës së Kosovës: Analizë e aktakuzave, proceseve gjyqësore dhe aktgjykimeve në rastet e “veteranëve të rrejtshëm”, me ç’rast gjykatat kanë praktikuar rekomandimet e dhëna në këtë raport. Sipas gjetjeve të këtij raporti, IKD kishte gjetur se sistemi i drejtësisë ka dështuar në mbrojtjen e buxhetit të Republikës së Kosovës në rastet e “veteranëve të rrejtshëm”. Në këto raste, publikimi i raportit nga IKD paraqet kthesën në trajtimin e këtyre rasteve dhe fillimin e mbrojtjes së buxhetit të Republikës së Kosovës nga “veteranët mashtrues”.

Në vijim të këtij raporti, IKD ka analizuar disa nga rastet karakteristike që janë gjykuar në kuadër të DP-ve, duke ofruar të dhënës konkrete dhe gjetje të veçanta për secilin nga ato raste.

10. Anex : Analizë e detajuar e rasteve të përzgjedhura karakteristike

1. Hudhet poshtë aktakuza ndaj Kryetarit të Pejë për mosekzekutim të vendimit gjyqësor

GjTh në Pejë

Numri i lëndës: P.nr.493/17,

Vepra penale: “mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore”, nga neni 402 i KPRK-së.

Gjykatësi: Sejdi Blakaj

Prokurore: Lumturije Vuqetaj

I pandehuri: Gazmend Muhaxheri.

Faza e procedurës: Aktgjykim i formës së prerë

Nga ngritja e aktakuzës e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit kanë kaluar 983 ditë.

Gjykata Themelore në Pejë, më 19 gusht 2019, e kishte hedhur poshtë aktakuzën ndaj Kryetarit të Pejës, Gazmend Muhaxheri për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore.⁴⁹

Ky vendim për hedhje të aktakuzës ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, duke e vërtetuar aktgjykimin e nxjerrë në shkallë të parë, dhe duke e hedhur si të palejuar ankesën e të dëmtuarit, Hysni Selmanaj.⁵⁰

Prokuroria Themelore në Pejë e akuzonte Gazmend Muhaxherin se më 24 mars 2016, në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Pejës, ka refuzuar të ekzekutojë vendimin e plotfuqishëm të Gjykatës së Apelit të Kosovës, për të kthyer Hysni Selmanaj në vendin e punës si drejtor i Auditorit të Brendshëm.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTH në Pejë më 27 shtator 2016 kishte pranuar kallëzimin penal ndaj të pandehurit Gazmend Muhaxheri për veprën penale mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Kjo prokurori më 2 nëntor 2016 kishte nxjerr vendim për fillimin e hetimeve ndaj Muhaxherit për veprën e lartcekur.

Aktakuza ndaj Muhaxherit për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore ishte ngritur më 3 maj 2017.

Seanca fillestare ishte mbajtur më 27 dhjetor 2018, apo 604 ditë pas dorëzimit të aktit akuzues në gjykatë. Ky veprim i gjykatës, përveçse i vonuar përbën shkelje të nenit 242.4 të KPPK-së,

⁴⁹ “Hudhet poshtë aktakuza për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore ndaj kryetarit të Pejës, Gazmend Muhaxheri”. Betimi për Drejtësi. 19 gusht 2019 (<https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktakuza-per-mosekzekutim-te-vendimeve-gjyqesore-ndaj-kryetarit-te-pejes-gazmend-muhaxheri/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

⁵⁰ “Apeli vërteton hudhjen e aktakuzës ndaj kryetarit të Pejës, Gazmend Muhaxheri”. Betimi për Drejtësi. 20 janar 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-hudhjen-e-aktakuzes-ndaj-kryetarit-te-pejes-gazmend-muhaxheri/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

i cili e obligon gjykatën që të caktojë shqyrtimin fillestar brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës.

Mirëpo, Gjykata Themelore në Pejë, nuk ishte mjaftuar me vetëm një shqyrtim fillestar ndaj Kryetarit të Pejës, Muhaxheri. Kjo gjykatë, kishte caktuar shqyrtimin fillestar për herë të dytë më 24 qershor 2019, ku sërish Muhaxheri ishte deklaruar i pafajshëm.

Caktimi për herë të dytë i seancës fillestare ishte arsyetuar nga gjykata me faktin se kishin kaluar më shumë se 90 ditë nga shqyrtimi fillestar i mbajtur dhe nuk ishte caktuar shqyrtimi i dytë.

Ky veprim i GjTh në Pejë përbën shkelje ligjore, konkretisht nenit 245.5 të KPPK-së, sipas të cilit, shqyrtimi i dytë caktohet “jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar”.

IKD vlerëson se në rastin konkret gjykatësi nuk ka pasur bazë ligjore që të mbajë sërish shqyrtimin fillestar ngase afati prej 90 ditësh në të cilën ishte thirrur GjTh në Pejë vlen vetëm për fazën e shqyrtimit gjyqësor,⁵¹ e jo për veprimet procedurale para konfirmimit të aktakuzës. Kjo ngase KPPK, në nenin 311 të tij, në mënyra taksative ka rregulluar aspektet ligjore se si të procedohet me shqyrtimin gjyqësorë të shtyrë, varësisht nga përbërja e trupit gjykues që e vazhdon atë apo nga kohëzgjatja për të cilën është shtyrë shqyrtimi gjyqësor, kjo me qëllim që të sigurohet vazhdimësi në trajtimin e çështjes juridiko-penale ku duhet të vie në shprehje parimi i drejtpërdrejtë.⁵²

Shqyrtimi i dytë ndaj Muhaxherit ishte mbajtur më 26 korrik 2019, në të cilën seancë prokurorja kishte deklaruar se “bazuar në këto veprime të tij vijmë në përfundim që Gazmend Muhaxheri është mbi ligjin”. Këto deklarime ajo i bëri nisur nga fakti se kinse i akuzuari Muhaxheri po refuzonte të zbatonte vendimin e plotfuqishëm të gjykatës.⁵³

Ky proces gjyqësor ishte përcjellë me peripeci të shumta, ngase i akuzuari Muhaxheri gjatë vitit 2018 nuk iu ishte bindur thirrjeve të gjykatës, duke bërë që të dështonin tri seanca të

⁵¹ Kodi i Procedurës Penale. Neni 311.3 “Kur shtyrja ka zgjatur më shumë se tre (3) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat”.

⁵² Kodi i procedurës penale. Neni 311.3 “Kur shtyrja ka zgjatur më shumë se tre (3) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat”.

⁵³ “Prokurorja thotë se me veprimet e Gazmend Muhaxherit vijmë në përfundim se ai është mbi ligjin, mbrojtja konsideron se është abuzuar me pushtetin prokurorial”, Betimi për Drejtësi, 26 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurorja-thote-se-me-veprimet-e-gazmend-muhaxherit-vijme-ne-perfundim-se-ai-eshte-mbi-ligjin-mbrojtja-konsideron-se-eshte-abuzuar-me-pushtetin-prokurorial/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

caktuara ndaj tij, ajo e 24 tetorit 2017, 22 marsit dhe 25 qershorit 2018.⁵⁴ Si pasojë e mungesës së të akuzuarit Muhaxheri në këto tri seanca, marrë parasysh faktin se ftesa atij i ishte dorëzuar me rregull, gjykata ndaj tij kishte lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim për seancën e radhës. Bazuar në dispozitat e KPPK-së, konkretisht nenin 175.1, gjyqtari ka pasur autorizimin ligjor që të zbatojë masën e urdhër arrestit pa pasur nevojë që të dështonin tre seanca radhazi, me arsyetimin se në rastin konkret ishin përmbushur disa nga kushtet për zbatimin e kësaj mase për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, siç janë kur i pandehuri i cili ishte ftuar me rregull nuk paraqitet në gjykatë dhe nuk e arsyeton mungesën e tij apo kur sipas rrethanave ishte e qartë se i pandehuri i shmanget pranimit të thirrjes.⁵⁵

Sipas një analize të bërë nga IKD, epilogu gjyqësor nëse kryetari Muhaxheri kishte zbatuar vendimin e KPMSHC-së, që ta kthejë në punë Hysni Selmanajn, ka prodhuar dy interpretime të ndryshme ligjore, njëra në favor të Muhaxherit, e tjetra në favor të Selmanaj. Këto dallime të interpretimeve ishin bërë fillimisht nga divizionet e Gjykatës Themelore në Pejë, vendimet e të cilave më pas i kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit. Divizionet penale e kanë interpretuar ligjin në favor të Kryetarit të Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, derisa Divizionet Civile, për të njëjtën çështje, kanë interpretuar ligjin në favor të paditësit Hysni Selmanaj. Ndërsa, Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit kishte vërtetuar vendimet e Gjykatës Themelore në Pejë për shqiptimin e gjobave në lartësi prej mbi 16 mijë euro ndaj Komunës së Pejës, për shkak se kryetari Muhaxheri nuk e kishte kthyer në punë ish-drejtorin Hysni Selmanaj, përkundër vendimeve të favorshme gjyqësore për kthimin në punë.⁵⁶

Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, në një përgjigje të dhënë për IKD-në përkitazi me faktin se brenda gjykatës që ai drejton, për rastin e lartcekur ishin nxjerrë interpretime të ndryshme ligjore nga Divizioni Civil dhe ai Penal i GjA, ka deklaruar se *“Sa i përket pyetjes së parë, unë si kryetar i Gjykatës nuk mund të komentoj vendimet gjyqësore. Prandaj përgjigjen e pyetjes suaj, ju sugjeroj ta kërkonti, brenda pjesës arsyetuese të këtyre vendimeve”*.⁵⁷

⁵⁴ “Serish mungon kryetari i Pejës, lëshohet urdhër për sjellje me detyrim për Gazmend Muhaxherin”. Betimi për Drejtësi. 25 qershor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/serish-mungon-kryetari-i-pejes-leshohet-urdher-per-sjellje-me-detyrim-per-gazmend-muhaxherin/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

⁵⁵ Kodi i procedurës penale. Neni 175.1 “Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sipas detyrës zyrtare mund të lëshojë urdhërarrest me kërkesë të prokurorit të shtetit, ose në rrethana të ngutshme me kërkesë të policisë kur ekzistojnë kushtet nga paragrafi 1. i nenit 187 të këtij Kodi, ose kur i pandehuri i cili pasi është thirrur me rregull nuk paraqitet dhe nuk e arsyeton mungesën e tij ose kur thirrja nuk ka mundur t’i dërgohet sipas rregullit dhe kur sipas rrethanave është e qartë se i pandehuri i shmanget pranimit të thirrjes”.

⁵⁶ “Hulumtimi i “Betimi për Drejtësi”, Gjykata në Pejë dhe Gjykata e Apelit me interpretime dhe vendime të ndryshme për çështjen e njëjtë”, Betimi për Drejtësi (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hulumtimi-i-betimi-per-drejtesi-gjykata-ne-peje-dhe-gjykata-e-apelit-me-interpretime-dhe-vendime-te-ndryshme-per-ceshtjen-e-njejte/>). (Qasur së fundi më 5 tetor 2020).

⁵⁷ Përgjigje e Kryetarit të GjA Hasan Shala, për IKD. 16.10.2020.

2. Apeli kthen në rigjykim rastin ndaj ish-kryeshefit të IPK-së dhe dy të tjerëve për privim të kundërligjshëm të lirisë

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.3372/17,

Vepra penale: “privimi i kundërligjshëm i lirisë”, nga neni 196 të KPRK-së.

Gjykatësja: Fatime Dermaku,

Prokurore: Hava Krasniqi,

Të pandehur: Fitim Shishani, Jetullah Aliu, Valbona Osmani.

Faza e procedurës: Aktgjykim i dhënë në shkallë të parë.

Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2020 kanë kaluar 894 ditë.

Paraprakisht, GjTh Prishtinë më 4 nëntor 2019, kishte shpallur të pafajshëm ish-kryeshefin e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), Fitim Shishani, drejtoreshën për Hetime Speciale, Valbona Osmani, si dhe drejtorin e Departamentit të Hetimeve në këtë institucion, Jetullah Aliu, për akuzat për privim të kundërligjshëm të lirisë.⁵⁸

PTh në Prishtinë i akuzonte ata se në mënyrë të kundërligjshme kishin privuar nga liria të dëmtuarin Q.V, për të cilin kishin marrë informacionin se kishte qenë në një motel së bashku me një femër për të cilën ishte dyshuar se ka qenë e mitur.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë, më 4 shkurt 2014 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar ndaj të pandehurve Shishani, Aliu dhe Osmani, për privim të kundërligjshëm të lirisë dhe fotografim i paautorizuar.

Kjo prokurori më 25 maj 2016 kishte nxjerr vendim për fillimin ndaj të pandehurve të lartcekur, dhe më 20 korrik 2017, PTh në Prishtinë kishte ngritur aktakuzë ndaj të akuzuarve për privim të kundërligjshëm të lirisë dhe fotografime apo incizime të paautorizuara.

Shqyrtimi fillestar ndaj tyre ishte mbajtur më 26 mars 2018, pasi kishin kaluar 250 ditë nga dorëzimi i aktakuzës në gjykatë, duke mos respektuar afatin ligjor për mbajtjen e kësaj seance, që është 30 dite nga ngritja e aktit akuzues në gjykatë.⁵⁹

⁵⁸ “Ish-kryeshefi i IPK-së dhe dy të tjerët lirohen nga akuza për privim të kundërligjshëm të lirisë”. Betimi për Drejtësi. 4 nëntor 2019 (<https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryeshefi-i-ipk-se-dhe-dy-te-tjeret-lirohen-nga-akuza-per-privim-te-kunderligjshem-te-lirise/>). (Qasur së fundmi më 30 prill 2020).

⁵⁹ Kodi i Procedurës Penale. Neni 242.4 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.

Kjo gjykatë më 13 qershor 2018, pas analizimit të kërkesave të të akuzuarve për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, e kishte hedhur aktakuzën dhe kishte pushuar procedurën penale ndaj të akuzuarve.

Mirëpo, Gjykata e Apelit në gusht të vitit 2018, e kishte kthyer lëndën në rivendosje, me propozim që të merret deklarata e të dëmtuarit dhe e dëshmitarëve të tjerë të propozuar në aktakuzë.⁶⁰

Shqyrtimi kryesor ndaj të akuzuarve kishte filluar më 19 dhjetor 2018, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor të 19 shtatorit 2019, prokurorja kishte bërë precizimin e kësaj aktakuze, ashtu që të akuzuarit i ngarkonte vetëm për veprën penale “privimi i kundërligjshëm i lirisë”.

Më 30 tetor 2019 kishte përfunduar shqyrtimi gjyqësor me dhënien e fjalës përfundimtare nga palët në procedurë. Ky shqyrtim kryesor i cili kishte filluar më 19 dhjetor 2018 për të përfunduar në tetor 2019, kishte zgjatur 316 ditë.

Kohëzgjatja e këtij shqyrtimi kryesor është zhvilluar duke mos e respektuar nenin 314.1.1 të KPPK-së, i cili përcakton afatin prej 90 ditësh, brenda të cilit duhet të përfundojë shqyrtimi kryesor, i cili zhvillohet para gjyqtarit të vetëm gjykuar.⁶¹

Ndërsa, më 4 nëntor 2019 kjo gjykatë kishte shpallur aktgjykimin në shkallë të parë ndaj të akuzuarve të lartcekur.

Ky rast gjyqësor, që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e verdiktit në shkallë të parë ka zgjatur **838 ditë, apo dy vite e tre muaj.**

⁶⁰ “Pas kthimit në rivendosje, fillon gjykimi ndaj ish-kryeshefit të IPK-së dhe dy të tjerëve”, Betimi për Drejtësi, 7 dhjetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kthimit-ne-rivendosje-fillon-gjykimi-ndaj-ish-kryeshefit-te-ipk-se-dhe-dy-te-tjereve/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

⁶¹ KPPK. Neni 314.1 “Përveç në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shtyn shqyrtimin gjyqësor nga neni 310 i këtij Kodi, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda këtyre afateve kohore: 1.1. nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjëres prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni”.

3. Apeli vërteton dënimet me gjobë ndaj Sami Lushtakut dhe të tjerëve

GjTh në Gjakovë, dega në Malishevë

Numri i lëndës: P.nr.197/18,

Vepra penale: “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykatësi: Njazi Morina,

Prokurori: Ismet Tofaj,

Të pandehur: Dardan Gashi, Endrit Shala, Sami Lushtaku, Behar Amerllahu, Fadil Demiri, Sherif Kastrati.

Faza e procedurës: Aktgjykim i formës së prerë.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit kanë kaluar 435 ditë.

Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Malishevë, më 1 mars 2019, të akuzuarit Dardan Gashi, Endrit Shala, Sami Lushtaku, Behar Amerllahu, Fadil Demiri dhe Sherif Krasniqi i kishte shpallur fajtor për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Sipas këtij vendimi Dardan Gashi ishte dënuar me 1,700 euro gjobë, Endrit Shala me 2400 euro gjobë, ish-kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku është dënuar me 1700 euro gjobë dhe me nga 1700 euro gjobë janë dënuar edhe tre të akuzuarit e tjerë, Behar Amerllahu, Fadil Demiri si dhe Sherif Krasniqi.⁶² Ky vendim i nxjerrë në shkallë të parë ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më 30 korrik 2019, e cila të akuzuarve u’ka kishte vërtetuar dënimet e shqiptuara nga Gjykata e Malishevës.⁶³

PTh në Gjakovë i akuzonte të akuzuarit e lartcekur se më 30 nëntor 2017 në fshatin Banjë të Malishevës, në një aheng familjar kishin shtënë me armë nga dritarja e odës së ish-zëvendëskryeministrit Fatmir Limajt në Malishevë, pasi Gjykata Themelore në Prishtinë kishte nxjerrë aktgjykim lirues ndaj Limajt në rastin e njohur si “MTPT”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Gjakovë më 6 dhjetor 2017 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj të akuzuarve të lartcekur me dyshimet se kishin kryer veprën penale të

⁶² “Dardan Gashi, Endrit Shala, Sami Lushtaku e të tjerët dënohen me gjobë për gjuajtjen me armë në odën e Fatmir Limajt”, Betimi për Drejtësi, 1 mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dardan-gashi-endrit-shala-sami-lushtaku-e-te-tjeret-denohen-me-gjobe-per-gjuajtjen-me-arme-ne-oden-e-fatmir-limajt/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

⁶³ “Apeli vërteton dënimet me gjobë ndaj Dardan Gashit, Endrit Shalës, Sami Lushtakut e të tjerëve për gjuajtjen me armë në odën e Fatmir Limajt”, Betimi për Drejtësi, 30 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimet-me-gjobe-ndaj-dardan-gashit-endrit-shales-sami-lushtakut-e-te-tjereve-per-gjuajtjen-me-arme-ne-oden-e-fatmir-limajt/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

armëmbajtjes pa leje. Kjo prokurori më 11 janar 2018 kishte nxjerr vendim për fillim të hetimeve ndaj të pandehurve të lartcekur. PTh në Gjakovë më 22 maj 2018 kishte ngritur aktakuzën ndaj gjashtë të akuzuarve si më lartë, për veprën penale armëmbajtje pa leje.

Seanca fillestare ishte mbajtur më 27 shkurt 2019, kur kishin kaluar 282 ditë nga dorëzimi i aktakuzës në gjykatë, duke mos respektuar afatin ligjor prej 30 ditësh. Në këtë seancë të akuzuarit kishin pranuar fajësinë për veprën që u ngarkohej, ndërsa shpallja e aktgjykimit ndaj tyre ishte bërë më 1 mars 2019, të cilin vendim e vërtetoi edhe shkalla e dytë gjatë vitit të kaluar.

Mirëpo, ky vendim i shpallur në shkallë të parë e më pas i vërtetuar edhe nga shkalla e dytë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Më konkretisht, kjo çështje penale është e përfshirë në shkelje të nenit 384 par.1 nën par.1.1 dhe 1.6 të KPPK-së, apo për të arsytuar më tej, gjykimin e kësaj çështje penale e ka bërë një gjykatë jo kompetente në aspektin lëndor dhe se përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin.⁶⁴

Rrjedhimisht, sipas nenit 19.1 të Ligjit për Gjykatat, përcaktohet se Departamenti për Krime të Rënda ka kompetencë për të gjykuar veprat penale të dënueshme mbi 10 vjet burgim si dhe veprat penale që konsiderohen krime të rënda sipas Kodit Penal apo Kodit të Procedurës Penale.⁶⁵ Ndërsa, neni 22.1.1.75 ka përcaktuar se si vepër penale që duhet gjykuar në Departamentin për Krime të Rënda listohet edhe armëmbajtja pa leje nga neni 374 të KPRK-së, duke e përfshirë atë në listën e krimeve të rënda.

Andaj, në rrethana të tilla, gjykimi dhe vendosja mbi këtë çështje penale është bërë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Malishevë, e më konkretisht nga Departamenti i Përgjithshëm i saj, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura, të cilat i japin kompetencë ekskluzive DKR-së në gjykimin e armëmbajtjes pa leje. Po ashtu, edhe përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin, ngase neni 19.2 i ligjit për gjykatat ka paraparë se lëndët në DKR gjykohen në trup gjykues, ndërsa kjo çështje penale për të cilën është diskutuar më lartë është vendosur nga gjykatësi i vetëm gjykues. Shkelje të tilla cenojnë themelësinë e një aktgjykimi të tillë, dhe kanë shërbyer si bazë që Apeli ta prish këtë aktgjykim, ngase kompetenca dhe përbërja e gjykatës ndër të tjera janë të listuara në grupin e shkeljeve esenciale, për të cilat Apeli kujdeset sipas detyrës zyrtare sipas nenit 394.1.1.1 të KPPK-së,⁶⁶ pa marrë parasysh faktin nëse ankuesi është thirrur në ato arsye me rastin e ankimit.

Ky gjykim, nga ngritja e aktakuzës e deri në marrjen e vendimit të formës së prerë ka zgjatur **435 ditë**.

⁶⁴ KPPK. Neni 384.1 “Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse: 1.1. përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi; 1.6. aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes”.

⁶⁵ Ligji nr. 06/1 - 054 për gjykatat, hyrë në fuqi më 3 janar 2019. Neni 19.1.

⁶⁶ Po aty. Neni 394.1 “Gjykata e Apelit shqyrton aktgjykimin në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë, por çdo herë sipas detyrës zyrtare shqyrton: 1.1. nëse ekziston shkelje e dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.1., 1.2., 1.6. dhe 1.8. deri në 1.12. të këtij Kodi”.

4. Apeli vërteton pafajësinë e të akuzuarve se kërcënuan kreun e OSHP-së për tenderin 21 milionë euro

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.1158/18

Vepra penale: “Detyrimi”, nga neni 340 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 35 të KPRK-së.

Gjykatësja: Fatime Dermaku,

Prokurori: Blerim Igrishta,

Të pandehur: Naim Sallahu, Shaban Lushtaku.

Faza e procedurës: Aktgjykim i formës së prerë.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit kanë kaluar 491 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 4 mars 2019 kishte liruar nga akuza Naim Sallahun dhe Shaban Lushtakun, të cilët nga PTh në Prishtinë akuzoheshin se kanë frikësuar dhe detyruar kryetarin e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Blerim Dina, lidhur me një tender në vlerë prej 21 milion euro. Ky aktgjykim lirues ishte shpallur me arsyetimin se nuk ishte provuar se dy të akuzuarit Sallahu e Lushtaku kanë kryer veprën penale me të cilën i ngarkonte aktakuza e PTh në Prishtinë.⁶⁷

Ky aktgjykim lirues i nxjerrë në shkallë të parë ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, me vendimin e nxjerrë më 9 korrik 2019.⁶⁸

PTh në Prishtinë i akuzonte Sallahun dhe Lushtakun se përmes forcës dhe kanosjes, kanë detyruar të dëmtuarin Blerim Dina, në cilësinë e personit zyrtar si kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), që të kryej ndonjë veprim në dëm të pasurisë publike. Sipas prokurorisë, dy të akuzuarit e kanë kanosur seriozisht për jetë të dëmtuarin Dina, duke i'u drejtuar me fjalë se “ky tender ka vlerën e njëzet e një milion eurove, kjo punë duhet të kryhet dhe kushton me jetë”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 18 tetor 2017 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj Naim Sallahut dhe Shaban Lushtakut dhe po të njëjtën ditë prokuroria ka nxjerrë edhe aktvendim për fillim të hetimeve.

⁶⁷ “Shpallen të pafajshëm të akuzuarit se kërcënuan kryetarin e OSHP-së për tenderin 21 milionësh”, Betimi për Drejtësi, 4 mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallen-te-pafajshem-te-akuzuarit-se-kercenuan-kryetarin-e-oshp-se-per-tenderin-21-milionesh/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

⁶⁸ “Apeli vërteton pafajësinë e të akuzuarve se kërcënuan kreun e OSHP-së për tenderin 21 milionësh”, Betimi për Drejtësi, 23 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-e-te-akuzuarve-se-kercenuan-kreun-e-oshp-se-per-tenderin-21-milionesh/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

Aktakuza ndaj Sallahut dhe Lushtakut ishte ngritur më 6 mars 2018, ndërsa seanca fillestare në këtë rast ishte mbajtur më 12 mars 2018, në përputhshmëri të plotë me afatin e përcaktuar në par.4 të nenit 242 të KPPRK-së.

Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte mbajtur më 18 prill 2018, apo 38 ditë pas mbajtjes së seancës fillestare. Edhe caktimi i shqyrtimit të dytë në këtë rast është bërë konform par.5 të nenit 245 të KPPRK-së, i cili parasheh mbajtjen e kësaj seance jo më herët se tridhjetë ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, ky kod ka paraparë mundësinë e paraqitjes së propozimeve deri në datën e caktuar, por jo më vonë se tridhjetë ditë nga shqyrtimi fillestar, kjo sipas kërkesës së gjykatësit”.⁶⁹

Nëse analizojmë kohëzgjatjen e këtij procesi gjyqësor, që nga ngritja e aktakuzës më 6 mars 2018, e deri në shpalljen e këtij aktgjykimi më 4 mars 2019, del se kësaj gjykate i janë dashur **364 ditë** për ta përfunduar gjykimin në shkallë të parë. Aktgjykimi lirues i nxjerrë në shkallë të parë është vërtetuar edhe nga GjA me vendimin e nxjerrë më 9 korrik të vitit të kaluar.

⁶⁹ KPPK. Neni 245. 5 “Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar”.

5. Apeli kthen në rigjykim rastin e ministres Haradinaj-Stublla të akuzuar për korrupsion

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.1250/19

Vepra penale: “mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër pasurore ose i detyrimeve financiare”, neni 437 paragrafi 2 të KPRK-së

Gjykatësi: Alban Ajvazi.

Prokurori: Bashkim Zeqaj,

E pandehura: Meliza Haradinaj.

Faza e procedurës: Rast i kthyer në rigjykim.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjyimit në shkallë të parë kanë kaluar 193 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë më 4 tetor 2019 e kishte shpallur fajtores për mos deklarim të pasurisë, Meliza Haradinaj, dhe atë e kishte dënuar me tetë muaj burg me kusht. Por, dënimi me burg ndaj saj, nuk do të ekzekutohet nëse ajo nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti.⁷⁰

E akuzuara Meliza Haradinaj, në seancë fillestare kishte mohuar fajësinë për këtë vepër penale.⁷¹

Pas shqyrtimit të ankesave të mbrojtjes, Gjykata e Apelit më 11 shtator 2020 kishte njoftuar se ky rast ishte kthyer në rigjykim, me arsyetimin se dispozitivi i aktgjyimit të ankimuar është në kundërshtim me vetveten, si dhe me arsyetimin, pasi që nuk përmban fakte vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale.⁷²

PTh në Prishtinë e akuzonte Meliza Haradinaj se me rastin e marrjes së detyrës si këshilltare politike e kryeministrit Ramush Haradinaj, më 11 shtator 2017, nuk e ka deklaruar në Agjencinë Kundër Korrupsion pronësinë e saj mbi biznesin “IN MIDDLE LTD”, të regjistruar në Londër, edhe pse ka qenë e obliguar.

⁷⁰ “Shpallet fajtores se nuk e deklaroi biznesin në Londër, dënohet me burgim me kusht dhe me gjobë këshilltarja e Ramush Haradinajt”, Betimi për Drejtësi, 4 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-fajtores-se-nuk-e-deklaroi-biznesin-ne-londer-denoht-me-burgim-me-kusht-dhe-me-gjobe-keshilltarja-e-ramush-haradinajt/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

⁷¹ “Këshilltarja e Kryeministrit të Kosovës deklarohet e pafajshme për mos raportim të pasurisë”, Betimi për Drejtësi, 20 maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/keshilltarja-e-kryeministrit-te-kosoves-deklarohet-e-pafajshme-per-mos-raportim-te-pasurise/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

⁷² “Apeli e kthen në rigjykim rastin e ministres Haradinaj-Stublla, e akuzuar për korrupsion”, Betimi për Drejtësi, 11 shtator 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-ministres-haradinaj-stublla-e-akuzuar-per-korrupsion/>). (Qasur së fundi më 5 tetor 2020).

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 16 janar 2019 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar ndaj Meliza Haradinaj nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Kjo prokurori më 8 shkurt 2019 kishte autorizuar ndërmarrjen e veprimeve hetimore ndaj saj, për mos deklarim të pasurisë.

Aktakuza ndaj Meliza Haradinaj për mos deklarim të pasurisë ishte ngritur më 29 mars 2019.

Seanca fillestare ndaj saj ishte mbajtur më 20 maj 2019, pas më shumë se 53 ditëve nga ngritja e aktit akuzues, duke mos respektuar afatin prej 30 ditësh të përcaktuar me nenin 242.4 të KPPK-së. Shqyrtimi i dytë në këtë çështje penale nuk ishte caktuar, por nga palët ishte kërkuar që brenda 20 ditë të paraqitnin kërkesat për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave.

Në seancën fillestare, ministrja Haradinaj-Stublla kishte mohuar në tërësi aktakuzën për mos deklarim të pasurisë, duke deklaruar se ndihej absolutisht e pafajshme.

Aktakuza ndaj Haradinajt ishte konfirmuar më 28 qershor 2019, pasi gjykata kishte marrë vendim që refuzonte kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin për provat e përfshira në aktin akuzues, të ushtruara nga mbrojtësja e të akuzuarës.⁷³ Ndërsa shqyrtimi gjyqësor ndaj saj kishte përfunduar më 1 tetor 2019. Shpallja e aktgjykimit ndaj saj ishte bërë 3 ditë më pas. Ndërsa, Apeli, kur kishin kaluar më shumë se një vit që nga vendimi i nxjerrë në shkallë të parë, më 11 shtator 2020 ka njoftuar se ky rast ishte kthyer në rigjykim.

Ky gjykim që nga ngritja e aktakuzës e deri në marrjen e vendimit në shkallë të parë ka zgjatur plot **193 ditë**.

⁷³ “Konfirmohet aktakuza ndaj këshilltares së kryeministrit Haradinaj për mos deklarimin e biznesit në Londër”, Betimi për Drejtësi, 28 qershor 2019, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ndaj-keshilltares-se-kryeministrit-haradinaj-per-mos-deklarimin-e-biznesit-ne-londer/>). (Qasur së fundi më 5 tetor 2020).

6. Rrahim Hashimi e Kadri Rexhepi dënohen me mbi 6 vjet burg për mashtrim

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.3651/18

Vepra penale: “*mashtrimi*”, nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykatësja: Medie Bytyçi,

Prokurore: Rukije Shasivari

Të pandehur: Rrahim Hashimi, Kadri Rexhepi.

Faza e procedurës: Aktgjykim i dhënë në shkallë të parë.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë kanë kaluar 708 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 26 shkurt 2020 kishte shpallur fajtor dy të akuzuarit për mashtrim, Rrahim Hashimi e Kadri Rexhepi. Rrahim Hashimi, ishte dënuar me tre vjet e nëntë muaj burg, ndërsa Kadri Rexhepi me tre vjet burg.⁷⁴

Kjo lëndë ndaj Rrahim Hashimit dhe Kadri Rexhepit fillimisht kishte filluar të gjykohej nga Gjykata Themelore në Ferizaj, por e njëjta më 6 gusht 2018, ishte shpallur jo kompetente në pikëpamje territoriale, duke transferuar këtë lëndë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila kishte filluar të procedonte me këtë rast në qershor të vitit 2019.

PTh në Ferizaj e akuzon Hashimin dhe Rexhepin se ata në periudhën kohore prej 30 dhjetor 2011, deri më 24 korrik 2012, në Prishtinë, në zyrën e të dëmtuarit Faton Dalladaku, së bashku me të pandehurin tjetër Ekrem Lika, i cili është arrestuar më 18 prill 2020⁷⁵, pasi ndodhej në arrati, janë prezantuar rrejtshëm para të dëmtuarit dhe atë i akuzuari Rrahim Hashimi, si i afërm i ish-kryeparlamentarit Kadri Veselit dhe ish-deputetit Xhavit Halitit, ndërsa i akuzuari Ekrem Lika si dhëndër i Veselit, ashtu që të tre së bashku kinse po ndërmjetësonin për blerjen e Qendrës Kardiake të Kosovës SH.P.K në Prishtinë nga i dëmtuari Dalladaku.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

I dëmtuari Faton Dalladaku më 27 korrik 2016 në Drejtorinë e Krimeve të Rënda pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës në Prishtinë kishte deklaruar se nga viti 2011 kishte qenë viktimë e mashtrimit nga grupet kriminale të organizuara.

Më pas, Njësia për Hetimin e Krimeve Ekonomike (NJHKEK) në Ferizaj kishte dorëzuar më 26 shtator 2017 materiale dhe shkresa që ndërlidheshin me raportimet e të dëmtuarit Dalladaku,

⁷⁴ “Të akuzuarit për mashtrim, Rrahim Hashimi e Kadri Rexhepi dënohen me mbi 6 vjet burg”, Betimi për Drejtësi, 26 shkurt 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/te-akuzuarit-per-mashtrim-rrahim-hashimi-e-kadri-rexhepi-denohen-me-mbi-6-vjet-burg/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

⁷⁵ “Një muaj paraburgim ndaj të akuzuarit për mashtrim, Ekrem Lika”, Betimi për Drejtësi, 21 prill 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nje-muaj-paraburgim-ndaj-te-akuzuarit-per-mashtrim-ekrem-lika/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

derisa PTH në Ferizaj më 2 nëntor 2017 kishte kërkuar nga NJHKEK në Ferizaj ndërmarrjen e veprimeve hetimore ndaj të dyshuarve Hashimi, Rexhepi dhe Lika.

Vetëm më 29 janar 2018 kjo prokurori kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga NJKEK ndaj Rrahim Hashimit, Kadri Rexhepi dhe Ekrem Likës.

Nëse llogarisim kohën kur i dëmtuari ka paraqitur rastin në polici, pra datën **27 korrik 2016**, dhe kohën kur kallëzimi penal është dorëzuar në prokurori nga ana e policisë, **29 janar 2018**, rezulton se kanë kaluar **552 ditë**, apo më shumë se një vjet e gjashtë muaj.

Lidhur me këtë, KPPK në paragrafin nenin 70.4 të saj, e obligon policinë që brenda 24 orësh ti dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit, posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare.⁷⁶

Ndërsa, NJHKEK vetëm më 26 shtator 2017 kishte dorëzuar një raport të tillë tek PTh në Ferizaj, apo **427 ditë** pas i dëmtuari kishte paraqitur rastin në polici.

Aktvendimi për fillim të hetimeve ndaj të pandehurve të lartcekur ishte marrë 31 janar 2018, ndërsa aktakuza ndaj Hashimit, Rexhepit ishte ngritur më 21 mars 2018, brenda afatit të paraparë ligjorë për ngritjen e aktit akuzues.

Edhe pse aktakuza ishte ngritur më **21 mars 2018**, GjTh në Ferizaj nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për caktimin e seancës fillestare, por e njëjta në gusht të vitit 2018 ishte shpallur jo kompetente në pikëpamje territoriale për gjykimin e kësaj lënde, duke e transferuar atë në GjTh në Prishtinë.

Pra, GjTh në Ferizaj, i janë dashur afër **5 muaj** për ta vlerësuar se a është kompetente në pikëpamje territoriale për t'a gjykuar këtë çështje penale.⁷⁷

Sa i përket gabimit në vlerësimin e kompetencës, IKD vlerëson se përballë faktit se ligji është shumë i qartë në këtë rast, IKD konsideron se veprimi që lidhur me këtë lëndë të procedohet në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ka qenë veprim i pa arsyeshëm, i cili ka ndikuar konsiderueshëm në zvarritjen e këtij procesi gjyqësor.

Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte caktuar seancën fillestare ndaj Hashimit dhe Rexhepit vetëm me 26 qershor 2019, apo **325 ditë** pas ngritjes së aktakuzës, apo kur kishin kaluar afër një vit pas pranimit të kësaj lënde nga kjo gjykatë.

Caktimi i seancës fillestare pas 325 ditësh, paraqet shkelje të afatit të paraparë me ligj për mbajtjen e seancës fillestare, ku par. 4 i nenit 242 të KPPK-së shprehimisht parasheh caktimin e saj brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës në gjykatë.

⁷⁶ KPPK. Neni 70.4 “Posa policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia është e detyruar që brenda njëzet e katër (24) orëve t’i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale”.

⁷⁷ Po aty. Neni 242.3 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton sipas detyrës zyrtare nëse ka kompetencë mbi çështjen që përbën aktakuzën”.

Shqyrtimi i dytë në këtë çështje penale nuk është mbajtur, mirëpo kundërshtimet dhe kërkesat për hedhjen e të akuzuarve janë paraqitur më 24 dhe 27 korrik nga mbrojtja, e të cilat janë refuzuar nga gjykata me vendimin e nxjerrë më 14 gusht 2019.

Shqyrtimi gjyqësor ndaj dy të akuzuarve për mashtrim kishte filluar më 14 shkurt 2020 dhe kishte përfunduar më 24 shkurt. Shpallja e aktgjykimit ishte bërë dy ditë më pas.

Ky gjykim, që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e vendimit në shkallë të parë ka zgjatur plot **708 ditë**.

7. Pushohet gjykimi ndaj Frashër Krasniqit dhe 21 aktivistëve të VV-së

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: 3176/16

Vepra penale: “Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi”, nga neni 412 par.1 të KPRK-së

Gjykatësi: Alban Ajvazi,

Prokurori: Ali Hajdini,

Të pandehur: Frashër Krasniqi, Gëzon Kastrati, Bekim Gashi, Adem Megjuani, Egzon Azemi, Agron Kabashi, Petrit Ademi, Nora Fetoshi, Etleva Malushaj, Egzon Balaj, Rejhan Fejza, Fatos Sahiti, Pleurat Thaqi, Durim Elshani, Alban Makolli, Arbër Sejdiu, Flamur Pireva, Boiken Abazi, Zgjim Hyseni, Imer Fejza, Dritëro Çadraku dhe Arianit Manxhuka.

Faza e procedurës: Vendim për hedhje të aktakuzës.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e procedurës penale kanë kaluar 1010 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, në qershor të vitit 2019 kishte pushuar procedurën penale ndaj Frashër Krasniqit dhe të tjerëve, të cilët akuzoheshin për veprën penale “Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi”.⁷⁸

Ky vendim për hedhje të kësaj aktakuze ishte marrë pasi prokurori i PTh në Prishtinë, Ali Hajdini, më 18 prill 2019 ishte tërhequr nga akti akuzues, të cilin vet kjo prokurori e kishte ushtruar ndaj këtyre 22 të akuzuarve.

Ish-deputeti Krasniqi dhe bashkëpartiake i tij, Zgjim Hyseni, dhe zyrtarët e VV-së, Boiken Abazi e Etleva Malushaj, si dhe aktivistë të tjerë, akuzoheshin për “pjesëmarrje në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizëm”, lidhur me protestën e organizuar në janar të vitit 2015, në të cilën kërkoheshin shkarkimi i ministrit të atëhershëm për Komunitete dhe Kthim, Aleksandar Jabllanoviq.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh Prishtinë më 16 janar 2015 kishte pranuar kallëzimin penal ndaj këtyre 22 të akuzuarve. Ndërsa, aktvendimin për fillim të hetimeve kjo prokurori e kishte nxjerrë më 21 qershor 2016, apo 523 ditë pas paraqitjes së kallëzimit penal.

Aktakuza ndaj Krasniqit dhe 21 të akuzuarve të tjerë ishte ngritur më 18 korrik 2016 apo 28 ditë pas fillimit të hetimeve dhe **550 ditë** prej kohës së paraqitjes së kallëzimit penal në PTh. Ndërsa, seanca fillestare në këtë çështje penale nuk kishte arritur të mbahej asnjëherë, ashtu që kjo lëndë kishte qëndruar e mbyllur në sirtarët e gjykatës për afro **tre vite** që nga ngritja e aktakuzës.

⁷⁸ “Pushon procedura penale ndaj deputetit Frashër Krasniqi dhe të tjerëve lidhur me protestën për shkarkimin e ish-ministrit Jabllanoviq”, Betimi për Drejtësi, 5 qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pushon-procedura-penale-ndaj-deputetit-frasher-krasniqi-dhe-te-tjereve-lidhur-me-protesten-per-shkarkimin-e-ish-ministrit-jabllanoviq/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

Kjo situatë paraqet shkelje të afatit ligjor, përkatësisht nenit 242.4 të KPPRK-së i cili ka përcaktuar obligimin e gjykatës që të caktoj shqyrtimin fillestar brenda **30 ditësh** pas ngritjes së aktakuzës.

Andaj, mos respektimi i këtij afati nga ana e gjykatës mund të cilësohet si një shkelje serioze në raport me ligjshmërinë e këtij procesi gjyqësor, me ç'rast 22 të akuzuarve në këtë rast u është pamundësuar e drejta që të njoftohen me veprën e cila u ngarkohej dhe rrjedhimisht edhe e drejta e tyre që në fazat e mëtejshme ta kundërshtonin aktakuzën dhe të bënin kërkesë për hedhje të saj, para se prokurori të tërhiqej nga ndjekja penale, kur kishin kaluar tri vjet nga ngritja e aktit akuzues.

Ndërsa, akti i heqjes dorë të prokurorit nga akti akuzues, me arsyetimin se “provat që gjenden në shkresat e lëndës janë thelbësisht të pa mbështetshme dhe thelbësisht të pabesueshme dhe si të tilla nuk mund të vërtetojnë elementet qenësore të kësaj vepre penale”, tregon për një mungesë profesionalizmi të prokurorisë qysh në fazën e zhvillimit të hetimeve e më pas edhe me rastin e ngritjes së kësaj aktakuze.

Veprime të tilla të ndërmarra pa kurrfarë arsyetimi ligjor paraqesin cenim të sigurisë juridike, si njëri ndër parimet themelore në procedurë penale, dhe ndikojnë në rënien e indeksit të besimit të qytetarëve në pavarësinë, paanësinë dhe profesionalizimin e organit të akuzës.

Në këtë rast, të pandehurit janë persekutuar për afro tre vite deri në kohën kur prokurori ka konstatuar se aktakuza e tij nuk mbështetet në prova. Nga paraqitja e kallëzimit penal e deri në nxjerrjen e vendimit për fillim të hetimeve në këtë rast kanë kaluar 523 ditë.

Ndërsa, kohëzgjatja e këtij procesi gjyqësor, që nga ngritja e kësaj aktakuze më 18 korrik 2016, e deri në pushimin e procedurës penale më 23 prill 2019, përfshin plot **1010 ditë**.

8. Shkon në ndërmjetësim rasti i përlshjes së dy deputetëve në një studio televizive

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.5005/17

Vepra penale: “lëndim i lehtë trupor”, “kanosje”, nga neni 188 dhe 185 të KPRK-së.

Gjykatësi: Hanefi Jashari,

Prokurori: Fatmir Behrami,

Të pandehur: Frashër Krasniqi, Milaim Zeka.

Faza e procedurës: Rast i referuar në procedurë të ndërmjetësimi.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në referimin për ndërmjetësim kanë kaluar 741 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 5 nëntor 2019 e kishte dërguar në procedurë të ndërmjetësimi rastin ndaj dy ish-deputetëve Frashër Krasniqi e Milaim Zeka, për përlshjen në studion televizive të Klan Kosovës.⁷⁹

PTh në Prishtinë akuzonte ish-deputetët Krasniqi dhe Zeka se me 29 shtator 2017 në një studio televizive, kanë filluar ta fyejnë njëri-tjetrin, ashtu që i pandehuri Frashër Krasniqi ka sulmuar fizikisht deputetin Zeka duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, e më pas Zeka i ishte drejtuar Krasniqit me fjalët “me ty do të merrem pas emisionit”, me ç’rast tek Krasniqi ka shkaktuar ndjenjën e frikësimit se do ti shkactohej ndonjë të keqe.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 30 shtator 2017 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj ish-deputetëve Krasniqi dhe Zeka dhe po të njëjtën ditë kjo prokurori ka nxjerrë edhe aktvendim për fillimin e hetimit.

Ndërsa, aktakuza ndaj dy deputetëve ishte ngritur më 26 tetor 2017, që nënkupton se aktakuza në këtë rast ishte ngritur në afat rekord.

Por, GjTh në Prishtinë vetëm më 23 korrik 2019 ndërmori veprimet e para procedurale për mbajtjen e shqyrtimit fillestar ndaj këtyre dy deputetëve. Mirëpo, këto përpjekje të gjykatës, për mbajtjen e seancës fillestare nuk ishin treguar efektive, ngase katër herë me radhë kishte dështuar mbajtja e asaj seance, kryesisht për shkak të mungesës së të akuzuarve.⁸⁰

Për më tepër, përkundër dështimit të mbajtjes së shqyrtimit fillestar në rastin e parë, edhe tri tentativa të tjera të GjTh në Prishtinë për mbajtjen e kësaj seance kanë rezultuar të dështuara,

⁷⁹ “Milaim Zeka nuk e pranon fajin, kurse Frashër Krasniqi po, ish-deputetët pajtohen që rastin ta zgjidhin me ndërmjetësim”, Betimi për Drejtësi, 5 nëntor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/milaim-zeka-nuk-e-pranon-fajin-kurse-frasher-krasniqi-po-ish-deputetet-pajtohen-qe-rastin-ta-zgjidhin-me-ndermjetesim/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

⁸⁰ “As për herën e katërt s’mbahet gjykimi për përlshjen fizike ndaj ish-deputetëve Frashër Krasniqi e Milaim Zeka”, Betimi për Drejtësi, 4 nëntor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/as-per-heren-e-katert-smbahet-gjykimi-per-perleshjen-fizike-ndaj-ish-deputeteve-frasher-krasniqi-e-milaim-zeka/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

si ajo e 7 gushtit, 20 shtatorit dhe 4 nëntorit të vitit 2019. Përfundimisht, seanca fillestare ishte mbajtur më 5 nëntor 2019.

Pra, kësaj gjykate i janë dashur më shumë se dy viteve që të arrij të mbaj shqyrtimin fillestar ndaj dy të akuzuarve, veprim ky në kundërshtim me par.4 të nenit 242 të KPPRK-së, i cili përcakton afatin ligjore prej një muaji për mbajtjen e kësaj seance, pas ngritjes së aktakuzës.

IKD vlerëson se gjykatësi i çështjes ka aplikuar një qasje jo ligjore në raport me të akuzuarit, ngase Kodi i Procedurës Penale i ka ofruar të gjitha mjetet ligjore për të siguruar praninë e të akuzuarve në procedurë penale, dhe për të penguar zvarritjen e procesit gjyqësor. Në rastin konkret, gjykatësi ka qenë i obliguar që konform nenit 173 par.1 nën par. 1.2 dhe 1.9 të KPPK-së, të lëshojë urdhër arrest, e deri tek privimi i lirë përmes paraburgimit pasi që dy të akuzuarit nuk i ishin përgjigjur vullnetarisht thirrjeve të gjykatës, edhe pse për një gjë të tillë i obligon ligji, pa marrë parasysh statusin e tyre shoqëror⁸¹. Me këtë rast, IKD vlerëson se një mënyrë e tillë e veprimit është administrim jo i mirë e drejtësisë dhe zbehje e autoritetit të gjykatës.

Aktakuza e ngritur nga PTH në Prishtinë ndaj ish-deputetëve Krasniqi e Zeka për përleshjen e “famshme” të 29 shtatorit 2017 në një studio televizive, ishte e mbajtur e fshehur për publikun për më shumë se një vit e gjysmë, derisa “Betimi për Drejtësi” më 19 korrik 2019 kishte raportuar ekskluzivisht për këtë aktakuzë.

Fakti që kjo aktakuzë është mbajtur e “fshehur” si nga prokuroria ashtu edhe nga gjykata paraqet një qasje selektive të sistemit të drejtësisë. Përkundër faktit se në rastin konkret aktakuza ishte ngritur ndaj dy ish-deputetëve të cilët ishin përleshur në një emision televiziv, as PTh në Prishtinë e as GjTh në Prishtinë nuk kishin njoftuar opinionin publik se çfarë ka ndodhur me këtë rast, kur dihet se këto veprime të ish-deputetëve, sipas prokurorisë përmbanin elemente të veprës penale, e për më tepër ishin kryer para syve të publikut. Në anën tjetër, në raste të ngjashme, Prokurori i Shtetit lëshon komunikatë për media, gjë të cilën nuk e ka bërë në këtë rast.

Ky proces gjyqësor, që nga ngritja e aktakuzës e deri në dërgimin në procedurë të ndërmjetësimit ka zgjatur **741 ditë**.

⁸¹ KPPK. Neni 173.1 “Masat të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale janë: 1.2 “1.2. urdhërarrestit” dhe 1.9 “paraburgimi”.

9. Prokuroria tërhiqet nga aktakuza, pushohet procedura penale ndaj ish-deputetit Liburn Aliu

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.2499/19

Vepra penale: “pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”, nga neni 409 par.1 të KPRK-së.

Gjykatësi: Kushtrim Shyti,

Prokurori: Besart Mustafa,

I pandehur: Liburn Aliu.

Faza e procedurës: Vendim për hedhje të aktakuzës.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e procedurës penale kanë kaluar 82 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë më 15 tetor 2019 e kishte pushuar procedurën penale ndaj deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, i cili akuzohej për veprën penale “pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”.⁸²

Vendimin për hedhjen e kësaj aktakuze e ka marr gjykatësi Kushtrim Shyti, pasi që Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka hequr dorë nga kjo aktakuzë.

PTh në Prishtinë e akuzonte Aliun se më 21 mars 2018 në sallën e Kuvendit të Kosovës, kishte marrë nga tavolinat e deputetëve 40 kartela zyrtare që shërbejnë për votim, me qëllim që të pamundësohej votimi i marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 22 mars 2018 ka pranuar kallëzimin penal nga Policia e Kosovës ndaj të pandehurit Liburn Aliu, nën dyshimet se ai kishte kryer veprën penale “pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”. Po të njëjtën ditë kjo prokurori kishte filluar hetimet ndaj Aliut në drejtim të veprës penale të lartcekur.

Aktakuza për pengim të personit zyrtar ndaj deputetit Aliu ishte ngritur më 26 korrik 2019.

Mirëpo kjo aktakuzë asnjëherë nuk e pati fatin që të ballafaqohej me kundërshtimet e mbrojtjes e as me kërkesat e tyre për hedhje të kësaj aktakuze, në sallën e gjykatës.

Kjo, ngase akoma pa u proceduar aktakuza në fjalë nga gjykata, vet prokurori i cili e kishte ushtruar atë aktakuzë, përmes një parashtrese të dorëzuar në gjykatë më 30 shtator 2019, njoftonte heqjen dorë nga ndjekja penale.

Pra, për vetëm dy muaj, prokurori në fjalë kishte ndryshuar qasjen e tij ndaj aktit akuzues të ngritur nga vetë ai. Përderisa më 26 korrik 2019, ai ushtronte këtë aktakuzë me arsyetimin se

⁸² “Prokuroria tërhiqet nga aktakuza, pushohet procedura penale ndaj ish-deputetit Liburn Aliu”, Betimi për Drejtësi, 15 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-terhiqet-nga-aktakuza-pushohet-procedura-penale-ndaj-ish-deputetit-liburn-aliu/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

ishte tejkualuar shkalla e dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari Liburn Aliu kishte kryer veprën penale që i ngarkohej.

Ndërsa, pasi kishin kaluar dy muaj nga ushtrimi i kësaj aktakuze, prokurori në fjalë kishte ndryshuar mendje, duke njoftuar se tërhiqej nga ndjekja penale, ashtu që tashmë sipas tij, nuk ekzistonte dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari Aliu ka kryer veprën penale “pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”.

IKD vlerëson se në rastin konkret shpërfaqet një mungesë totale e profesionalizmit nga ana e prokurorit të rastit, përkundër asaj se Ligji mbi Prokurorin e Shtetit ka përkufizuar prokurorin si “institucionin e pavarur, kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale dhe veprave të tjera siç ceken me ligj”. Veprime të këtilla, tek opinioni publik nxisin dyshime serioze mbi pavarësinë dhe paanësinë e Prokurorit të Shtetit. Veçanërisht, një mënyrë e tillë e veprimit nga organi i akuzës paraqet cënim serioz të sigurisë juridike të qytetarëve.

Ky gjykim ka zgjatur plot **82 ditë**, nga ngritja e aktit akuzues e deri tek vendimi për pushim të procedurës penale, për shkak të heqjes dorë të prokurorit nga akti akuzues.

10. Prokuroria ngritë aktakuzë ndaj personit që ka vdekur më 2008, pushohet procedura ndaj tij

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.2884/17

Vepra penale: “vjedhja e shërbimeve komunale”, nga neni 320 të KPRK-së

Gjykatësja: Fatime Dermaku

Prokurorja: Rukije Shasivari

I pandehuri: Sh.I

Faza e procedurës: Vendim për hedhje të aktakuzës.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e procedurës penale kanë kaluar 793 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë më 21 gusht 2019 kishte pushuar procedurën penale ndaj të akuzuarit për vjedhje të shërbimeve komunale, Sh.I.⁸³

Hedhja e aktakuzës ndaj Sh.I ishte bërë pasi gjykata kishte pranuar verifikimin zyrtar nga Komuna e Prishtinës, me të cilën dëshmohej se ai kishte ndërruar jetë më 14 tetor 2008.

PTh në Prishtinë e akuzonte Sh,I se më 8 dhjetor 2016, me rastin e kontrollit të bërë nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, në shtëpinë e të akuzuarit Sh.I është konstatuar se i njëjti pa leje apo autorizim të furnizuesit të autorizuar, e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm është furnizuar me energji elektrike.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 17 janar 2017 kishte pranuar kallëzimin penal nga KEDS-i, ndaj të pandehurit Sh.I, me dyshimin se ai kishte kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale.

Kjo prokurori, pas pranimit të kallëzimit penal, nuk kishte autorizuar ndërmarrjen e veprimeve hetimore, por më 20 qershor 2017 kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj Sh.I, për veprën penale të lartcekur.

KPPRK-ja, në par.2 të nenit 101 ka paraparë mundësinë e ngritjes së aktakuzave të drejtpërdrejta, pa zhvillim të hetimeve, për veprat penale të dënueshme deri në tri vjet burgim.⁸⁴

Mirëpo, kjo zgjidhje në praktikë ka krijuar situata të pakëndshme, ashtu që në cilësinë e të akuzuarve kanë përfunduar edhe personat që kishin vdekur shumë kohë para ngritjes së

⁸³ “Prokuroria ngritë aktakuzë ndaj personit që ka vdekur më 2008, pushohet procedura ndaj tij”, Betimi për Drejtësi, 26 gusht 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ngrite-aktakuze-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-me-2008-pushohet-procedura-ndaj-tij/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

⁸⁴ KPPK. Neni 101.2 “Kur policia apo ndonjë person tjetër bën kallëzim tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një veprë penale ose për disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim, dhe prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, prokurori i shtetit mund të ngrit aktakuzë sipas nenit 241 të këtij Kodi”.

aktakuzës. Kjo për arsye se në këto raste, ngritja e aktakuzës pa zhvilluar fare hetime është bërë tanimë parim.

Seanca fillestare në këtë rast ishte caktuar më 24 qershor 2019, apo kur kishin kaluar më shumë se dy vite që nga ushtrimi i kësaj aktakuze në gjykatë.

Kjo paraqet shkelje të afatit të paraparë me par.4 të nenit 242 të KPPRK-së, ku përcaktohet qartë obligimi që ka gjykata në caktimin e kësaj seance brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktit akuzues.

Më 11 korrik 2019, gjykata kishte lëshuar urdhëresë drejt Komunës së Prishtinës, për të kryer verifikimet e nevojshme për statusin jetësor të të akuzuarit Sh.I. Më 16 gusht 2019, gjykata kishte pranuar certifikatën e vdekjes për të akuzuarin, ku vërtetohej se ai kishte ndërruar jetë më 14 tetor 2008.

IKD vlerëson se është veprim i papranueshëm i prokurorit të rastit, që të mos bëjë verifikimin e të dhënave personale të personit i cili dyshohet se ka kryer një vepër penale të caktuar, por vetëm të bazohet në kallëzimin penal të ushtruar nga KEDS-i. Veprime të tilla shpërfaqin një mungesë kujdesi profesional dhe kanë ndikuar që shumë persona të persekutohen pa të drejtë nga organet e ndjekjes, apo të mbahen në evidencat penale për vite të tëra pa të drejtë, për shkakun e vetëm që prokuroria ka ngritur aktin akuzues, bazuar vetëm në informatat e siguruar nga një kallëzim penal.

Ky gjykim, që nga ngritja e aktit akuzues e deri në pushimin e kësaj procedure ka zgjatur plot **793 ditë**.

11. Vazhdon ngritja e akuzave ndaj të vdekurve

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.5448/16

Vepra penale: “vjedhja e shërbimeve komunale”, nga neni 323 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Gjykatësi: Alban Ajvazi

Prokurorja: Nebahate Salihu

I pandehuri: I.I

Faza e procedurës: Vendim për hedhje të aktakuzës

Nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e procedurës penale kanë kaluar 970 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë më 16 gusht 2019 kishte marr vendim për hedhjen e kësaj aktakuze dhe pushimin e kësaj procedure penale ndaj të akuzuarit për vjedhje rryme, I.I.⁸⁵

Një vendim të tilla e kishte marr gjykata, pasi vërtetimit se i akuzuari kishte vdekur në vitin 2007 dhe ishte futur në regjistrin e të vdekurve.

PTh në Prishtinë e akuzonte I.I se ka bërë anashkalimin e njësisë matëse-njehsorit elektrik, duke futur shiritin filmik nga ana e djathtë për ta penguar punën e diskut dhe me qëllim që rryma e shpenzuar të mos regjistrohet dhe faturohet fare.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 15 qershor 2016 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga KEDS-i ndaj të pandehurit I.I me dyshimin se kishte kryer veprën penale vjedhje rryme,

Kjo prokurori më 20 dhjetor 2016 kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj I.I.

Seanca fillestare ndaj të akuzuarit I.I ishte caktuar më 25 korrik 2019, pas më shumë se dy vite e shtatë muaj nga dorëzimi i aktakuzës në gjykatë, seancë kjo e cila kishte dështuar që të mbahej.

Më 7 gusht të vitit të kaluar, gjykata kishte kërkuar nga policia, që të verifikonte statusin jetësor të të akuzuarit I.I. Gjykata kishte pranuar njoftimin se i akuzuari kishte vdekur qysh në vitin 2007. Në këto rrethana, gjykata kishte hedhur aktakuzën dhe kishte pushuar procedurën penale ndaj I.I, konform nenit 358 par.1 nën par.1,3 të KPPK-së.⁸⁶

Nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e kësaj procedure kanë kaluar **970 ditë**.

⁸⁵ “Vazhdon ngritja e aktakuzave ndaj personave që kanë vdekur shumë vite më parë, një e tillë sërish hudhet poshtë”, Betimi për Drejtësi, 27 gusht 2019 (<https://betimiperdrejtesi.com/vazhdon-ngritja-e-aktakuzave-ndaj-personave-qe-kane-vdekur-shume-vite-me-pare-nje-e-tille-serish-hudhet-poshte/>). (Qasur së fundi më 28 prill 2020).

⁸⁶ KPPK, 358.1 “Trupi gjykues me aktvendim e hudh aktakuzën kur: 1.3. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen”.

12. Akuzohej se vodhi 20 euro, prokurori tërhiqet nga ndjekja penale ndaj tij

GjTh në Prizren, Dega në Dragash

Numri i lëndës: P.nr.169/16,

Vepra penale: “vjedhja”, nga neni 325, par. 2 të KPRK-së.

Gjykatësja: Sabaheta Kurteshi

Prokurori: Besim Susuri

I pandehuri: Vahit Hoxha

Faza e procedurës: Aktgjykim refuzues

Nga ngritja e aktakuzës e deri në nxjerrjen e aktgjykimit refuzues kanë kaluar 1102 ditë.

Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Dragash më 13 nëntor 2019 ka marrë aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarit për vjedhje, Vahit Hoxha, pas tërheqjes së prokurorit nga ndjekja penale.⁸⁷

PTh në Prizren e akuzonte Hoxhën se më 12 tetor 2015, në fshatin Restelicë të Dragashit, shkon në shtëpinë e të dëmtuarës N.S, dhe nga aty merr shumën e të hollave prej 20 eurosh dhe largohet nga vendi i ngjarjes.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prizren, më 19 tetor 2015 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj të pandehurit Vahit Hoxha, me dyshimin se ai kishte kryer veprën penale “vjedhje”.

Kjo prokurori më 7 nëntor 2016 kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj të akuzuarit Hoxha, për veprën penale të lartcekur.

Seanca fillestare ndaj Hoxhës ishte mbajtur më 26 dhjetor 2016, ndërsa shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 29 mars 2017, apo 94 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, duke mos respektuar nenin 245.5 të KPPK-së, sipas së cilit shqyrtimi i dytë caktohet jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar.⁸⁸

Shqyrtimi gjyqësor kishte filluar më 24 gusht 2017, për të përfunduar me aktin e tërheqjes së prokurorit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 13 nëntor 2019.

⁸⁷ “Akuzohej se vodhi 20 euro, prokurori tërhiqet nga ndjekja penale ndaj tij”, Betimi për Drejtësi, 13 nëntor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/akuzohej-se-vodhi-20-euro-prokurori-terhiqet-nga-ndjekja-penale-ndaj-tij/>). (Qasur së fundi më 29 prill 2020).

⁸⁸ KPPK. Neni 245.5 “Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar”.

Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor ka tejkalluar afatet e përcaktuara me nenin 314.1.1,1 të KPPK-së, ku përcaktohet se në rastet kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, ai duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana që kërkojnë më shumë kohë, të përcaktuar me par.2 të nenit 314 të KPPK-së, paragraf ky në të cilin janë arsyetuar rrethanat të cilat kërkojnë më shumë kohë sesa ajo e paraparë me nenin 314.1, si numri i madh i dëshmitarëve, dëshmia e një apo më shumë dëshmitarëve është shumë e gjatë, numri i provave është jashtëzakonisht i madh dhe siguria e shqyrtimit gjyqësor bën të nevojshme vazhdimin. Sipas kësaj dispozite shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet me aktvendim të arsyetuar.⁸⁹ Afatet e tilla të përcaktuara me nenin 314.1 të KPPK-së, sa i përket përfundimit të shqyrtimit gjyqësor kanë për qëllim që të sigurojnë një rrjedhë të atillë të procesit gjyqësor në mënyrë që gjykimi të përfundojë brenda një afati të arsyeshëm kohor, duke i garantuar të pandehurit të drejtën në gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.

Më 13 nëntor 2019 gjykata kishte shpallur aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarit për vjedhje, Vahit Hoxha. Mirëpo, paraprakisht prokurori i rastit ishte tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit Hoxha, me arsyetimin se kjo vepër penale ishte e një rëndësie të vogël.

Mirëpo, në rastin konkret dhe sipas përshkrimit faktik të ngjarjes dhe veprimeve të të akuzuarit të përfshira në aktakuzë, rezulton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore që kjo vepër penale të cilësohej si vepër e rëndësisë së vogël. Kjo ngase vepra penale “vjedhja”, e paraparë në nenin 325, paragrafi 2 e Kodit Penal të Kosovës përfshinte në vete këto veprime “*Nëse vlera e pasurisë së vjedhur është më pak se pesëdhjetë (50) Euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj*”. Pra, sipas kodit penal, në veprimet e të akuzuarit përmbushen elementet objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale të përshkruar si më lartë.

Bazuar në përshkrimin faktik të bërë në aktakuzë, rezulton se i akuzuari kishte përvetësuar në mënyrë të paligjshme pasurinë e tjetrit.

Vepra penale të rëndësisë së vogël, sipas nenit 11 të KRPRK-së, përcaktohen ato vepra “kur rrezikshmëria e saj është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës; mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; rrethanave në të cilat është kryer vepra; shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose rrethanave personale të kryesit”.

Ky gjykim, që nga ngritja e aktakuzës e deri në përfundimin e kësaj procedure me aktgjykim refuzues, ka zgjatur **1102 ditë apo 3 vjet e 7 ditë**.

⁸⁹ KPPK. Neni 314.2 “*Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet me aktvendimin të arsyetuar nga paragrafi 1. i këtij neni kur ekzistojnë rrethana të cilat kërkojnë më shumë kohë, përfshirë por pa u kufizuar në: 2.1. numër të shumtë të dëshmitarëve; 2.2. dëshmia e një apo më shumë dëshmitarëve është shumë e gjatë; 2.3. numri i provave është jashtëzakonisht i madh; 2.4. siguria e shqyrtimit gjyqësor bën të nevojshme vazhdimin*”.

13. Burg me kusht dhe gjobë ndaj të akuzuarit që pranoi se vodhi 13 pula e 3 gjela

GjTh në Gjakovë, Dega në Rahovec

Numri i lëndës: P.nr.20/17,

Vepra penale: “vjedhja”, nga neni 325 të KPRK-së.

Gjykatësi: Mizahir Shabani

Prokurori: Armend Zenelaj

I pandehuri: Edmond Limanaxhiu

Faza e procedurës: Aktgjykim i dhënë në shkallë të parë

Nga ngritja e aktakuzës e deri në nxjerrjen e aktgjykimit dënues kanë kaluar 1145 ditë.

Gjykata Themelore në Gjakovë, Dega në Rahovec më 24 shkurt 2020 e kishte shpallur fajtor të akuzuarin Edmond Limanaxhiu, se në dy raste kishte vjedhur gjithsej 13 pula dhe 3 gjela.⁹⁰

Për dy vepra penale të vjedhjes, gjykata atij i kishte shqiptuar dënim unik prej 150 ditësh burgim me kusht dhe 300 euro gjobë. Afati i verifikimit ishte caktuar të jetë një vit.

PTH në Gjakovë e akuzonte Limanaxhiun se më 23 maj 2016 në Rahovec, me qëllim që vetes t'i sjell përfitime të kundërligjshme merr pasurinë e tjetrit nga dy të dëmtuar vjedhin gjithsej 13 pula e 3 gjela.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTH në Gjakovë më 27 maj 2016 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj Edmond Limanaxhiut, për dyshimin se ai kishte kryer vjedhje.

Kjo prokurori më 1 qershor 2016 kishte filluar hetimet ndaj Limanaxhiut dhe pas gjashtë muajve, më 6 janar 2017 prokuroria kishte ngritur aktakuzë ndaj tij për dy raste të vjedhjes.

Seanca fillestare ishte mbajtur më 24 shkurt 2020, apo pasi kishin kaluar 1145 ditë nga ngritja e aktit akuzues në gjykatë, duke shkelur afatin ligjor prej 30 ditësh. Në këtë seancë, i akuzuari pranon fajësinë, dhe po të njëjtën ditë bëhet edhe shpallja e aktgjykimit.

Përpos kësaj, IKD ka gjetur se në këtë rast kemi të bëjmë me ato raste, ku gjykata e prokuroria zhvillojnë procedura penale ndaj personave që dyshohet se kanë kryer vepra penale të cilat sipas KPRK-së janë kategorizuar si “vepra të rëndësisë së vogël”.

Ndonëse vepra të tilla plotësojnë elementet e veprave penale, ato nuk përbejnë rrezikshmëri të lartë shoqërore. Vepra këto që sipas, KPRK-së përkufizohen si “Nuk përbën vepër penale ajo vepër e cila edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuar me ligj, paraqet vepër të

⁹⁰ “Burg me kusht dhe gjobë ndaj të akuzuarit që pranoi se vodhi 13 pula e 3 gjela”, Betimi për Drejtësi, 24 shkurt 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/burg-me-kusht-dhe-gjobe-ndaj-te-akuzuarit-qe-pranoi-se-vodhi-13-pula-e-3-gjela/>). (Qasur së fundi më 29 prill 2020).

rëndësisë së vogël. Vepra është e rëndësisë së vogël kur rrezikshmëria e saj është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës; mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; rrethanave në të cilat është kryer vepra; shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose rrethanave personale të kryesit”.

Përkundër kësaj prokuroria ka ngritur aktakuzë e gjykata ka zhvilluar procedurë ndaj personit të akuzuar për blerjen e pulave e gjelave të vjedhur, ku shuma totale e të cilëve nuk tejkalon vlerën prej 60 euro.

Ky proces gjyqësor që nga dorëzimi i aktit akuzues në gjykatë e deri në marrjen e vendimit në shkallë të parë ka zgjatur **1145 ditë apo më shumë se 3 vjet**, duke shkelur parimin e gjykimit të drejtë e në kohë të arsyeshme.

14. Akuzohet gabimisht për vjedhje rryme

GjTh në Prishtinë, Dega në Podujevë

Numri i lëndës: P.nr.81/19,

Vepra penale: “*lejimi i njehsorëve të ndryshuar të shërbimeve*”, nga neni 323, par.1 i KPK-së.

Gjykatësi: Minir Hoti

Prokurori: Rexhep Maqedonci

I pandehuri: Vehbi Kaqiu

Faza e procedurës: Vendim për hedhjen poshtë të aktakuzës

Nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e procedurës penale kanë kaluar 1087 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë më 19 prill 2019 ka pushuar procedurën penale ndaj të akuzuarit për vjedhje rryme, Vehbi Kaqiu, pas tërheqjes së prokurorit nga ndjekja penale. Tërheqja e prokurorit erdhi pasi ai vërtetoi se aktakuza e ngritur nuk kishte asnjë lidhje me personin që figuronte si i akuzuar.⁹¹

PTh në Prishtinë e akuzonte Kaqiun se prej datës së pavërtetuar e deri më 15 prill 2014, në shtëpinë e tij, në fshatin Lupç i Poshtëm i Podujevës kishte shfrytëzuar energjinë elektrike pa autorizim nga KEDS-i, se kishte manipuluar njehsorin elektrik, duke i shkaktuar dëm KEDS-it, në shumë prej 162.39 euro

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 20 maj 2014 kishte pranuar kallëzimin penal nga KEDS-i të ushtruar ndaj të pandehurit Vehbi Kaqiu, me dyshimin se ai kishte vjedhur energjinë elektrike. Kjo prokurori më 28 prill 2016 kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj Kaqiut për veprën e lartcekur.

Seanca fillestare ishte caktuar të mbahej më 19 prill 2019, pasi kishin kaluar **1087** nga dorëzimi i saj në gjykatë, e cila përbën shkëlje të nenit 242.2 të KPPK-së.

Prokurori ishte tërhequr nga ndjekja penale me arsyetimin se “pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, si dhe të dhënave personale të të akuzuarit, është vërtetuar se ai nuk ishte personi për të cilin prokuroria kishte ngritur aktakuzë”. Pra, pasi kishin kaluar dy vite e 11 muaj, prokurori ka analizuar dhe vlerësuar shkresat e lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se kishte akuzuar personin e gabuar.

⁹¹ “Akuzohet gabimisht për vjedhje rryme, prokurori heq dorë nga aktakuza, Betimi për Drejtësi, 19 prill 2019 (Shih [linkun https://betimiperdrejtesi.com/akuzohet-gabimisht-per-vjedhje-rryme-prokurori-heq-dore-nga-aktakuza/](https://betimiperdrejtesi.com/akuzohet-gabimisht-per-vjedhje-rryme-prokurori-heq-dore-nga-aktakuza/)). (Qasur së fundi më 29 prill 2020).

15. Konstatohet se arma është lodër e fëmijëve, pas 13 vjetësh hedhet poshtë aktakuza për përdorim të armës

GjTh në Prishtinë, Dega në Podujevë

Numri i lëndës: P.nr.226/19,

Vepra penale: “përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”, neni 8.3 dhe 8.5 i Rregullores së UNMIK-ut, me nr.2001/7

Gjykatësi: Minir Hoti

Prokurori: Sead Kuraja

I pandehuri: Ajet Kastrati

Faza e procedurës: Vendim për hedhje të aktakuzës.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e procedurës penale kanë kaluar 4812 ditë.

Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë më 13 qershor 2019 kishte hedhur poshtë aktakuzën e ngritur nga ish-Prokuroria e Qarkut në Prishtinë ndaj Ajet Kastratit, për përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm.

Sipas aktakuzës së ngritur nga sh-Prokuroria e Qarkut në Prishtinë, Ajet Kastrati akuzohet se më 22 shtator 2002, rreth orës 13:15, në fshatin Kërpimeh, Komuna e Podujevës, pas një fjalosjeje me Nexhat Muçiqin, i pandehuri Ajet kishte nxjerrë revolen imituese nga brezi, dhe me qëllim frikësimi kishte drejtuar atë tek i dëmtuari.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Ish-Prokuroria e Qarkut në Prishtinë më 25 shtator 2002 kishte pranuar kallëzimin penal nga Policia e UNMIK-ut, të ushtruar ndaj Ajet Kastratit, me dyshimet se ai kishte kryer veprën penale “zotërim, posedim apo përdorim i armës”, nga neni 8.3. dhe 8.5 i rregullores së UNMIK-ut 2001/7.

Kjo prokurori më **11 prill 2006** kishte ngritur aktakuzën ndaj Kastratit, për veprën e lartcekur.

Kjo aktakuzë, së pari ishte dorëzuar në ish-Gjykatën e Qarkut më 11 prill 2006, ku edhe ishte konfirmuar aktakuza dhe ishin mbajtur disa seanca. Më pas, kishte kaluar në Departamentin e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Pastaj, ky departament e kishte deleguar lëndën në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë, kurse në fund sipas shkresave, lënda më 17 maj 2019, është deleguar në degën e Gjykatës në Podujevë.

Kjo akuzë ishte hedhur poshtë pas **13 vjetësh** nga Gjykata e Podujevës me arsyetimin se arma të cilën pretendohet se është përdorur nga i akuzuari, është imituese, konkretisht lodër për fëmijë.

Kjo gjykatë, pas analizimit të shkresave të lëndës, dhe konstatimit mbi mjetin me të cilin konsiderohet të jetë kryer vepra penale, erdhi në përfundim se nuk ka vepër penale të përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm.

Po ashtu, gjykata duke u bazuar në nenin 3 të Kodit të ri Penal të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi në prill të këtij viti, dhe aplikimit të ligjit më të favorshëm, sipas detyrës zyrtare ka rikualifikuar këtë vepër penale, nga neni 8.3. dhe 8.5 i rregullores së UNMIK-ut 2001/7, në nenin 367 paragrafi 2 i KPRK-së.⁹²

IKD vlerëson se hedhja e kësaj aktakuze ka qenë veprim i vonuar por i drejtë, ngase KRPRK-ja në nenin 113.40 [Përkufizimet], ndër të tjera ka numëruar mjetet që konsiderohen armë sipas legjislacionit tonë.⁹³ Ndërsa, ky kod ka përcaktuar se nuk konsiderohet armë sipas qëllimeve të këtij kodi, imitimi i armëve, veprime këto që i ngarkoheshin të akuzuarit Ajeti sipas kësaj aktakuze.⁹⁴

Raste të tilla të “ping-pongut” gjyqësor, ku një lëndë penale është transferuar tek disa gjykata, dhe sidomos rasti eklatant kur një person është mbajtur në evidencat penale për më shumë se 13 vite paraqesin shkelje të parimit universal të gjykimit të drejtë të realizuar brenda një afati të arsyeshëm, parim i ky i inkorporuar në nenin 5 të KPPK-së⁹⁵ dhe neni 31.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës⁹⁶, ku në këto dy këto nene proklamohet e drejta e çdo personi të dyshuar apo akuzuar për vepër penale që të gëzojë të drejtën e një shqyrtimi publik, të drejtë dhe të paanshëm përkitazi me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër tij, brenda një afati të arsyeshëm.

Përkitazi me zvarritjen e këtij procesi gjyqësor, evidentohet shkelja e autorizimeve nga ana e prokurorit të shtetit, siç përcaktohet me nenin 7, par.1, nën paragrafi 1.2,⁹⁷ ku sipas kësaj dispozite prokurori është i obliguar të zbatojë standarde më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare. Zbatimi në praktikë i kësaj dispozite, do të parandalonte rastin që një person të mbahej në regjistrat penal për më shumë se 13 vite, ngase siç dihet vet inicimi i procedurës penale ka pasoja juridike për të akuzuarin dhe veprime si këto të fundit, cenojnë rëndë sigurinë juridike.

⁹² KRPRK. Neni 367.2 “Kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet”.

⁹³ Po aty. Neni 113.40 “Këto në vijim janë armë: 40.1. armët e zjarrit; 40.2. armët e koleksionit; 40.3. armët pneumatike (ajrore); 40.4. armët që përdoren për shpërndarjen e gazit irritues; 40.5. armët shpërthyes; 40.6. armët me shigjeta; 40.7. armët e ftohta; 40.8. armët për sinjalizim akustik dhe të dritës; 40.9. armët elektroskok; 40.10. armët me rrymë”.

⁹⁴ Po aty. Neni 113 “Këto në vijim nuk konsiderohen armë për qëllime të këtij Kodi; 40.11. armët për qëllime industriale; 40.12. armët dekorative; 40.13. imitimi i armëve; 40.14. armët e zjarrit të bëra të papërdorshme (deaktivizuara) në mënyrë permanente me aplikimin e procedurave teknike që garantojnë nga organi kompetent ose që njihen nga organi kompetent; 40.15. fuzhnjat për peshkim nën ujë”.

⁹⁵ Kodi i Procedurës Penale. Neni 5.1 “Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme”.

⁹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, Neni 31.2 “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

⁹⁷ Ligji nr. 03/1-225 për prokurorin e shtetit, i miratuar më 30 shtator 2010. Neni 7.1.1.2.

Ky proces gjyqësor, që nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e kësaj procedure ka zgjatur 13 vite e dy muaj, apo **4812 ditë**.

16. Aktakuza pa asnjë provë hudhet nga gjykata

GjTh në Prishtinë, Dega në Podujevë

Numri i lëndës:

Vepra penale: “pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare”, nga neni 409 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykatësi: Minir Hoti

Prokurori: Bogdan Spadijer

Të pandehur: Milot dhe Anton Jaha

Faza e procedurës: Vendim për hedhje të aktakuzës.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e procedurës penale kanë kaluar 32 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë më 18 tetor 2019 e kishte pushuar procedurën penale ndaj dy të akuzuarve për pengim të personit zyrtar, Milot dhe Anton Jaha.

Një aktvendim të tillë, kjo gjykatë e ka marr pasi që ka konstatuar se aktakuza në këtë rast është ngritur pa asnjë provë të vetme.⁹⁸

PTh në Prishtinë i akuzonte Milot dhe Anton Jahën se më 18 mars 2019, në rrugën “Anton Qeta”, në Podujevë, në shtëpinë familjare kishin penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, në atë mënyrë që kur kanë ardhur zyrtarët e KEDS-it, në përcjellje të policisë me qëllim që të shkyçin energjinë elektrike, Milot Jaha i kishte fyer ata duke iu thënë “Jeni bërë më të këqij se serbët”, e pastaj Anton Jaha, gjithashtu i ka penguar dhe fyer, ku policët e kishin shoqëruar në Stacionin e Policisë në Podujevë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 16 prill 2019 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj të pandehurve Milot e Anton Jasha, me dyshimin se ata kishin kryer veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.

Kjo prokurori më 17 shtator 2019 ka ngritur aktakuzë ndaj dy të akuzuarve për pengim të personit zyrtar, Milot e Anton Jaha.

Gjykata e Podujevës më 18 tetor 2019 kishte pushuar procedurën penale ndaj të akuzuarve Jaha me arsyetimin se as se Prokuroria Themelore e Prishtinës nuk ia kishte bashkangjitur asnjë provë aktakuzës.

⁹⁸ “Aktakuzë pa asnjë provë, pushon procedura penale ndaj dy të akuzuarve se penguan punëtorët e KEDS-it në Podujevë”, Betimi për Drejtësi, 18 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktakuze-pa-asnje-prove-pushon-procedura-penale-ndaj-dy-te-akuzuarve-se-penguan-punetoret-e-keds-it-ne-podujeve/>). (Qasur së fundi më 29 prill 2020).

Sipas kësaj gjykate, nga kallëzimi penal i Policisë e as nga aktakuza nuk përmendet asnjë i dëmtuar, viktimë apo ankues. Tutje, gjykata thekson se lënda në fjalë përmbante vetëm deklaratimet e të akuzuarve, të cilët kishin mohuar fajësinë.

Fillimisht, KPPK, në nenin 9.4 të saj ka përcaktuar se aktakuza duhet jetë produkt i një faze hetimi ku mblidhen fakte të cilat mund të provohen në shqyrtim gjyqësor, ose në rastet kur kodi lejon ngritjen e aktakuzave të drejtpërdrejta, provat e siguruar duhet të tejkalojnë dyshimin e bazuar mirë, se aktakuza mund të vërtetohet në gjykatë.⁹⁹

Në rastin konkret prokurori i rastit ka dështuar që të ngritë një aktakuzë të suksesshme ngase akti të cilin e ka prezantuar para gjykatës nuk ka përmbajtur as elementet e detyrueshme, të cilat sipas nenit 241 par.1 nën par.1.6 dhe 1.7 të KPPK-së, ku theksohet se aktakuza duhet të përmbajë doemos provat që duhen prezantuar në shqyrtim gjyqësor, së bashku me emrat e dëshmitarëve, shkresave dhe sendet që duhet administruar si provë.¹⁰⁰

KPPK-ja në nenin 262.1 të tij ka adoptuar rregullin i cili ndalon gjykatën që të shpall një të akuzuar fajtor, duke u mbështetur vetëm në një dëshmi, andaj ky obligim ligjor duhet të shërbejë si udhërrëfyes për prokurorinë që para se të procedojnë me aktakuza për në shqyrtim gjyqësor, të bëjnë të gjitha vlerësimet, në mënyrë që ato të mos rrëzohen në gjykatë si të pathemelta.¹⁰¹

Ky gjykim, nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e procedurës ka zgjatur **32 ditë**.

⁹⁹ KPPK. Neni 9.4 “Nëse prokurori i shtetit vlerëson se gjatë hetuesisë janë mblodhur prova të mjaftueshme për të vazhduar në shqyrtim gjyqësor, prokurori i shtetit harton aktakuzën dhe paraqet faktet mbi të cilat ai e bazon aktakuzën dhe siguron provat për këto fakte”.

¹⁰⁰ Po aty. Neni 241.1.1.6. “Rekomandimin për provat që duhet prezentuar në shqyrtimin gjyqësor së bashku me emrat e dëshmitarëve dhe ekspertëve, shkresat që duhet lexuar dhe sendet që duhet marrë si provë. 1.7. Shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore”.

¹⁰¹ Po aty. Neni 262.1 “Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”.

17. Dënohet dy herë për të njëjtat vepra penale

GjTh në Prishtinë, Dega në Podujevë

Numri i lëndës: P.nr.133/18,

Vepra penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, “përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 374 par.1 dhe neni 375 par.1 të KPRK-së.

Gjykatës: Elheme Jashari/Minir Hoti

Prokurorë: Hava Krasniqi/Rexhep Maqedonci

I pandehuri: Ahmet Rrahimi.

Faza e procedurës: Aktgjykim dënues i dhënë në shkallë të parë.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në nxjerrjen e aktgjykimit dënues kanë kaluar 617 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, brenda pak muajsh e ka dënuar dy herë për të njëjtat vepra penale të akuzuarin, Ahmet Rrahimi. Së pari, më 28 maj 2019, kjo gjykatë e kishte dënuar me një vit burgim me kusht të akuzuarin.¹⁰²

Për herë të dytë dhe për të njëjtat vepra penale, Ahmet Rrahimi ishte dënuar nga kjo gjykatë më 23 tetor 2019, për çka ai është dënuar me një vit burg dhe 300 euro gjobë me kusht.¹⁰³

PTh në Prishtinë e akuzonte Ahmet Rrahimi se nga koha e pacaktuar deri më 2 gusht 2017, në fshatin Revuqë të Podujevës, e ka poseduar armën pushkë automatike, prodhim kinez dhe një karikator të zbrastë, të cilat i posedonte pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët. Ndërsa, në dispozitivin e dytë, ai akuzohet se ka gjuajtur me të njëjtën armë në kundërshtim me ligjin.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 3 gusht 2015 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj Ahmet Rrahimit, më dyshimin se kishte kryer veprat penale armëmbajtje pa leje dhe përdorimi i armës. Kjo prokurori më 23 janar 2018 kishte filluar hetimet ndaj Rrahimit në drejtim të veprave penale të lartcekura.

Më 14 shkurt 2018, PTh në Prishtinë kishte ngritur aktakuzë ndaj Ahmet Rrahimit për dy veprat e cekura si më lartë.

¹⁰² “Dënohet me kusht i akuzuari për posedim dhe përdorim të armës”, Betimi për Drejtësi, 28 maj 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-kusht-i-akuzuari-per-posedim-dhe-perdorim-te-armes/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

¹⁰³ “Gjykatësja “harron” ta shkruajë aktgjykimin, dënohet për herë të dytë i akuzuari se përdori armën pa leje”, Betimi për Drejtësi, 23 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykatesja-harron-ta-shkruaje-aktgjykimin-denohet-per-here-te-dyte-i-akuzuari-se-perdori-armen-pa-leje/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

Seanca fillestare ishte mbajtur më 28 maj 2019, pasi kishin kaluar 469 ditë nga ushtrimi i aktit akuzues në gjykatë, duke shkelur afatin ligjor prej 30 ditësh të përcaktuar me nenin 242.4 të KPPK-së.

Në këtë seancë i akuzuari Rrahimi ishte deklaruar fajtor dhe gjykata atë e kishte dënuar me një vit burgim me kusht të akuzuarin.

Mirëpo, ky proces gjyqësor nuk ka përfunduar me kaq, ngase i akuzuari Ahmet Rrahimi vetëm disa muaj më vonë është ballafaquar sërish me gjykatën, për të njëjtat vepra penale.

Pra, për herë të dytë Ahmet Rrahimi ishte dënuar më 23 tetor 2019, nga një gjykatës tjetër, me një vit burg dhe 300 euro gjobë me kusht

Sipas Gjykatës së Podujevës, arsyeja pse ai është dënuar dy herë për të njëjtat vepra penale, është se gjykatësja në herën e parë, Elheme Jashari, nuk e kishte përpiluar në formë të shkruar aktgjykimin që ishte shpallur më 28 maj 2019.

Në rastin konkret gjykata ka dështuar të zbatoj dispozitat ligjore të karakterit imperativ, duke mos respektuar asnjërin nga afatet e përcaktuara me KPPK për përpilimin me shkrim të aktgjykimit, procedurë kjo e cila pason, pas përfundimit dhe shpalljes publike së aktgjykimit.

Mos veprimi i gjykatës në përmbushjen e detyrimeve ligjore ka një sërë pasojash negative në dëm të të pandehurit. Fillimisht, atij i është cenuar e drejta kushtetuese dhe ligjore që të përdorë mjetin juridik ndaj vendimit gjyqësor, pa fajin e tij. Pastaj, veprime të këtilla paraqesin cenim serioz të parimit të sigurisë juridike, ngase kjo vë në dyshim esencën e mbajtjes së një gjykimi, ngase tek palët mund të krijohet bindja se në çdo kohë gjykatat mund të rifillojnë procedura gjyqësore, pa asnjë bazë ligjore.

Kjo paraqet shkelje të nenit 369.1 të KPPK-së, i cili obligon gjykatën që aktgjykimin e shpallur ta përpilojë brenda 15 ditëve nga shpallja e tij kur i akuzuari gjendet në paraburgim ose i është caktuar paraburgimi, ndërsa në raste të tjera brenda tridhet (30) ditëve nga dita e shpalljes.¹⁰⁴

Në rastin konkret gjykimi i një personi dy herë për të njëjtën vepër penale, përbën shkelje të parimit universal “ne bis in idem”, i cili në mënyrë shprehimore ndalon veprime të këtilla në funksion të mbrojtjes së interesave të të pandehurve në procedurë, më përjashtime të veçanta të cilat i parasheh ligji. Pra, një rregull i tillë, i inkorporuar edhe në nenin 4 të KPPK-së, parasheh se “askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar

¹⁰⁴ KPPK. Neni 369.1 “Aktgjykimin e shpallur duhet të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga shpallja e tij, kur i akuzuari gjendet në paraburgim ose i është caktuar paraburgimi, ndërsa në raste të tjera brenda tridhet (30) ditëve nga dita e shpalljes. Kur rasti është i ndërlikuar, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga presidenti i gjykatës që të zgjasë afatin për përpilimin me shkrim të aktgjykimit deri në gjashtëdhjetë (60) ditë”.

me vendim të formës së prerë të gjykatës”. Këtë rregull e gjejmë në nenin 34 të Kushtetutës së Kosovës dhe në nenin 14 paragrafi 7 të PNDKP.

Sipas vlerësimit të IKD-së, një parim të tillë duhet ta ketë parasysh si prokurori i shtetit me rastin e ngritjes së akuzës, ashtu edhe gjykata me rastin e zhvillimit të procedurës dhe të marrjes së vendimit, meqë kjo është pengesë për zhvillim të procedurës së re për të njëjtën çështje.

Mos respektimi i afatit për përpilimin e aktgjykimit nga ana e gjykatës paraqet shkelje të nenit 5 të Ligji nr. 06/1 - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, konkretisht paragrafit 1, nën paragrafit 1.2 të këtij ligji, ku përcaktohet se gjyqtari kryen shkelje disiplinore nëse ai shkel ligjin. Në rastet kur mos kryerja e detyrave zyrtare shndërrohet në shprehje dhe bëhet në vazhdimësi, atëherë një sjellje e tillë trajtohet si shkelje disiplinore konform 5.2.2.7 të këtij ligji.¹⁰⁵

Ky gjykim, që nga ngritja e aktakuzës e deri në përfundimin e procesit gjyqësor ka zgjatur **617 ditë**.

Lidhur me këtë rast, gjyqtari mbikëqyrës i Gjykatës së Podujevës, Gazmend Bahtiri në një përgjigje për IKD-në, ka konfirmuar faktin se gjykatësja Elheme Jashari nuk e kishte përpiluar në formë të shkruar aktgjykimin ndaj të akuzuarit Ahmet Rrahimi, përkundër pranimin të fajit dhe shpalljes së aktgjykimin ndaj të akuzuarit, pasi ajo ishte transferuar në GjTh në Prishtinë, Departamenti për të Mitur. Ai ka deklaruar se në rastin konkret nuk ishte shkelur parimi “ne bis in idem”, për shkak se nuk kishte pasur aktgjykim të formës së prerë.

“Lënda me shenjen P.nr.133/18, nga gjyqtari Minir Hoti u njoftova se në shkresat e lëndës ka rezultuar procesverbali i mbajtjes së seancës fillestare në të cilën i pandehuri u deklarua i fajshëm, ndërsa nuk e ka gjetur aktgjykimin e përpiluar nga gjyqtarja paraprake Elheme Jashari e cila në atë kohë ka kaluar në gjykatën Themelore Prishtinë-Departamenti për të Mitur dhe e ka treguar seancën fillestare në të cilën i pandehuri u deklarua i fajshëm u shpall fajtor dhe kundër aktgjykimin palët në procedurë nuk kanë parashtruar ankesë. Në rastin konkret mendoj që nuk është shkelur parimi “ne bis in idem”, për shkak se nuk ka pasur vendim-aktgjykim të formës së prerë” ka thënë gjykatësi Bahtiri.¹⁰⁶

¹⁰⁵ Ligji nr. 06/1 - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i miratuar më 23 nëntor 2018. Neni 5.2.2.7 “në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj”.

¹⁰⁶ Përgjigje nga gjyqtari mbikëqyrës i GjTh në Prishtinë, Dega në Podujevë, Gazmend Bahtiri, për IKD. 09.10.2020

18. Aktakuzë se e dëmtoi KEDS-in 9 euro

GjTh në Prishtinë, Dega në Podujevë

Numri i lëndës: P.nr.189/18

Vepra penale: “*lidhja e paautorizuar në shërbime*”, nga neni 321 të KPRK-së.

Gjykatësi: Gazmend Bahtiri

Prokurori: Ali Hajdini,

I pandehuri: Arsim Maloku.

Faza e procedurës: Vendim për hedhje të aktakuzës.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e procedurës penale kanë kaluar 663 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë më 27 dhjetor 2019 ka pushuar procedurën penale ndaj Malokut, pas tërheqjes së prokurorit nga ndjekja penale.¹⁰⁷

PTh në Prishtinë e akuzonte Arsim Malokun se me 5 tetor 2017, punëtorët e autorizuar të KEDS-it, gjatë kontrollit në shtëpinë e tij në fshatin Shtedim të Podujevës, kanë vërejtur se i pandehuri me qëllim që vetes t’i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është furnizuar me energji elektrike dhe ka anashkaluar njehsorin elektrik.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 13 dhjetor 2017 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga KEDS-i ndaj të pandehurit Arsim Maloku, me dyshimin se ai kishte kryer veprën penale vjedhje rryme. Kjo prokurori më 5 mars 2018 kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj Malokut, në drejtim të veprës së lartcekur.

Seanca fillestare ishte caktuar më 27 dhjetor 2019, kur kishin kaluar 1 vjet e 9 muaj nga dorëzimi i aktakuzës në gjykatë. Në këtë seancë, prokurori që përfaqësonte akuzën njoftonte gjykatën se tërhiqej nga ndjekja penale, me arsyetimin se kjo ishte vepër e rëndësisë së vogël, me rrezikshmëri fare të parëndësishme.

Si rrjedhojë e heqjes dorë nga ndjekja penale, gjykata duke vepruar sipas parimit akuzator nuk kishte më objekt trajtimi, andaj morri vendim për pushimin e kësaj procedure.

KPRK-ja, në nenin 11 të tij ka përcaktuar tiparet e një veprime i cili sipas legjislacionit penal cilësohet si “vepër e rëndësisë së vogël”. Në rastet e tilla, organet e ndjekjes nuk iniciojnë procedurë penale, për shkak se rrezikshmëria e veprës është e parëndësishme për shkak të natyrës së saj ose peshës së veprës, apo mungojnë pasojat e dëmshme dhe raste tjera të përcaktuara me nenin e sipërcituar.¹⁰⁸

¹⁰⁷ “Aktakuzë se e dëmtoi KEDS-in 9 euro, prokurori heq dorë nga ndjekja penale”, Betimi për Drejtësi, 27 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktakuze-se-e-demtoi-keds-in-9-euro-prokurori-heq-dore-nga-ndjekja-penale/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

¹⁰⁸ KRPRK. Neni 11 “Nuk përbën vepër penale ajo vepër e cila edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuara me ligj, paraqet vepër të rëndësisë së vogël. Vepra është e rëndësisë së vogël kur rrezikshmëria e saj

Në rastin konkret, edhe pse i akuzuari ka kryer një vepër e cila në vete përmban të gjitha tiparet e veprës penale të përcaktuara me ligjin penal, për shkak se veprimi konkret posedon një sasi tejet të vogël të pasojës së dëmshme apo të rrezikshmërisë ajo nuk konsiderohet si vepër penale. Ky institut është paraparë për rastet e lehta të veprave penale, të cilat kryhen shpeshherë në jetën e përditshme, kur veprime të caktuara, edhe pse në dukje janë të paligjshme, humbasin karakterin kriminal, nuk përfshihen në sferën penale, për shkak të rëndësisë së vogël, ngase në të drejtën penale, si vepra penale konsiderohen ato veprime të kundërligjshme që përmbajnë në vete një vëllim a intensitet të caktuar të rrezikimit apo dëmtimit të së mirës juridike të mbrojtur me të drejtën penale.

Si rrjedhojë, për 663 ditë sa ka zgjatur ky proces gjyqësor, gjykata është ngarkuar pa nevojë me një lëndë ku dëmi i pretenduar është vetëm 9 euro, ndërsa vet zhvillimi i procesit gjyqësor përfshin në vete një mori shpenzimesh të tjera për palët e përfshira në procedurë, pastaj gjykata ka mundur të procedojë me lëndë të tjera, pa pasur nevojë të trajtojë një çështje e cila nuk ka objekt sipas legjislacionit tonë penal, si dhe fakti i pamohueshëm që një qytetar i Republikës së Kosovës për afro dy vite është mbajtur në evidenca penale dhe është listuar në kategorinë e delikuentit, për një vepër e cila nuk konsiderohet vepër penale sipas legjislacionit tonë penal.

Ky rast kishte zgjatur **663 ditë**, deri në pushimin e kësaj procedure.

është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës; mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; rrethanave në të cilat është kryer vepra; shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose rrethanave personale të kryesit”.

19. Prokurorja shkon në seancë pa shkresa të lëndës, gjykatësi e quan papërgjegjësi

GjTh në Prishtinë, Dega në Podujevë

Numri i lëndës: P.nr.701/18

Vepra penale: “vjedhja”, nga neni 325 të KPRK-së.

Gjykatësi: Gazmend Bahtiri

Prokurorja: Hava Krasniqi

I pandehuri: Yll Alushi

Faza e procedurës: Rast i kthyer në rigjykim.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në përfundimin e gjykimit në shkallë të parë kanë kaluar 227 ditë.

Gjykata Themelore në Podujevë më 23 janar 2020 kishte dështuar që të mbante seancën e rigjykimit ndaj të akuzuarit për vjedhje dhe tentim vjedhje, Yll Alushi, pasi që prokurorja kishte njoftuar gjykatën se nuk i posedonte shkresat e lëndës me vete.¹⁰⁹

PTh në Prishtinë e akuzonte Ylli Alushi, Adonis Plakolli dhe Xhemshit Sylja, akuzohen se më 1 dhjetor 2014, në intervalin kohor mes orës 01:00 dhe 02:00, në rrugën magjistrale Prishtinë-Podujevë, në parkingun afër servisit “Mercedes”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, në bashkëkryerje kishin vjedhur afër 200 litra naftë dhe kishin shkaktuar dëm në vlerë prej 220 euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 9 mars 2015 kishte pranuar nga Policia e Kosovës kallëzimin penal ndaj të pandehurit Yll Alushi dhe të tjerëve, me dyshimin se ata kishin kryer veprën penale vjedhje dhe tentim vjedhje. Kjo prokurori më 6 nëntor 2018 kishte ngritur aktakuzë për vjedhje ndaj Yll Alushit dhe të akuzuarve të lartcekur.

Seanca fillestare ishte mbajtur më 8 prill 2019, pas 154 ditëve nga ngritja e aktakuzës në gjykatë. Shqyrtimi kryesor kishte filluar më 17 qershor 2019, ndërsa më 20 qershor kjo gjykatë kishte dënuar Alushin me burgim prej tre muajsh si dhe 400 euro gjobë. Por kjo lëndë, ishte kthyer në rigjykim nga Apeli më 6 dhjetor 2019.

Seanca e rigjykimit e caktuar më 23 janar 2020 kishte dështuar të mbahej ngase prokurorja nuk kishte marrë shkresat e lëndës me vete, përkundër faktit se i akuzuari Alushi ishte sjellë nga burgu i Dubravës.

Kjo kishte bërë që gjykatësi i rastit, të adresojë kritika ndaj kësaj mënyre të përfaqësimit nga prokuroria, duke i cilësuar veprimet e tilla si papërgjegjësi të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, pasi që raste të ngjashme sipas tij, kanë ndodhur jo rrallë herë.

¹⁰⁹ “Prokurorja shkon në seancë pa shkresa të lëndës, gjykatësi e quan papërgjegjësi”, Betimi për Drejtësi, 23 janar 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurorja-shkon-ne-seance-pa-shkresa-te-lendes-gjykatesi-e-quan-papergjegjesi/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

Nga ngritja e aktakuzës e deri në përfundimin e gjykimit në shkallë të parë kishin kaluar **227 ditë**.

Sipas gjyqtarit mbikëqyrës të kësaj gjykate, Gazmend Bahtiri, kjo nuk ishte hera e parë që prokurorët prezantonin në seanca pa shkresa të lëndës dhe se një çështje të tillë, ata e kishin diskutuar me përgjegjës të departamentit të prokurorisë.

“Sa i përket çështjes penale me shenjën P.nr. 701/18, kur prokurori i shtetit ka qenë pa shkresa të lëndës, nuk ka qenë hera e parë dhe këtë çështje e kemi diskutu me përgjegjës të departamentit të prokurorisë dhe ju kemi tërheqë vërejtjen në procesverbale, mendoj që është përgjegjësi e administratës së prokurorisë, për faktin se prokurorët që përfaqësojnë lëndët në gjykata ju dërgohen në zyrë nga administrata-shkrimorja dhe prokurorët arsyetohen se nuk ju ka dhënë lënda për përfaqësim dhe nuk është dijëni për ftesën e gjykatës” ka thënë Bahtiri.¹¹⁰

¹¹⁰ Përgjigje nga gjyqtari mbikëqyrës i GjTh në Prishtinë, Dega në Podujevë, Gazmend Bahtiri, për IKD. 09.10.2020.

20. Akuzohet për vjedhje pylli në gusht, në shkresa është fotografia me borë deri në gjunjë

GjTh në Prishtinë, Dega në Podujevë

Numri i lëndës: P.nr.529/19

Vepra penale: “vjedhje pylli”, nga neni 349, paragrafi 3, pika 3.1 të KPRK-së.

Gjykatësi: Minir Hoti

Prokurori: Ali Hajdini

I pandehuri: Bujar Jashari

Faza e procedurës: Në proces.

Në seancën fillestare të 28 shkurtit 2020, i akuzuari Bujar Jashari, kishte mohuar fajësinë se në gusht të vitit 2019, të ketë vjedhur pyllin.¹¹¹

PTH në Prishtinë e akuzonte Bujar Jasharin se më 3 gusht 2019, rreth orës 11:00, në vendin e quajtur “Te Gërdeqi”, në fshatin Gërdec në Podujevë, në pyllin në pronësi publike, me të cilin menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës, është zënë në flagrancë nga punëtori i autorizuar i sektorit të pylltarisë, duke prerë dru, me ç’rast Agjencisë Pyjore të Kosovës, në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 452.20 euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTH në Prishtinë më 24 shtator 2019 kishte pranuar kallëzimin penal nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural e Podujevës ndaj të pandehurit Bujar Jashari. Më 17 tetor 2019 kjo prokurori kishte filluar hetimet ndaj Jasharit dhe më 18 nëntor 2019 PTH në Prishtinë kishte ngritur aktakuzë ndaj Jasharit për vjedhje pylli.

Shqyrtimi fillestar ndaj Jasharit ishte caktuar më 28 shkurt 2020, pasi kishin kaluar 103 ditë nga dorëzimi i kësaj aktakuze në gjykatë, duke shkelur afatin ligjor prej 30 ditësh të përcaktuar me nenin 242.4 të KPPK-së. Në këtë seancë, i akuzuari Jashari kishte mohuar fajësinë për vjedhje pylli.

Ndërsa, gjykatësi i rastit ka deklaruar se rasti në aktakuzë përshkruhet të ketë ndodhur me 3 gusht, ndërsa fotografitë në shkresat e lëndës paraqesin një traktor të vetëm dhe në kohë me borë.

Lidhur me këtë, prokurori që ka përfaqësuar aktakuzën ka kërkuar që të ftohet roja i pyllit për të kuptuar për rastin, përkundër faktit se prokuroria kishte zhvilluar hetime për rastin në fjalë. Kjo dëshmon për një mungesë të përgjegjësisë nga ana e prokurorit, i cili përkundër faktit se nuk ka ngritur aktakuzën në fjalë, nuk ka bërë asnjë vlerësim dhe analizë paraprake të materialeve që janë pjesë e shkresave të lëndës.

¹¹¹ “Gjykatësi: Nuk e di qysh është ngritë aktakuzë se në gusht ka ndodhur vepra, e në shkresa është fotografia me borë deri në gjunjë”, Betimi për Drejtësi, 28 shkurt 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykatesi-nuk-e-di-qysh-eshte-ngrite-aktakuze-se-ne-gusht-ka-ndodhur-vepra-e-ne-shkresa-eshte-fotografia-me-bore-deri-ne-gjunje/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

21. Dënohet me burg se vodhi një palë këpucë

GjTh në Ferizaj,

Numri i lëndës: P.nr.970/15,

Vepra penale: “vjedhje”, nga neni 325 par. 1 i KPRK-së.

Gjykatësi: Adem Shabani

Prokurori: Albert Zejnullahu

I pandehuri: Arben Ukëzmajli

Faza e procedurës: Aktgjykim dënues i dhënë në shkallë të parë.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në përfundimin e gjyimit në shkallë të parë kanë kaluar 1331 ditë.

Gjykata Themelore në Ferizaj më 3 prill 2019 e ka dënuar me dy muaj burg dhe 200 euro gjobë të akuzuarin për vjedhje Arben Ukëzmajli. Mirëpo, me pëlqimin e personit të dënuar, gjykata i zëvendësoi dënimin e shqiptuar me urdhër me punë në dobi të përgjithshme në kohë prej 140 orëve.¹¹²

PTh në Ferizaj e akuzonte Ukëzmajlin se më 14 korrik të vitit 2014, në qendrën tregtare “ETC”, kishte marrë një palë këpucë në vlerë prej 50 euro, në atë mënyrë që vetes t’i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm dhe me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Ferizaj më 18 gusht 2014 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga Policia e Kosovës ndaj Arben Ukëzmajli, me dyshimin se ai kishte kryer veprën penale vjedhje. Kjo prokurori pas pranimit të kallëzimit penal, më 12 gusht 2015 kishte ngritur aktin akuzues ndaj Ukëzmajlit për vjedhje.

Seanca fillestare ndaj tij ishte mbajtur më 3 prill 2019, apo pasi kishin kaluar tri vjet e 7 muaj që nga dorëzimi i aktakuzës në gjykatë. Kjo paraqet shkelje flagrante të nenit 242.4 të KPPK-së, i cili ka përcaktuar mbajtjen e kësaj seance brenda 30 dite pas ngritjes së aktakuzës.

Në këtë seancë i akuzuari Ukëzmajli ishte deklaruar fajtor për këtë veprë penale, dhe gjykata atij fillimisht i kishte dënim prej dy muaj burgim dhe 200 euro gjobë, të cilin dënim më pas e kishte zëvendësuar me punë në dobi të përgjithshme. Ky veprim i gjykatës është ndërmarrë në përputhje me nenin 45.1 të KPRK-së, ku përcaktohet se gjykata me pëlqimin e personit të dënuar mund të zëvendësojë dënimin me burg deri në 6 muaj me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.¹¹³

¹¹² “Dënohet me 140 orë punë në dobi të përgjithshme i akuzuari që pranoi se vodhi një palë këpucë”, Betimi për Drejtësi, 3 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-140-ore-pune-ne-dobi-te-pergjithshme-i-akuzuari-qe-pranoi-se-vodhi-nje-pale-kepuce/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

¹¹³ KRPRK. Neni 45.1 “Gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund të zëvendësojë dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme”.

Ky rast gjyqësor, që nga ngritja e aktakuzës e deri në nxjerrjen e vendimit në shkallë të parë ka zgjatur **1331 ditë**.

22. Akuzohet gabimisht personi për vjedhje rryme

GjTh në Prishtinë,

Numri i lëndës: P.nr.963/16

Vepra penale: “vjedhje e shërbimeve komunale”, nga neni 320 i KPRK-së.

Gjykatësi: Kushtrim Shyti

Prokurorja: Ajshe Ferati

I pandehuri: Abdullah Xhemajli

Faza e procedurës: Vendim për hedhje të aktakuzës.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në pushimin e procedurës penale kanë kaluar 1162 ditë.

Gjykata Themelore në Prishtinë më 2 maj të vitit 2019 viti kishte marrë vendim për pushimin e procedurës penale ndaj të akuzuarit për vjedhje të rrymës, Abdullah Xhemajli.

Ky aktgjykim ishte rrjedhojë e tërheqjes nga ndjekja penale të prokurores së PTh në Prishtinë, pasi sipas saj, është vërtetuar se personi i akuzuar nuk është ai që ka kryer një vepër të tillë penale, por që bëhet fjalë për një person tjetër që ka emrin e njëjtë.¹¹⁴

PTh në Prishtinë e akuzonte Abdullah Xhemajlin, se prej datës së pavërtetuar deri më 13 mars 2014, kishte shfrytëzuar pa autorizim energjinë elektrike në shtëpinë e tij dhe me një kablo është kyçur direkt në rrjet, jashtë njehsorit, kështu që energjia e shpenzuar elektrike nuk është regjistruar fare, me çka ka shkaktuar dëm material në shumën prej 903.62 euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PTh në Prishtinë më 17 qershor 2014 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga KEDS-i ndaj Abdullah Xhemajlit. Kjo prokurori nuk kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve, por më 26 shkurt të vitit 2016, kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndaj të akuzuarit Xhemajli.

KPPRK-ja, në par.2 të nenit 101 ka paraparë mundësinë e ngritjes së aktakuzave të drejtpërdrejtë, pa zhvillim të hetimeve, për veprat penale të dënueshme deri në tri vjet burgim.¹¹⁵ Seanca fillestare në këtë rast ishte caktuar më 2 maj 2019, apo kur kishin kaluar 1162 ditë, apo shprehur në vite, tre vite e dy muaj që nga data e ngritjes së kësaj aktakuze. Kjo paraqet shkelje të afatit të paraparë me par.4 të nenit 242 të KPPRK-së, ku përcaktohet qartë

¹¹⁴ “Prokuroria tërhiqet nga ndjekja penale pasi që ka akuzuar gabimisht personin për vjedhje rryme”, Betimi për Drejtësi, 2 maj 2019 (<https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-terhiqet-nga-ndjekja-penale-pasi-qe-ka-akuzuar-gabimisht-personin-per-vjedhje-rryme/>). (Qasur së fundi më 30 prill 2020).

¹¹⁵ KPPK. Neni 101.2 “Kur policia apo ndonjë person tjetër bën kallëzim tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një vepër penale ose për disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim, dhe prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, prokurori i shtetit mund të ngrit aktakuzë sipas nenit 241 të këtij Kodi”.

obligimi që ka gjykata në caktimin e kësaj seance brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktit akuzues.¹¹⁶

Po në seancën e 2 majit të këtij viti, prokurorja e PTh në Prishtinë, kishte marrë vendim për t'u tërhequr nga ndjekja penale, me arsyetimin se Abdullah Xhemajli, nuk ishte personi që kishte kryer këtë vepër penale, por se bëhet fjalë për një person tjetër që kishte rastisur të ketë emër të ngjashëm si tani i akuzuari.

Kjo mënyrë e veprimit është në kundërshtim të plotë edhe me dispozitën e nenit 241, ku në nënpar.1.2 të par.1 të këtij neni përcaktohen qartë elementet të cilat duhet t'i përmbajë një aktakuzë, e mes tjerash përmendet “*emri dhe mbiemri i të pandehurit dhe të dhënat e tij personale*”.¹¹⁷

Nëse analizojnë kohëzgjatjen e këtij procesi gjyqësor që nga ngritja e aktakuzës më 26 shkurt të vitit 2016 dhe përfundimin e këtij procesi më 2 maj 2019, del se ky rast kishte marrë epilog pasi kishin kaluar **1162 ditë**. Pra, në këtë rast është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e paraparë me nenin 31 të saj. Në par.2 të këtij neni, përcaktohet se “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.¹¹⁸

¹¹⁶ Po aty. Neni 242.4 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.

¹¹⁷ KPPK. Neni 241.1 “Aktakuza përmban: emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale”.

¹¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 31.2.

11. Rekomandimet

1. KGJK dhe KPK të bëjnë vlerësime periodike mbi ngarkesën dhe performancën e secilës gjykatë dhe prokurori, dhe varësisht nga rezultatet të ndërmerren masa konkrete për reduktimin e numrit të lëndëve që trashëgohen vit pas viti.
2. KPK të publikojë në baza të rregullta mujore statistika mbi punën e sistemit prokurorial, në mënyrë që publiku të ketë pasqyrë të qartë për progresin apo regresin e këtij institucioni.
3. KGJK të rris numrin e aktgjyqimeve të publikuara në web-faqen zyrtare, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies para publikut.
4. KGJK dhe KPK të krijojnë data baza unike mbi performancën e këtyre institucioneve, dhe të sigurohen për saktësinë e këtyre të dhënave, duke eliminuar të gjitha paqartësitë numerike të hasura në raportet vjetore mbi punën e këtyre institucioneve.
5. KGJK dhe KPK të analizojnë nëse rregulloret respektive mbi normat orientuese kanë rritur efektivitetin në punë të prokurorëve dhe gjykatësve që veprojnë në DP.
6. KGJK të rishqyrtoj Rregulloren aktuale për Përcaktimin e Normave Orientuese të Gjyqtarëve.
7. KGJK dhe gjykatat të angazhohen për uljen e numrit të seancave të shtyra.
8. KGJK dhe KPK të iniciojnë procedura disiplinore ndaj prokurorëve dhe gjykatësve që kanë shkelur afatet ligjore apo nuk kanë kryer me profesionalizëm detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligj.
9. KGJK të miratojë një strategji efektive për t'iu qasur dukurisë së parashkrimit të rasteve.
10. KPK të mbajë të dhëna të detajuara mbi numrin e rasteve të parashkruara.
11. Prokurorët në aktakuzat e tyre, në rastet kur ka bazë ligjore, të paraqesin kërkesa për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së përfutur në mënyrë të kundërligjshme.
12. KGJK të adresojë dukurinë e mos procedimit në kohë të lëndëve, dhe të sigurohet që në secilën gjykatë lëndët të trajtohen brenda një afati të arsyeshëm kohor.
13. Prokurorët të mos ngritin aktakuza me vetëm një provë, ngase kjo është në kundërshtim me KPPK, dhe rrjedhimisht aktakuzat e tilla refuzohen si të pabazuara.
14. Gjykatat të vlerësojnë çështjen e kompetencës lëndore dhe territoriale qysh me rastin e pranimit të lëndëve për shqyrtim, dhe të pamundësohet që për shkaqe të tilla të zvarritet procedura penale.
15. Gjykatësit të mos procedojnë me rastet e kualifikuara si vepra të rëndësisë së vogël.
16. Prokurorët të zbatojnë hetime efikase dhe të kujdesen për mbledhjen e të gjitha provave fajësuese dhe shfajësuese, dhe të pamundësohet ngritja e aktakuzave që mbështeten në prova të paqëndrueshme e të pa themelta.
17. Prokurorët të ngritin aktakuza të drejtpërdrejta vetëm në ato raste kur nga të dhënat e siguruar nga kallëzimi penal tejkalohej dyshimi i bazuar mirë se një vepër penale është kryer.
18. Prokurorët të bëjnë verifikime mbi statusin jetësor të të akuzuarve, që të pamundësohet ngritja e aktakuzave ndaj personave të vdekur.
19. Gjykatësit të sigurojnë zhvillimin e seancave gjyqësore sipas afateve ligjore dhe të aplikojnë të gjitha mundësitë ligjore për sigurimin e prezencës së të akuzuarve.

20. Gjykatësit të sigurojnë trajtim të barabartë të të gjithë qytetarëve para ligjit, duke mos praktikuar standarde të dyfishta varësisht nga statusi i personit që ka cilësinë e të akuzuarit.